



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në “Sistemet e
Informacionit në Biznes”**

ofruar nga

Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Dr. Gloria TYXHARI

Dr. Senada BUSHATI

Nëntor / 2024

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Master Profesional në “Sistemet e Informacionit në Biznes”**

1	IAL aplikues:	Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Informatikës së Biznesit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master Profesional në “Sistemet e Informacionit në Biznes”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMAS Nr. 408, datë 27.07.2016
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	UMASR Nr. 365, datë 23.10.2020
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	VBA Nr. 46 datë 13.07.2018
8	Cikli i studimit:	Cikli I dytë, Master Profesional
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 vit
10	Kreditet në total (ECTS):	60 kredite
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	8 PAE / 1 PAK
18	Numri i studentëve:	2021-2022, 17 studentë 2022-2023, 13 studentë 2023-2024, 17 studentë
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit Master Profesional në “Sistemet e Informacionit në Biznes” në UMSH është një program njëvjeçar me 60 ECTS, i ndërtuar në përputhje me kritere të ndryshme si Ligji për Arsimin e Lartë, Standardet Shtetërore të Cilësisë, dhe Udhëzimet e MAS dhe të ASCAL. Ky program siguron një vazhdim të thelluar të studimeve Bachelor në fushën e Sistemeve të Informacionit në Biznes, duke u përqendruar në aplikimin praktik të njohurive në tregun e punës, jo vetëm shqiptar, por edhe më gjerë.

Programi synon të pajisë studentët me njohuri të thella për ndërtimin dhe zbatimin e sistemeve të informacionit në subjekte të ndryshme biznesi, të formojë specialistë të aftë në teknologjinë e informacionit dhe të promovojë kërkimin e vazhdueshëm në fushat e inovacionit dhe ekonomisë. Nëpërmjet një kurrikule që përfshin lëndë si Analiza dhe Projektimi i Sistemeve të Informacionit, Programimi i Avancuar në Web dhe Siguria e Sistemeve të Informacionit, studentët mësojnë të lidhin teorinë me praktikën dhe të zhvillojnë projekte aplikative në fusha si kontabiliteti dhe menaxhimi.

Përveç mësimdhënies teorike, programi përfshin praktika mësimore që mund të kryhen në institucione me të cilat Universiteti ka marrëveshje bashkëpunimi ose në vendet e punës së studentëve. Kjo i mundëson studentëve të aplikojnë njohuritë në mjedise reale pune, duke rritur aftësitë e tyre profesionale dhe përgatitjen për tregun e punës.

Pas diplomimit, studentët kanë mundësi të punësohen në sektorin publik ose privat si specialistë të teknologjisë së informacionit, zhvillues faqesh interneti, programues, ose në menaxhimin e databazave dhe rrjeteve. Programi gjithashtu ofron mundësi për pjesëmarrje në leksione të hapura me profesionistë të njohur nga fusha e teknologjisë, duke u ofruar studentëve një perspektivë më të gjerë mbi trendet aktuale dhe praktikat më të fundit në teknologjinë e informacionit.

Referenca: <https://www.umsh.edu.al/media/6613bd62b93c3.pdf>



3



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;


Grupi i Eksperteve të Vlerësimit të Jashtëm përbëhet nga dy anëtarë: **Dr. Gloria TYXHARI** dhe **Dr. Senada BUSHATI**, me mbështetjen e Koordinatorit Teknik të ASCAL, Msc. Arbri Ndreka.

Procesi i vlerësimit të jashtëm ka filluar me dorëzimin nga ana e Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë të Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (RVB) si dhe dosjes së vetëvlerësimit (DVV) me dokumentacionin mbështetës.

Ekspertët u njohën me RVB dhe DVV nëpërmjet sistemit të menaxhimit elektronik AMS të ASCAL.

Mbi bazën e një agjende të përcaktuar nga ASCAL në bashkëpunim me Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë, në datat 12 dhe 13 Shkurt 2024, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) vizitoi institucionin dhe realizoi një sërë takimesh e intervistash me Dekanin e Fakultetit të Informatikës (FI), Përgjegjësin e Departamentit të Informatikës së Biznesit, me Grupin e Vlerësimit të Brendshëm të programit (GVB), me stafin akademik të programit të studimit (efektiv dhe me kontratë), me studentët e programit të studimit, me përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore dhe e Rekrutimit, me përfaqësues të Zyrës së Mardhënieve me Jashtë, me përfaqësues të Zyrës së Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Kurrikulave, me përfaqësues të Zyrës së Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës. Gjithashtu GVJ, zhvilloi vizita në Sekretarinë Mësimore, si dhe u njoh me mjediset e zhvillimit të procesit mësimor si dhe Bibliotekën.

Raporti i përgatitur përmbledh rezultatet e shqyrtimit të dokumentacionit të DVV, si dhe të informacionit të mbledhur gjatë vizitës në Institucion.



SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr. 46, date 13.07.2018, datë janë:

1. IAL-ja të realizojë një studim tregut të punësimit të mundshëm për studentët që diplomohen në këtë program studimi.
2. IAL-ja të hartojë një plan mbi vlerësimin dhe analizimin e shkallës dhe cilësisë së punësimit të studentëve të diplomuar vit pas viti, dhe përshtatshmërinë e këtij programi me tregun real të punës si dhe kërkesat e këtij të fundit.

II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

1. Për rekomandimin e parë institucioni ofron dokumentin: Evidenca nr 29. Analiza e tregut të punës.pdf. Në këtë dokument realizohet analiza e tregut të punës për programin e studimit Master Profesional në Sistemet e Informacionit në Biznes, duke listuar seksionet si mëposhtë:
 - i. Hyrje
 - ii. Metodologjia e studimit
 - iii. Vëzhgimi i tregut për programet Master që ofron Fakulteti i Informatikës në UMSH
 1. analiza e ofertës universitare
 2. analiza e tregut universitar të shkencave ekonomike dhe informatike në nivel master
 3. struktura e ofertës universitare
 - iv. Si i përgjigjet programi i studimit nevojave të tregut të punës.
 1. kompetencat dhe mundësitë e punësimit të studentëve që përfundojnë studimet në programin MP SIB.

GVJ duke shqyrtuar përmbajtjen e këtij dokumenti vë re se janë kapur për tu trajtuar një sërë çështjesh të rëndësishme. Nën disa prej tyre vërehet re një trajtim jo i thelluar. Për këtë GVJ rekomandon përmirësimin e tij me detaje të cilat i vlejné programit të studimit. Një përmirësim i mundshëm i këtij raporti mund të përfshijë detaje të tjera mbi:

- i. **Kërkesa për aftësi dhe kompetenca:** që nënkuptojnë identifikimin dhe analizimin e aftësive dhe kompetencave specifike që janë të kërkuara dhe të vlerësuara nga punëdhënësit. Kjo përfshin: **Aftësitë teknike** - që lidhen drejtpërdrejt me njohuritë dhe përvojën në përdorimin e teknologjisë dhe metodave specifike në fushën e SIB, **Soft skills** - të cilat nuk lidhen drejtpërdrejt me teknologjinë, por janë thelbësore për performancën në vendin e punës dhe **Certifikimet dhe kualifikimet** - që dëshmojnë aftësitë dhe njohuritë e fituara nga individët përmes trajnimeve dhe kurseve specifike. Këto janë të rëndësishme sepse ato mund të jenë kërkesë specifike nga punëdhënësit ose të rritin konkurrencën e kandidatëve në tregun e punës. Institucioni mund të

mbledhë dhe analizojë këto informacione për të siguruar që programi i studimit të jetë në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe që studentët të jenë të përgatitur mirë për të plotësuar këto kërkesa.

- ii. **Mundësitë e Punësimit:** trajtohen në dokumentin e ofruar nga IAL si listë se ku mund të punojnë studentët e diplomuar në programin MP SIB. Ndërkohë mund të jepen informacione mbi **Përshkrimet e punëve** apo dhe përgjegjësitë për secilin pozicion si dhe **Statistikat e punësimit** ku ofrohen informacione mbi shkallen e punësimit, sektorët e punësimit, pagat mesatare për të diplomuarit në këtë program, etj.
- iii. **Opinioni i Punëdhënësve:** në të cilin mund të ofrohet feedbacku i dhënë nga punëdhënësit për të kuptuar pritshmëritë e tyre në përgjithësi për programin e studimit dhe sugjerimet e tyre për përmirësime, si dhe feedback-un e tyre me të diplomuarit aktualë, e realizuar kjo nëpërmjet sondazheve apo teknikave të tjera.

Përfshirja e këtyre çështjeve do të ndihmojë në krijimin e një studimi të plotë dhe të detajuar, që mund të ndihmojë IAL-në në përmirësimin e programit të studimit dhe në përgatitjen më të mirë të studentëve për tregun e punës.

2. Referuar rekomandimit të dytë, IALnuk ofron një dokument specifik i cili harton analizimin e shkallës dhe cilësisë së punësimit të studentëve të diplomuar vit pas viti për programin e studimit MP Sistemet e Informacionit në Biznes. Ndërkohë referuar dokumentit: [Evidenca nr 29. Analiza e tregut të punës.pdf](#), shpjegohet dhe analizohet dhe përshtatshmëria e këtij programi studimi me tregun real të punës si dhe kërkesat e këtij të fundit.

Më datë 02.10.2024, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr.2/32 Prot., datë 29.07.2024 dërgohet në institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL, përmes sistemit AMS, më datë 16.10.2024 dhe me shkresë zyrtare Nr.2/47 Prot., datë 17.10.2024, ka dërguar komente mbi draft raportin.

GVJ pasi u njoh me komentet e institucionit mbi draft raportin, sqaron si vijon:

1. Lidhur me komentin e institucionit për SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT (RVJ 5/92)

GVJ: 1. Referuar Rekomandimit të parë, institucioni ofron dokumentin: [Evidenca nr 29. Analiza e tregut të punës.pdf](#). Në këtë dokument realizohet analiza e tregut të punës për programin e studimit Master Profesional në Sistemet e Informacionit në Biznes, duke listuar seksionet si më poshtë:

- i. Hyrje
- ii. Metodologjia e studimit
- iii. Vëzhgimi i tregut për programet Master që ofron Fakulteti i Informatikës në UMSH
 - 1. analiza e ofertës universitare
 - 2. analiza e tregut universitar të shkencave ekonomike dhe informatike në nivel master
 - 3. struktura e ofertës universitare
- iv. Si i përgjigjet programi i studimit nevojave të tregut të punës.
 - 1. kompetencat dhe mundësitë e punësimit të studentëve që përfundojnë studimet në programin MP SIB.

GVJ duke shqyrtuar përmbajtjen e këtij dokumenti vë re se janë kapur për tu trajtuar një sërë çështjesh të rëndësishme. Në disa prej tyre vihet re një trajtim jo i thelluar. Për këtë GVJ rekomandon përmirësimin e tij me detaje të cilat i vlejné programit të studimit. Një përmirësim i mundshëm i këtij raporti mund të përfshijë detaje të tjera mbi:

- iv. **Kërkesa për aftësi dhe kompetenca:** që nënkuptojnë identifikimin dhe analizimin e aftësive dhe kompetencave specifike që janë të kërkuara dhe të vlerësuara nga punëdhënësit. Kjo përfshin: **Aftësitë teknike** - që lidhen drejtpërdrejt me njohuritë dhe përvojën në përdorimin e teknologjisë dhe metodave specifike në fushën e SIB, **Soft skills** - të cilat nuk lidhen drejtpërdrejt me teknologjinë, por janë thelbësore për performancën në vendin e punës dhe **Çertifikimet dhe kualifikimet** - që dëshmojnë aftësitë dhe njohuritë e situara nga individët përmes trajnimeve dhe kurseve specifike. Këto janë të rëndësishme sepse ato mund të jenë kërkesë specifike nga punëdhënësit ose të rritin konkurrencën e kandidatëve në tregun e punës. Institucioni mund të mbledhë dhe analizojë këto informacione për të siguruar që programi i studimit të jetë në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe që studentët të jenë të përgatitur mirë për të plotësuar këto kërkesa.
- v. **Mundësitë e Punësimit:** trajtohen në dokumentin e ofruar nga IAL si listë se ku mund të punojnë studentët e diplomuar në programin MP SIB. Ndërkohë mund të jepen informacione mbi **Përshkrimet e punëve** apo dhe përgjegjësitë për secilin pozicion si dhe **Statistikat e punësimit** ku ofrohen informacione mbi shkallen e punësimit, sektorët e punësimit, pagat mesatare për të diplomuarit në këtë program, etj.
- vi. **Opinion i Punëdhënësve:** në të cilin mund të ofrohet feedbacku i dhënë nga punëdhënësit për të kuptuar pritshmëritë e tyre në përgjithësi për programin e studimit dhe sugjerimet e tyre për përmirësime, si dhe feedback-un e tyre me të diplomuarit aktualë, e realizuar kjo nëpërmjet sondazheve apo teknikave të tjera.

Përfshirja e këtyre çështjeve do të ndihmojë në krijimin e një studimi të plotë dhe të detajuar, që mund të ndihmojë IAL-në në përmirësimin e programit të studimit dhe në përgatitjen më të mirë të studentëve për tregun e punës.

2. Referuar rekomandimit të dytë, IAL nuk ofron një dokument specifik i cili harton analizimin e shkallës dhe cilësisë së punësimit të studentëve të diplomuar vit pas viti për programin e studimit MP Sistemet e Informacionit në Biznes. Ndërkohë referuar dokumentit: Evidenca nr 29. Analiza e tregut të punës.pdf, shpjegohet dhe analizohet dhe përshtatshmëria e këtij programi studimi me tregun real të punës si dhe kërkesat e këtij të fundit.

GVB, Objeksion/Sqarim UMSH: Referuar rekomandimeve të mësipërme, Analiza e Tregut është realizuar nga ekspertët fushës, të cilët janë kujdesur që të ndërtojnë një pasqyrë reale, bazuar në të dhëna zyrtare të ofruara nga institucionet përkatëse si INSTAT dhe ASCAL, në përputhje me nevojat e Universitetit. Më konkretisht, lidhur me mundësitë ku mund të punojnë studentët e diplomuar në programin MP SIB, në analizën e tregut është vendosur një listë me pozicionet e punës dhe jo përshkrimet e punëve apo përgjegjësitë për secilin pozicion, pasi çdo institucion/kompani ka përshkrimet dhe përgjegjësitë specifike.

GVJ: Në mbështetje të analizës së bërë, disa elementë të rëndësishëm që duhen theksuar janë:

Rekomandimi 1:

- i. **Analiza jo e thelluar e aftësive dhe kompetencave:** Institucioni ka paraqitur një listë pozicionesh pune, por mungon një analizë e thelluar e aftësive dhe kompetencave specifike që kërkohen për këto pozicione. GVJ mendon që analiza mos mjaftohet me listimin e mundësive të punësimit, por të analizohen aftësitë teknike dhe të buta (soft skills) të nevojshme, si dhe të identifikohen certifikime apo kualifikime të rëndësishme për të qenë konkurrues në tregun e punës. Ky nivel detajimi është thelbësor për të siguruar që programi përgatit studentët në përputhje me kërkesat reale të punëdhënësve.
- ii. **Përshkrimi i roleve dhe përgjegjësi në pozicionet e punës:** Ndërsa GVB argumenton se përshkrimet ndryshojnë sipas institucioneve, një përmbledhje e përgjithshme e detyrave kryesore për çdo pozicion është e nevojshme për t'i orientuar më mirë studentët.
- iii. **Feedback nga punëdhënësit dhe analiza e përmirësimit të programit:** Në mungesë të një mekanizmi të strukturuar për mbledhjen e feedback-ut nga punëdhënësit, është e vështirë të konfirmohet se programi po evoluon në përputhje me nevojat e tregut. Standardi kërkon jo vetëm kontakt me palët e interesuara, por edhe integrimin e sugjerimeve të tyre në zhvillimin e programit, gjë që kërkon prova të qarta dhe dokumentacion të verifikueshëm.

Rekomandimi 2: Analiza e shkallës së punësimit

Mungesa e një analize të mirëfilltë për shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve vit pas viti përbën një tjetër boshllëk. Institucioni ka ofruar të dhëna nga INSTAT dhe ASCAL, por nevojitet një analizë specifike për të diplomuarit e këtij programi, e cila do të tregonte nëse dhe si po përmbushen objektivat e punësimit të programit.

Duke qenë se programi është akredituar më parë dhe ka të dhëna, ka vend për përmirësim dhe plotësim të këtyre sugjerimeve.

2. Lidhur me komentën e institucionit për Standardi I.2, Konkluzione, (RVJ fq. 13/92)

GVJ: Analiza e programit Master Profesional në "Sistemet e Informacionit në Biznes" tregon përputhje të fortë me fushën akademike dhe kërkesat e njësisë kryesore të institucionit. Përgjigja e institucionit ndaj kërkesave të tregut për inovacion dhe specializim është e qartë, përmirësimi i kapaciteteve njerëzore dhe përfshirja e ekspertëve të jashtëm do të garantonte vazhdimësinë e këtij trendi. Në aspektin e trajnimeve profesionale të mëtejshme, nevoja për organizim të aktiviteteve të përditësuara dhe përfshirjen e studentëve në projekte praktike janë thelbësore për përgatitjen e tyre në tregun e punës. Për të siguruar cilësi dhe përputhje me standardet kombëtare dhe europiane, rekomandohet vazhdimi i procesit për miratimin e planit të kodifikimit të programeve të studimit dhe monitorimi i përpjekjeve për përshtatje me trendet më të fundit të fushës së IT-së.

GVB: Objeksion/Sqarim UMSH: Në lidhje me miratimin e planit të kodifikimit, ky proces nuk është finalizuar akoma në përputhje me standartet kombëtare dhe europiane nga MASR, Universiteti vazhdon të jetë i angazhuar për të ndjekur zhvillimet më të fundit dhe për të përmirësuar cilësinë e programeve të studimit, në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe nevojat e studentëve.

GVJ: Bazuar në analizën e standardit I.2 dhe duke marrë në konsideratë përgjigjen e institucionit, konstatohet se një nga kriteret kyçe përmban kërkesën për kodifikimin e programeve të studimit në përputhje me udhëzimet kombëtare dhe evropiane. Në këtë drejtim, është thelbësore që mungesa e finalizimit të këtij procesi të trajtohet me prioritet, pasi përmbushja e këtij kriteri ndikon drejtpërdrejt në cilësinë dhe legjitimitetin e programit. Për të shmangur pengesa të mëtejshme dhe për të siguruar pajtueshmërinë me standardet, sugjerohet përfshirja e një përmbledhjeje të qartë të hapave të ndërmarrë deri tani dhe dokumentacionit të dorëzuar. Dokumentimi i përpjekjeve të deritanishme dhe përmirësimeve të planifikuara ofron transparencë.

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon

3. Lidhur me komentën e institucionit për Standardi I.3, Konkluzione, (RVJ fq. 16/92)

GVJ: Analiza e marrëdhënieve bashkëpunuese në kuadër të programit të studimit "Sistemet e Informacionit në Biznes" tregon një përshtatje të mirë me standardet e institucionit të arsimit të lartë. Institucioni ka zhvilluar marrëdhënie të thella me institucione, kompani, dhe organizata të ndryshme, duke përfshirë partneritetet ndërkombëtare. Këto marrëveshje kanë sjellë kontribut në përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit, duke përfshirë organizimin e praktikave profesionale dhe bashkëpunimin për realizimin e kërkimeve shkencore. Megjithatë, është vërejtur një mungesë dokumentimi në analizën vjetore të përfitimeve nga këto marrëveshje, e cila është një aspekt që duhet adresuar për të siguruar monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të këtyre marrëdhënieve. Rekomandohet që institucioni të dokumentojë dhe të analizojë me thellësi

përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit, si dhe të hartojë raporte analitike të përfitimeve në përputhje me standardet dhe nevojat e institucionit.

Në përfundim, GVJ vlerëson se ky rekomandim është përmbushur kryesisht

GVJ: Objeksion/Sqarim UMSH: Institucioni ynë përmban një dokument të detajuar nga përfitimet e marrëveshjet të bashkëpunimit. Në kuadër të përmirësimeve, në procesin e hartimeve të raporteve analitike reflektohen përfitimet konkrete të këtyre marrëdhënieve. Duke përfshirë rezultatet nga praktikat profesionale, kërkimet shkencore dhe aktivitetet e përbashkëta me partnerët tanë. Duhet theksuar se gjatë vizitës në ambientet e institucionit nga GVJ nuk na është kërkuar një raport analitik i përfitimeve në lidhje me marrëveshjet e bashkëpunimit.

Gjithashtu kemi ndërmarrë hapa për të përforcuar mekanizmat e monitorimit të vazhdueshëm, në mënyrë që marrëveshjet e bashkëpunimit të kontribuojnë në mënyrë të matshme në cilësinë e programeve tona dhe zhvillimin profesional të studentëve. Këto përpjekje do të forcojnë më tej marrëdhëniet tona me partnerët ndërkombëtare dhe lokalë, dhe do të garantojnë transparencë në vlerësimin e përfitimeve në përputhje me standardet dhe nevojat e institucionit.

GVJ: Bazuar në analizën tonë të Standardit I.3, theksojmë se, megjithëse institucioni ka bërë përpjekje për përmirësim, mbetet e nevojshme që dokumentimi i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit të jetë i strukturuar dhe i analizuar në mënyrë të thelluar, në përputhje me kërkesat e standardeve. Raportet vjetore duhet të pasqyrojnë qartë ndikimin konkret të bashkëpunimeve në cilësinë e programeve dhe përfitimet për studentët, duke mundur një monitorim dhe përmirësim të vazhdueshëm. Edhe pse gjatë vizitës sonë nuk u kërkuar specifikisht një raport analitik, mbetet përgjegjësi e institucionit që këto të dhëna të jenë të aksesueshme dhe të përgatitura sipas kërkesave, për të garantuar transparencë dhe përputhshmëri të plotë me standardet e akreditimit.

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon

4. Lidhur me komentën e institucionit për Standardi II.2, Konkluzione, (RVJ fq. 23/92)

GVJ: Struktura akademike dhe personeli akademik nën Fakultetin e Informatikës, në përputhje me ligjin aktual në fuqi, janë të përshtatshme për programin e studimit "Sisteme Informacioni në Biznes". Megjithatë, ndryshimet në numrin e personelit akademik duhet të reflektohen në dokumentacionin zyrtar dhe të koordinohen në përputhje me rregulloret e fakultetit dhe programit. Po ashtu, duhet të caktohet një koordinator i programit të studimit për të përcaktuar përgjegjësinë dhe ecurinë e programit dhe praktikat profesionale në përputhje me objektivat e tij, duke siguruar që dokumentacioni për këtë të jetë i plotë dhe i dokumentuar siç parashikohet nga rregulloret institucionale.

Në përfundim, GVJ vlerëson se ky rekomandim është përmbushur kryesisht

GVJ: Objeksion/Sqarim UMSH: Institucioni dëshiron të sqarojë se ne kemi aktualisht një koordinator të caktuar për programin Master Profesional në "Sistemet e Informacionit në Biznes" i cili është përgjegjës për ecurinë e programit dhe menaxhimin e praktikave profesionale në

përputhje me objektivat e studimit. Koordinator i programit është plotësisht funksional dhe përmbush detyrimet e tij sipas rregulloreve të institucionit.

Ndryshimet në numrin e personelit akademik reflektohen në mënyrë të vazhdueshme në dokumentacionin zyrtar dhe janë në përputhje me rregulloret e fakultetit dhe të evidentuara me evidencë ku deklarohet se stafi akademik i Fakultetit të Informatikës përbëhet nga 39 anëtarë dhe Departamenti Informatikë Biznesi përbëhet nga 13 anëtarë, por duhet theksuar që ka një lapsus në shkrimin e RVB nga grupi dhe mbetet informacion i saktë, ai i bazuar në evidencë.

GVJ: Institucioni thekson se ka një koordinator për programin MP SIB, megjithatë nuk është paraqitur një vendim formal ose dokument zyrtar që vërteton këtë emërim. Për të përmbushur standardet dhe për të shmangur paqartësitë, sugjerohet që ky vendim të formalizohet dhe të përfshihet në dokumentacionin zyrtar të akreditimit.

Lidhur me numrin e personelit akademik, GVJ merr parasysh të dhënat e ofruara nga evidencat.

Raporti në këtë pikë ndryshon (Standarti II.2 Përmbushet Plotësisht).

5. Lidhur me komentin e institucionit për **Standardi II.4, Konkluzione**, (RVJ fq. 30/92)

GVJ: Struktura dhe organizimi i programit janë në përputhje me objektivat formuese dhe nivelin e kualifikimit sipas standardeve kombëtare dhe evropiane. Megjithatë, ka disa sfida dhe fusha për përmirësim. Për shembull, emërtimet e lëndëve dhe përmbajtja e tyre duhet rishikuar për të siguruar që përmbajnë njohuri të thella dhe të përditësuara për kërkesat e tregut të punës. Po ashtu, përditësimi i literaturës së lëndëve përmban një sfidë, duke pasur parasysh nevojën për të siguruar që materialet e përdorura janë të freskëta dhe të përshtatshme për industrinë aktuale. Rekomandimet përfshijnë rishikimin e emërimit të lëndëve, përditësimin e literaturës me burime më të reja dhe të përputhshme dhe përjasjen më të mirë të veprimtarive teorike dhe praktike për të garantuar formimin e thelluar profesional dhe përputhjen me kërkesat e tregut të punës.

Në përfundim, GVJ vlerëson se ky rekomandim është përmbushur pjesërisht.

GVJ: Institucioni ynë dëshiron të theksojë se emërtimet e lëndëve dhe përmbajtja e tyre janë rishikuar për të siguruar përputhshmëri me kërkesat e tregut dhe cdo ndryshim në lënd apo module bazohet në përmbajtjen e VKM nr. 41. Gjithashtu, përditësimi i literaturës është një proces i vazhdueshëm, dhe ne jemi të angazhuar për të përfshirë materjale dhe burime të reja në përputhje me zhvillimet më të fundit në industrinë dhe në fushën e teknologjisë së informacionit.

SQAROJMË SE: "Emërtimi E-biznes studime të thelluara" mbazohet në faktin që studentët në programin bachelor zhvillojnë lëndën "E-biznes" dhe në nivelin Master ata thellohen në koncepte më të avancuara në këtë fushë, pasi kanë fituar bazat e nevojshme paraprakisht. Kjo strukturë lejon një vazhdimësi në procesin e mësimdhënies dhe përgatit studentët për të trajtuar tema më komplekse dhe të avancuara në e-biznes.

GVJ: Theksojmë që emërtimet e kurseve duhet të përditësohen duke ju referuar aspektit profesional dhe vazhdimësisë së programeve që ofron fakulteti. Gjithashtu përmbajtja e tyre duhet rishikuar

për të siguruar njohuri të thella dhe të përditësuara për kërkesat e tregut të punës. Përditësimi i literaturës nuk i referohet 5 viteve të fundit. Duke marrë parasysh edhe faktin se elementët sipas vkm.41 qendrojnë, atëherë vlerësimi ndryshon në plotësohet kryesisht.

Raporti në këtë pikë ndryshon (Standarti II.4 Përmbushet Kryesisht).

6. Lidhur me komentën e institucionit për Standardi II.5, (RVJ fq. 32/92)

GVJ: UMSH po bën përpjekje për të nxitur përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit. Megjithatë, ka disa fusha për përmirësim. Rekomandimet përfshijnë nevojën për dokumentim të konsultimeve dhe propozimeve nga institucionet partnerë dhe tregu i punës për përmirësimin e programit, si dhe për të vërtetuar reflektimin e opinionit të studentëve dhe diplomuarve në programin e studimit. Po ashtu, sugjerohet një qasje më e mirë në mbajtjen e lidhjeve me të diplomuarit dhe përfshirjen e tyre në procesin e përmirësimit të programit. E rëndësishme është edhe përditësimi i programit të studimit në përputhje me zhvillimet e fundit në fushat përkatëse, duke përfshirë bashkëpunimin me profesionistë, shoqata dhe institucione të tjera relevante.

GVB: Objeksion/Sqarim UMSH: Sa i përket përfshirjes e studentëve dhe partnerëve në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit, umsh organizon cdo vit takime me ekspertët të tregut të punës kombëtar dhe ndërkombëtar, gjithashtu edhe takimet nga NJSBCZHK nëpërmjet fokus grupeve e cituar në RVB. Këto fokus-grupe kanë ofruar një mundësi të vlefshme për të marrë opinionet e drejtpërdrejta të atyre që janë më të prekur nga procesi mësimor rezultatet e këtij procesi mbahen të dokumentuara në mënyrë konfidenciale dhe profesionale nga njësi përgjegjëse e institucionit të cituar edhe në rregulloren e organizimit të UMSH Neni 76 pika 3.

Një mekanizëm tjetër ndihmës për hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit janë takimet me studentët ALUMNI që zhvillohen cdo vit ku ndahen eksperiencat profesionale. Po ashtu, ne kemi mekanizma të tjerë për të mbledhur mendime nga partnerët dhe tregun e punës, të cilat janë të integruara në proceset tona të rishikimit dhe përmirësimit të programit.

GVJ: Bazuar në standardin II.5, përfshirja e studentëve dhe partnerëve në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit duhet të jetë e strukturuar dhe e dokumentuar qartë, me prova të dukshme dhe të aksesueshme për vlerësim. Ndërsa UMSH ka realizuar takime me ekspertë të tregut dhe Alumni, mungesa e transparencës dhe dokumentimit të këtyre aktiviteteve mbetet një problematikë. Edhe pse rezultatet e fokus-grupeve mbahen konfidenciale, konfidencialiteti nuk përjashton nevojën për prova të verifikueshme që tregojnë ndikimin konkret të këtyre kontributeve në përmirësimin e programit. Kjo mungesë e evidencës justifikon ruajtjen e vlerësimit aktual, duke nënvizuar rëndësinë e transparencës dhe dokumentimit në përmbushjen e standardit.

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon

7. Lidhur me komentën e institucionit për Standardi II.7, (RVJ fq. 38/92)

GVJ: GVJ konstaton se njësia përgjegjëse për programin e studimit ofron mbështetje të rëndësishme për grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore në kuadër të kërkimit shkencor. Për të arritur këtë, institucioni ka siguruar mbështetje financiare dhe infrastrukturale të nevojshme për zhvillimin e këtyre aktiviteteve. Për të përmirësuar transparencën dhe monitorimin e mobilitetit të studentëve, rekomandohet hartimi i një liste të qartë dhe të dokumentuar të aktiviteteve të realizuara në lidhje me këtë. Në përgjithësi, vlerësohet se institucioni ka ndërmarrë hapa pozitivë për të inkurajuar dhe ndihmuar personelin akademik dhe studentët në kërkimin shkencor, por një përmirësim i dokumentimit dhe transparencës së aktiviteteve do të ishte përfitimtar.

Në përfundim, GVJ vlerëson se ky rekomandim është përmbushur kryesisht.

GVB: Objeksion/Sqarim UMSH: Referuar citimit "për të përmirësuar transparencën dhe monitorimin e mobilitetit të studentëve ..." ne deklarojmë se zotërojmë një listë me emrat e studentëve që kanë realizuar mobilitetet dhe përsa i përket dokumentit të aktiviteteve lidhet me dokumentin përcjellës nga institucionet prites (Erasmus* Learning Agreement Student Mobility for Studies) ku reflektohet lista e lëndëve të ndjekura dhe vlerësimi i marrë (Transcript of Records at the Receiving Institution), data e kryerjes së mobilitetit, universiteti dhe të gjitha detajet e tjera plotësuese. Institucioni ka gjithmonë në vëmendje përmirësimin dhe mbështetjen e personelit akademik dhe studentëve në kërkimin shkencor.

GVJ: Lidhur me mobilitetin e studentëve, standardi II.7 kërkon një nivel më të lartë transparence dhe dokumentimi sistematik. Ndërkohë që ekziston një listë e studentëve që kanë kryer mobilitete dhe dokumente përcjellëse si "Learning Agreement" dhe "Transcript of Records", mungon një mekanizëm i qartë për monitorimin dhe publikimin e këtyre të dhënave në mënyrë të qasshme dhe transparente për palët e interesuara. Standardi kërkon që ky proces të jetë i mirëstrukturuar dhe lehtësisht i verifikueshëm, duke siguruar që çdo përvojë e mobilitetit të ketë ndikim të matshëm në formimin akademik dhe personal të studentëve.

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon

8. Lidhur me komentin e institucionit për **Standardi III.1**, (RVJ fq. 42/92)

GVJ: GVJ konkludon se IAL garanton procesin e të nxënës dhe aftësimin profesional e shkencor nëpërmjet metodave dhe praktikave të mira, duke përqendruar vëmendjen në studentët. Procesi mësimor përdor një gamë të gjerë metodash, përfshirë leksione, seminare, punë laboratorike, detyra kursi dhe projekte praktike. Institucioni ka mbështetur marrëdhëniet dhe bashkëpunimet midis personelit akademik dhe studentëve, duke inkurajuar angazhimin e tyre në përmirësimin e procesit të mësimit dhe nxënies. Për të përmirësuar vazhdimisht cilësinë e mësimdhënies, rekomandojmë vazhdimin e trajnimeve për personelin akademik, përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies dhe hartimin e planeve të veprimit për koordinimin dhe përmirësimin e procesit të mësimit dhe nxënies në të ardhmen.

Në përfundim, GVJ vlerëson se ky rekomandim është përmbushur kryesisht.

GVB: Objeksion/Sqarim UMSH: Departamenti i Informatikës së Biznesit në bashkëpunim me Departamentin e Teknologjisë së Informacionit si dhe me mbështetjen e zyrave dhe strukturave të tjera në UMSH harton në formë të përsëritur programe, plane për trajnime dhe angazhime të stafit akademik në evente shkencore brenda dhe jashtë vendit. Ndër të tjera stafi akademik është pjesë edhe e programeve ERASMUS ku në formë të vazhdueshme dhe periodike sipas aplikimeve bëhen pjesë e trajnimeve të ofruara nga Universitetet pritëse. Gjithashtu si dhe është cituar në RVB, një pjesë e madhe e stafit akademik është në proces doktorature.

GVJ: Përfshirja në programe si ERASMUS dhe proceset e doktoraturës janë për t'u vlerësuar, këto aktivitete nuk përbëjnë vetvetiu një mekanizëm të qëndrueshëm dhe sistematik për zhvillimin e vazhdueshëm profesional të të gjithë stafit. Standardi kërkon që planet e trajnimeve dhe angazhimet shkencore të jenë të dokumentuara qartë dhe të lidhen drejtpërdrejt me objektivat e institucionit për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit. Mungesa e një dokumentimi të qartë dhe të strukturuar që provon ndikimin konkret të përfshirjes së stafit në trajnimet dhe aktivitetet shkencore.... Në mungesë të një dokumentacioni të tillë, vlerësimi aktual mbetet i vlefshëm.

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon

9. Lidhur me komentin e institucionit për Standardi III.4, kriteri 1, (RVJ fq. 49/92)

GVJ: GVJ mendon se IAL ka arritur të garantojë në mënyrë të kënaqshme zhvillimin e aftësive profesionale dhe të veçanta të studentëve, por sugjerojmë përmirësimin e mëtejshëm të kurrikulës, azhurnimin e literaturave, si dhe shtimin e trajnimeve, certifikimeve, apo vetë pjesëve praktike në lëndët e profilit, sikurse kemi evidentuar në kriteret e tjera më sipër.

GVB: Objeksion/Sqarim UMSH: Departamentet dhe strukturat përkatëse të Fakultetit të Informatikës janë në funksion të ndryshimeve dhe përmirësimeve të vazhdueshme të kurikulave dhe programeve që ofrojnë, gjithashtu dhe të përmirësimit të cilësisë së stafit akademik dhe mësimdhënies. Lidhur me shtimin e pjesëve praktike në lëndët e profilit, ky element mbahet në konsideratë që në përpilimin e syllabusit, i cili rishikohet cdo fillim viti dhe është në përmirësim të vazhdueshëm aty ku shihet e arsyeshme.

Në përfundim, GVJ vlerëson se ky rekomandim është përmbushur kryesisht.

GVJ: UMSH ka përfshirë stafin në programe si ERASMUS dhe disa janë në proces doktorature, por mungon një plan i qartë dhe dokumentim i rregullt që tregon si këto aktivitete po ndikojnë në përmirësimin e cilësisë akademike dhe të programit. Standardi kërkon që institucionet jo vetëm të përfshijnë stafin në trajnime, por edhe të tregojnë qartë se si këto trajnime ndihmojnë në arritjen e objektivave akademike dhe kërkimore.

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon

10. Lidhur me komentin e institucionit për Standardi III.5, kriteri 1, (RVJ fq. 52/92)

GVJ: Bazuar në RVB dhe në vizitën pranë UMSH, program i studimit MP SIB përmbyll detyrimet akademike me provimin e formimit. Pasi ka shlyer të gjitha detyrimet akademike dhe financiare, studentët kanë të drejtë të hyjnë në provimin e formimit.

Në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion, GVJ konstaton që institucioni harton rregullore të posaçme për provimin final apo atë të mbrojtjes së diplomës. Kështu, këto saktësohen në dokumentet:

- Program Orientues për Provim Formimi
- Rregullore e Programit MP SIB, Kreu VI, Neni 24
- Rregullore e Fakultetit të Informatikës, Kreu X, Neni 51, Neni 51, Neni 52

Nuk është e qartë se në çfarë formë, ky informacion i vihet në dispozicion studentit.

Në RVB është vendosur si referencë Evidenca 26: Udhëzues për provimin e formimit, i cili nuk figuron në listën e dokumentave të vënë në dispozicion. GVJ rekomandon vënien në dispozicion të kësaj evidence. Gjatë vizitës në institucion, GVJ u informua që përcaktimin midis diplomës apo provimit, departamenti e bënte në bazë të mesatares së ciklit të parë. Argumenti për këtë zgjidhje ishte kohëzgjatja një-vjeçare e programit master në fjalë.

Në përfundim, GVJ vlerëson se ky rekomandim është përmbushur plotësisht.

GVJ: Evidenca 26 përcakton udhëzues për provimin e formimit e cila sipas konstatimeve tona rezulton se është dorëzuar. Programi Orientues i provimit të Formimit përpilohet nga Përgjegjësi i Departamentit sipas udhëzimeve të secilit pedagog që ka dhënë lëndën përkatëse. Me pas Përgjegjësi i Departamentit ia vë në dispozicion studentëve brënda afateve të përcaktuara në Rregullore.

GVJ: pavarësisht pretendimit të institucionit, evidenca 26 nuk është e disponueshme në sistem, duke mos lejuar verifikimin e udhëzuesit të provimit të formimit dhe përmbushjen e plotë të kërkesave të standardit.

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon

11. Lidhur me komentin e institucionit për Standardi III.5, kriteri 3, (RVJ fq. 53/92)

RVJ: Në bazë të RVB dhe programit orientues për provimin e formimit, institucioni ka vendosur që për programin MP SIB, duke qënë se fokusi i programit është përvetësimi i aftësive praktike profesionale nga ana e studentit, edhe provimi përfundimtar si detyrim përmbyllës, synon të testojë pikërisht këto aftësi të përfituara nga programi i studimit.

Bazuar në po këto dokumente:

Pjesa e përgjithshme (40 pikë) përmban pyetje nga lëndet: Analiza dhe Projektimi i Sistemeve të Informacionit - 20 pikë dhe E-Biznes Studime të Thelluara - 20 pikë

Pjesa e profilit (60 pikë) përmban pyetje nga lëndët: Analiza dhe Projektimi i Bazave të të Dhënave - 20 pikë, Komunikimi i të Dhënave në Biznes - 20 pikë, dhe Programimi i Avancuar në Ëeb & Aplikime Mobile (nga 10 pikësecila lëndë, 20 pikë në total)

Referuar Planit Mësimor, GVJ vë re se lëndët e tipit A (lëndë bazë) dhe B (lëndë karakterizuese) janë përfshirë të gjitha në provimin e formimit. Ndërkohë nga lëndët e tipit C (lëndë ndërdisiplinore), përfshihet vetëm 1(një) nga 3(tre) lëndët e paraqitura në planin mësimor. GVJ rekomandon mundësisht përfshirjen e të gjitha lëndëve të kategorisë C në provimin e formimit.

Në përfundim, GVJ vlerëson se ky rekomandim është përmbushur plotësisht.

RVB: *Teza hartohet bazuar në udhëzuesin e Provimit të formimit, Evidenca numër 26, dhe Rregullores së Organizimit UMSH, Evidenca Nr 9. Sipas rekomandimit të dhënë nga GVJ në lidhje me përfshirjen e të gjitha lëndëve të kategorisë C në provimin e formimit, kjo do të sillte përfshirjen e të gjithë programit të MP SIB, përveç praktikës, gjë që do të conte në kontroll të të gjitha njohurive të marra në këtë program, e cila nuk është parashikuar në Rregullore dhe as në Udhëzim.*

RVJ: *Evidenca numër 26 nuk është hedhur në sistem dhe GVJ nuk e disponon këtë dokument për ta konsultuar.*

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon

12. Lidhur me komentin e institucionit për Standardi IV.1, kriteri 3, (RVJ fq. 59/92)

GVJ: *Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në UMSH, GVJ konstaton se UMSH ka kontrata pune me secilin punonjës të stafit akademik PAE dhe PAK. Çdo fillim viti zyra e burimeve njerëzore në bashkëpunim me departamentin dhe fakultetin përgjigjës për programin Master Profesional në "Sistemet e Informacionit në Biznes" përditësojnë listën e personelit akademik. Në zyrën e burimeve njerëzore gjenden dosjet e personelit, në të cilat përfshihen kontratat e punës, raportet e vlerësimit gjatë rekrutimit, cv, diploma, kualifikime etj. Kohëzgjatja e kontratës së punës për stafin akademik me kohë të plotë dhe të pjesshëm ishin me kohë zgjatje të ndryshme, sipas specifikave dhe kategorive të ligjit në fuqi, përkatësisht me kohëzgjatje të pa përcaktuar, njëvjeçare, semestrale etj. Rinovimi i kontratës bëhet në bazë të performancës dhe vlerësimit cilësor në fushën e mësimdhënies, punës kërkimore, si dhe duke kontribuar në mbështetjen dhe zhvillimin e institucionit. GVJ vëren paqëndrueshmëri në personelin akademik të angazhuar në programin e studimit, vërehet në evidencat e ofruara nga IAL-ja.*

GVB: *Ndryshimi i personelit akademik ka ardhur në përputhje me strategjinë e IAL-së për rritjen e cilësisë si dhe për të përmbushur sa më mirë kërkesat ligjore për tituj e grada si dhe përfshirjen e personelit akademik efektiv në masën mbi 70%.*

GVJ: *Sa i përket këtij kriteri, citohet fakti që stafi i angazhuar me kohë të plotë nuk ka qëndrueshmëri. Kjo vërehet tek evidencat e ofruara nga IAL-ja, Aneks_Tabela_MP_SIB.pdf, ku*

tabelat që tregojnë informacionin për stafin e angazhuar PAE dhe PAK, paraqesin numrin në rënie përgjatë 3-viteve të fundit..

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.

13. Lidhur me komentin e institucionit për Standardi IV.1, Kriteri 8 (RVJ fq. 60/92)

GVJ: Kurrikula e programit Master Profesional në "Sistemet e Informacionit në Biznes", ka në përbërje Praktikën Profesionale sipas ngarkesës së përcaktuar në Ligjin e Arsimit të Lartë. [Evidenca nr 6. Rregullore e programit MP SIB.pdf]. GVJ rekomandon: që UMSH duhet të ketë një rregullore të miratuar për Praktikën Profesionale, ku shpjegohet procedura e organizimit.

GVB: Në dokumentat e dorëzuara Evidenca Nr. 20, e emërtuar Dosja e Praktikës është përfshirë edhe udhëzuesi për praktikant (bachelor dhe master). Në këtë mënyrë personeli mbikqyrës ndihmon studentët në plotësimin e raportit përfundimtar të praktikës duke ndjekurme përpikmëri të gjitha pikat e përcaktuara në Udhëzuesin për Praktikant.

GVJ: Kurrikula e programit Master Profesional në "Sistemet e Informacionit në Biznes", ka në përbërje Praktikën Profesionale sipas ngarkesës së përcaktuar në Ligjin e Arsimit të Lartë. [Evidenca nr 6. Rregullore e programit MP SIB.pdf]. UMSH ka një udhëzim [Evidenca nr 20. Dosja Praktikës.pdf] të miratuar për Praktikën Profesionale, ku shpjegohet procedura e organizimit dhe menaxhimit.

Raporti në këtë pikë ndryshon (Standarti IV.1 Përmbushet Plotësisht).

14. Lidhur me komentin e institucionit për Standardi IV.2, kriteri 2, (RVJ fq. 61/92)

GVJ: GVJ nga vizita në institucion konstaton se hapësira ku zhvillohen shumica e lëndëve të këtij programi studimi. Sallat kanë hapësirën e nevojshme për të ushtruar mësimdhënien në kushte të mira dhe komode për studentët. Secili mjedis disponon ajrosjen dhe ndriçimin e duhur, sistem mbrojtje nga zjarri edhe ajër të kondicionuar. GVJ sugjeron që IAL-ja të ofrojë një relacion të detajuar mbi ambientet e dedikuara ndaj programit të studimit Master Profesional në "Sistemet e Informacionit në Biznes".

GVB: Në Evidencën nr 42. Relacioni i godinës, janë të pasqyruara mjediset mësimore dhe laboratorike për programet e studimit. Në përputhje me nevojat e programit të studimit, të gjitha orët mësimore për programin e studimit Master Profesional në "Sistemet e Informacionit në Biznes" realizohen në laboratore dhe kjo verifikohet lehtësisht nga orari mësimor. Në relacionin e verifikimit të godinës por edhe në tabelat lidhur me numrin e laboratorëve si edhe në përshkrimin e RVB është shprehur qartë se UMSH disponon 4 laboratore dhe në atë kohë laborator i pestë ishte në proces. Aktualisht UMSH disponon 5 laboratore funksional.

GVJ: GVJ nga vizita në institucion konstaton se hapësira ku zhvillohen shumica e lëndëve të këtij programi studimi. Sallat kanë hapësirën e nevojshme për të ushtruar mësimdhënien në kushte të

mira dhe komode për studentët. Secili mjedis disponon ajrosjen dhe ndriçimin e duhur, sistem mbrojtje nga zjarri edhe ajër të kondicionuar. Në [Evidenca nr 42. Relacioni i Godines.pdf] jepet një informacion rreth infrastrukturës së UMSH por jo specifikisht për programin e studimit. Në dokumentin me komente të ofruar nga UMSH, sqarohet hapësira e dedikuar të programit të studimit. UMSH disponon 4 laboratore dhe në atë kohë laborator i pestë ishte në proces. Aktualisht UMSH disponon 5 laboratore funksional.

Raporti në këtë pikë ndryshon vetëm në shtimin e informacionit detajues.

15. Lidhur me komentin e institucionit për Standardi IV.3, kriteri 1, (RVJ fq. 63/92)

GVJ: Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB, GVJ konstaton se çdo lektor i vendos studentëve në dispozicion syllabusin e lëndës në të cilin ndodhet literatura bazë dhe ndihmëse. [Evidenca nr 24. Syllabuset e lendeve te ofruara per vitin akademik-1.pdf] Materialet në formë elektronike gjëndën në klasat virtuale të krijuar në platformën google classroom. Gjithashtu UMSH disponon një bibliotekë në të cilën të gjithë studentët mund të aksesojnë literaturën e sugjeruar. Referuar syllabus-eve te paraqitura si evidenca, verëhet nje literature ne perputhje me permbajtjen e kursit, e cila ofrohet ne shqip. GVJ rekomandon që të azhurnohet literatura brenda 5 viteve të fundit.

GVB: Bazuar në legjislacionin në fuqi në lidhje me literaturën e detyrueshme për programin e studimit Master Profesional ne "Sistemet e Informacionit në Biznes", master i ofruar në gjuhën shqipe, është detyrim ligjor që literatura bazë të ofrohet në gjuhën e programit (shqip). Rishikimi i literatures bëhet në mënyrë periodike çdo vit dhe është konstatuar që ka mungesë botimesh në gjuhën shqipe. Për këtë arsye shumë lëndë kanë edhe leksione të shkruara nga pedagogu të mbështetura mbi literaturën e fundit të huaj.

GVJ: Ky kriter i referohet 'Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.', prandaj është e rëndësishme të punohet për pasurimin dhe azhurnimin e literaturës në gjuhën shqipe dhe të huaj.

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.

16. Lidhur me komentin e institucionit për Standardi IV.4, kriteri 4 (RVJ fq. 66/92)

GVJ: Sistemi i menaxhimit në UMSH nuk ka të integruar platforma dhe module interaktiv në lidhje me shkëmbimin e informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve. Staf i akademik përdor klasat virtual, përmes Google Classroom, për shkëmbimin e informacionit ndërmjet tyre dhe studentëve. GVJ sugjeron që në sistemin e menaxhimit të UMSH të integrohen platforma të standartizuara që mundësojnë format e komunikimit interaktiv ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.

GVB: Sistemi i Menaxhimit të Studentëve, SMS është një element funksional sistemit të informacionit në ndihmë të studentëve. Shumë informacione që jep sistemi janë të shfrytëzueshme me nivele, gjë që garanton një përdorim strategjik të tyre. Sistemi i siguron studentit marrjen e informacionit në mënyrë të vazhdueshme dhe konfidenciale mbi rezultatet e provimeve dhe mbi ecurinë e studimeve. Ky sistem lejon ndërveprimin student- pedagog në lidhje me bllokimet, ankesat, apo rezultate e provimeve..

GVJ: Standardi IV.4, kriteri 4, ka të bëjë me 'Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve', pra kryesisht ndërveprime të cilat krijojnë lehtësi në komunikimin dhe ndarjen e informacionit ndërmjet palëve. Themi që e tejkalon ndërveprimin student- pedagog në lidhje me bllokimet, ankesat, apo rezultate e provimeve.

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.

17. Lidhur me komentin e institucionit për Standardi IV.4, Konkluzione, (RVJ fq. 67/92):

GVJ: UMSH disponon një sistem të menaxhimit të dedikuar, nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me stafin dhe studentët. E gjithë procedura akademike dhe administrative realizohet përmes këtij sistemi. Sistemi i menaxhimit siguron akses për të gjithë personelin akademik dhe studentët e programit të studimit. GVJ rekomandon që:

- ✓ procesi si përpunohen këto raporte përmes sistemit të menaxhimit të shtohen në evidencë.
- ✓ në sistemin e menaxhimit të UMSH të integrohen platforma që mundësojnë format e komunikimit interaktiv ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.

GVB: Duam t'ju bëjmë me dije se Institucioni zotëron Rregulloren e Sekretarisë Mesimore, ku përkatësisht në nenin 11 dhe 13 përcaktohet qartë se si përpunohen të dhënat, si frekuentimi. notat etj..

GVJ: IAL-ja duhet të evidentojë procedurën e zbatuar përmes SMS sa i përket veprimtarisë akademike dhe asaj administrative. Evidenca [Evidenca nr 41. Udhezues për përdorimin e SMS-se.pdf] paraqet vetëm profilin e lektorit në SMS.

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.

18. Lidhur me komentin e institucionit për Standardi VI.5, Kriteri 2, (RVJ fq. 68/92)

GVJ: GVJ konstaton se UMSH të ardhurat parësore i ka nga tarifat e studentëve të cilat janë pasqyruar në kontratat individuale me secilin nga studentët. Burimet financiare të IAL-së janë të ardhurat e realizuara nga vetë institucioni. Shpenzimet për vitin 2022 janë në vlerën 114,686,891 dhe ato janë të ndara sipas: 43% shpenzime qiraje; 51% shpenzime për shërbime; 6% shpenzime për botime shkencore dhe konferenca. GVJ rekomandon: që të azhurnohet informacioni për buxhetin për vitin 2023

GVB: Në periudhën që janë dorëzuar dokumentat mbi procesin e akreditimit të MP SIB (dhjetor 2023) ende nuk ishin mbyllur pasqyrat financiare për vitin 2023.

GVJ: IAL-ja duhet të azhurnojë informacionin. Vizitat e GVJ janë bërë në vitin 2024, kështu që informacioni duhet të ishte dorëzuar.

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.

19. Lidhur me komentin e institucionit për Standardi V.1, Konkluzione, (RVJ fq. 72/92)

GVJ: GVJ konstatoi se UMSH harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit Master Profesional "Sistemet e Informacionit në Biznes". Universiteti përdor faqen zyrtare të ëeb-it, si mjet komunikimi gjithëpërfshirës. UMSH ofron mundësinë e regjistrimit në këtë program, studentëve shqiptarë, të huaj etj. Universiteti ofron bursa për studentët me arritje të larta dhe bursa sociale. **GVJ rekomandon** që UMSH të përcaktojë mekanizma dhe kritere shtesë për përthithjen e studentëve me mesatare të lartë.

GVB: Institucioni yne është i perkushtuar për të siguruar një proces i qartë dhe transparent duke përdorur faqen zyrtare të ëeb-it si një mjet komunikimi gjithëpërfshirës. Ne lidhje me pranimin e studentëve me arritje të larta. UMSH deshiron të theksojë se tashmë ka kritere të qarta për përthithjen e studentëve me mesatare të lartë, të cilat përfshijnë bursat dhe përfitimet e tjera të ofruara për studentet e dalluar. Këto kritere janë të përfshira në procedurat tona të pranimit dhe janë të disponueshme publikisht në faqen tone. Për më tepër, universiteti ofron bursa për studentët me arritje të larta, , si dhe bursa sociale për ata me nevoja financiare. Ne mbetemi të angazhuar për përmirësimin e zhdueshëm të mekanizmave për të tërhequr studentë të talentuar dhe për të garantuar që proceset tona të jenë gjithmone në përputhje me standardet më të larta. UMSH është i gatshëm të bashkëpunojë më tej për çdo propozim shtesë që mund të përmirësojë procesin e pranimit.

GVJ: ka shpjeguar procedurën përzgjedhëse në referencë me kriteret e Standartit V.1, duke cituar çdo dokument që pasqyron këtë informacion. GVJ konstatoi se institucioni informon të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme për përzgjedhjen e kandidatëve çdo vit akademik. Këto kritere janë të përcaktuara në dosjen e programit të studimit [Evidenca nr 6. Rregullore e programit MP SIB.pdf, Kreu III, Neni 12,15] dhe bëhen publike në faqen zyrtare të UMSH, duke ju referuar edhe legjislacionit në fuqi. ëeb: <https://ëëë.umsh.edu.al/c/110/bursat>. dhe <https://ëëë.umsh.edu.al/c/150/kriteret-e-pranimit>

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.

20. Lidhur me komentin e institucionit për Standardi VI.1, Kriteri 3, (RVJ fq. 82/92)

GVJ: UMSH ofron metoda për vlerësimin periodik të metodave të mësimdhënies dhe kontrollin e njohurive. Në fund të çdo semestri, studentët japin mendimet e tyre përmes një pyetësi [Evidenca nr 36. Formulari i vlereimit të pedagogut nga studentet.pdf]. Ky pyetësor plotësohet në format

elektronik përmes sistemit UMSH. Studentët kanë hapësirë të shprehin pakënaqësitë e tyre, në lidhje me vlerësimin, performancën mësimore, literaturën etj. **GVJ** citon që referenca e paraqitur në GVB për formularin e vlerësimit, 'Rregullore UMSH, Neni 76' nuk ekziston.

GVB: Në dokumentat e dorëzuara. "Rregullore e Organizimit UMSH. Neni 76. pika 2 e emertuar Vlerësimi i Lëndës dhe Cilësisë së Mësimdhënies nga ana e studentëve gjendet informacion në lidhje me pyetësonin formularin e vlerësimit të lëndës dhe pedagogut.

GVJ: Në dokumentat e dorëzuara dhe referencën e shënuar tek RVB, gjithashtu duke ju referuar edhe shpjegimit të GVB, theksojmë që evidenca e ngarkuar në sistemin e ASCAL me emërtimin "Rregullore e Organizimit UMSH. Neni 76. pika 2", shpreh : "Diploma tërhiqet personalisht nga studenti në të kundërt ajo mund të tërhiqet nga një i afërm me paraqitjen e prokurës".

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.

21. Lidhur me komentin e institucionit për Standardi VI.5, Konkluzione, (RVJ fq. 90/92)

GVJ: GVJ konstatoi se UMSH ka një njësi, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulës, NJSBCZHK, e cila bashkëpunon me departamentet dhe fakultetet, në procesin e përmirësimit të cilësisë sipas një frekuence periodike. UMSH publikon rezultatet e vlerësimeve, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. **GVJ rekomandon:** hartimin e një evidence me ndryshimet dhe rishikimet e realizuara në përmirësimin e mangësive dhe dobësive të evidentuara.

GVB: Referuar punës së realizuar nga NJSBCZHK këto raporte dhe evidenca realizohen pas çdo kontrolli dhe evidentimi nga zyra dhe i vendoset në dispozicion Rektoratit, i cili më pas ia kalon Dekanatit dhe Departamenteve apo zyrave përkatëse. Këto raporte dhe evidenca janë konfidenciale dhe nuk mund të jenë pjesë e raportit të përgjithshëm vjetor.

GVJ: Sa i përket konkluzioneve të Standartit VI.5, GVJ ka shprehur qartazi mekanizmin funksional të njësive të IAL-së për procesin e përmirësimit të cilësisë sipas një frekuence periodike dhe rekomandimi i lënë nga GVJ-ja kërkon që IAL-ja të dokumentojë rezultatin, pra atë çfarë bëhet për përmirësimin e dobësive dhe mangësive të gjetura.

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në “Sistemet e Informacionit në Biznes”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	GVJ arrin në përfundimin se programi Master Profesional në “Sistemet e Informacionit në Biznes”, i ofruar nga Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë, është në përputhje dhe në harmoni me interesat kombëtare. Kjo është e shprehur dhe në “Statutin e UMSH”, ku IAL synon të kontribuojë në mbështetje të prioritetëve strategjike dhe interesave të zhvillimit të vendit. Programi Master Profesional në fjalë, duke qënë se ndjek strategjinë dhe vizionin e përgjithshëm të UMSH, në bazë të Statutit të tyre, ka synim të krijojë një institucion të arsimit të lartë cilësor, i cili ofron profesionalizëm, nëpërmjet një edukimi ndërdisiplinor me përputhje me interesat kombëtare. Këtë vizion e shohim të aplikuar dhe në të dhënat e marra për Kërkimin Shkencor 2018-2023. Sipas këtyre dokumenteve GVJ sheh dhe prioritetet e tjera në aspektin mësimor, atë të botimeve, si dhe në zhvillimin e aktiviteteve social-kulturore. <u>Evidenca 1: Statuti UMSH</u> <u>Evidenca 51: Te dhënat për kerkim shkencor stafi akademik.</u> Vizita IAL: Takimi me Dekanin dhe Përgjegjësi i Departamentit
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Në bazë të Statutit të UMSH-së dhe Planit të Zhvillimit Strategjik të UMSH, për zhvillimin e programit Master Profesional në “Sistemet e informacionit në Biznes”, GVJ konstaton që ky program përmbush objektivat strategjike institucionale. Ky program i hapur më parë nga Fakulteti i Shkencave Ekonomike, me ndryshimet strukturore të kësaj IAL, zhvillohet nga Fakulteti i Informatikës, i hapur me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, Nr. 738, datë 15.12.2022, gjë që tregon për GVJ një zhvendosje më të përshtatshme të programit të ofruar dhe përputhje më të mirë në fushën e veprimtarisë. <u>Evidenca 1: Statuti UMSH</u>

	<u>Evidenca 3: Plani i Zhvillimit Strategjik te UMSH-se</u> <u>Evidenca 4: Strategjia e Zhvillimit te Programit Master Profesional ne Sisteme Informacioni ne Biznes</u>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimeve akademike të Institucionit.	Në bazë të dokumentave të IAL si Plani i Zhvillimit Strategjik të UMSH për zhvillimin e programit Master Profesional në “Sistemet e Informacionit në Biznes”, Rregullore e Fakultetit të Informatikës, , si dhe RVB, GVJ arrin në përfundimin se programi i studimit është hartuar në përputhje me strategjinë për zhvillim të IAL. Gjithashtu kjo theksohet edhe në dokumentin Strategjia e zhvillimit te programit MP SIB, sipas te cilit: “Strategjia për programin MP SIB mbështetet në Strategjinë për Zhvillim (2017 - 2021) të UMSH”. GVJ konstaton se në disa dokumenta të rëndësishme të dorëzuara nga IAL (të sipërpërmendura) janë të shprehura qartë dhe në mënyrë të detajuar drejtimet prioritare akademike të tij. Në RVB institucioni shprehet se “<i>ky program ofrohet në përputhje me nevojat e tregut të punës</i>”. Këtë e shohim të shprehur dhe në politikat e brendshme të IAL, sipas dokumentit “ANALIZË E TREGUT TË PUNËS”. Aspekti akademik dhe punësimi i studentëve të Masterit Profesional mendojmë se janë ndër objektivat e rëndësishme të IAL, të cilat përveç politikave të shkruara, GVJ i sheh se jetësuar dhe në aktivitetet universitare. GVJ mendon se programi i studimit të MP SIB emërtohet, organizohet dhe ka strukturë të përputhur me drejtimet akademike të institucionit. Mendojmë gjithashtu se struktura e përzgjedhur (master profesional një vjeçar me 60 ECTS) është një mënyrë e mirë për të nxjerrë shpejt në treg specialistë të fushës (sipas Marrëveshjes së Bolonjës, të cilën e ndjek dhe IAL). GVJ sugjeron që përmbajtja e programeve me natyrë IT, të jetë në vëmendje të vazhdueshme nga IAL, për shkak të dinamikave të fushës. <u>Evidenca 3: Plani i Zhvillimit Strategjik te UMSH-se</u> <u>Evidenca 4: Strategjia e Zhvillimit te Programit Master Profesional ne Sisteme Informacioni ne Biznes</u> <u>Evidenca 5: Rregullore e Fakultetit te Informatikes</u> <u>Evidenca 6: Rregullore e Programit Master Profesional ne Sisteme Informacioni ne Biznes</u> <u>Evidenca 23: Plani Mesimor</u> <u>Evidenca 29: Analize e Tregut te Punes</u> RVB Vizita IAL

Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	Në bazë të Raportit të Vlerësimit të Brendshëm të IAL, konstatohet që programi i studimit është hartuar në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit dhe ka si objektiv të plotësojë nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik lokal dhe kombëtar. Kjo mbështetet edhe nga lista e gjatë marëveshjeve të bashkëpunimit me institucione shtetërore, biznese private, OJF dhe universitete me emër në vend dhe jo vetëm. Gjatë vizitës në institucion, GVJ u njoh në mënyrë të detajuar me projektet si dhe impaktin që kanë pasur ato në ngritjen institucionale. Shkencat kompjuterike në përgjithësi janë pjesë e strategjive kombëtare të zhvillimit si një nga fushat prioritare të tyre. Kjo është në përputhje me trendet globale të zhvillimit, madje mund të themi se Shqipëria ka ende mungesë për specialistë të këtyre fushave. <i>GVJ rekomandon që të vihet në pah ndikimi i projekteve të caktuara, të cilat kontribuojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në cilësinë dhe relevancën e programit të studimit MP SIB.</i> Projekte si Lab AI, të cilat mund të kenë pasur një impakt të qartë në përmirësimin e aftësive të studentëve, duhet të promovohen më tej. <u>Evidenca 3: Plani i Zhvillimit Strategjik të UMSH-se</u> <u>Evidenca 4: Strategjia e Zhvillimit të Programit Master Profesional në Sisteme Informacioni në Biznes</u> <u>Evidenca 5: Regullore e Fakultetit të Informatikës</u> <u>Evidenca 12: Liste e Marëveshjeve të Bashkëpunimit</u> <u>Evidenca 29: Analize e Tregut të Punës</u> RVB Vizita IAL
Konkluzione	<i>Analiza e programit Master Profesional në "Sistemet e Informacionit në Biznes" të Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë tregon përputhje të fortë me interesat kombëtare dhe synimet strategjike të institucionit. Emërtimi i programit dhe struktura e tij janë në përputhje me qëllimet e përgjithshme dhe fushën e veprimtarisë së UMSH. Megjithatë, rekomandohet një përqendrim i vazhdueshëm në përditësimin e përmbajtjes së programeve, duke përfshirë strategji për përshtatjen me dinamikën e fushës së IT-së dhe përhapjen e projekteve inovative që përmirësojnë aftësitë e studentëve. Përmbledhja e programeve duhet të bëhet gjithmonë në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe zhvillimet e fundit në fushën e Sistemeve të Informacionit në biznes.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstron se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Programi i studimit Master Profesional në “Sistemet e Informacionit në Biznes” është ofruar fillimisht nga Fakulteti i Shkencave Ekonomike më 2016. Pas rishtruktimit të institucionit, ky program studimi u ofrua nga Departamenti i Informatikës së Biznesit, Fakulteti i Informatikës. Kjo pasqyron përgjigjen e institucionit ndaj kërkesave të tregut dhe përkushtimin e tij për specializim dhe inovacion në ofrimin e arsimit cilësor. Në bazë të dokumentacionit të dorëzuar nga IAL, rezultojnë se Departamenti i Informatikës së Biznesit ka gjithsej 10 staf PAE nga të cilët, një me titullin “Profesor”, tre me titullin “Doktor”, pesë në “Proces Doktorature” dhe një “Master”. Ky departament gjithashtu ka angazhuar 3 staf PAK nga të cilët një me titullin “Profesor”, një në “Proces Doktorature” dhe një “Master”. Gjatë vitit akademik 2022-2023 institucioni ka të angazhuar në programin MP SIB7 lektorë, si personel efektiv, nga të cilët dy janë me titullin “Profesor” dhe pesë me titullin “Doktor”. Nga të dhënat rezultojnë se nuk janë angazhuar lektorë të ftuar në këtë program. Edhe pse mungesa e lektorëve të ftuar mund të shihet si një mangësi (mungesë e ndërveprimeve me ekspertë të jashtëm), në këtë kontekst ajo tregon se institucioni ka mjaftueshëm kapacitet të brendshëm dhe nuk është i varur nga burime të jashtme për të mbuluar nevojat e mësimdhënies. GVJ sheh si mjaft të rëndësishme shtimin e burimeve njerëzore si dhe rritjen e kapaciteteve në drejtim të lëndëve teknike të programit master, për të rritur dhe cilësinë e diplomës në përgjithësi. Nga vizita në IAL, në takimin me dekanin, shefen e departamentit dhe stafin, u vu re dhe u pohua vështirësia për plotësimin e mëtejshëm të burimeve njerëzore me staf PAE për shkak të tregut të punës, por këto mbeten sfida të cdo departamenti me drejtim IT. Ndërkohë GVJ inkurajon përfshirjen e ekspertëve të jashtëm për të siguruar që programi i studimit vazhdon të jetë i përditësuar me trendet më të fundit dhe praktikën më të mira në fushën e IT-së.

	<u>Evidenca 1: Statuti UMSH</u> <u>Evidenca 7: CV e Stafit Akademik ne programin e studimit</u> <u>Evidenca 8: CV e Stafit Ndhimes ne programin e studimit</u> <u>Evidenca 27: Te dhenat Permbledhese te Stafit Akademik per Programin e Studimit sipas kualifikimit</u> <u>Evidenca 50: Personeli Akademik per cdo Njesi Baze: PAE, PAK, Titujt/Gradat, PNA dhe PA)</u> RVB Vizita ne IAL
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	GVJ konstaton që fusha e studimit të programit master profesional në “Sistemet e Informacionit në Biznes” është në përputhje me fushën akademike dhe atë kërkimore shkencore të njësisë kryesore. Mendojmë që ristrukturimi i IAL dhe krijimi i fakultetit të ri të Informatikës me fokus IT, e ka kthyer vëmendjen e duhur dhe pozicionimin e kësaj programi nën një njësi të përshtatshme. Bazuar në RVB, grupi i punës shprehet se “Sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit mbështetur në direktivat dhe udhëzimet kombëtare dhe evropiane, UMSH ka hartuar planin e kodifikimit të programeve të studimit ku specifikisht MP SIBkodifikohet si 0688 ...”. Ky plan kodifikimi nuk është miratuar ende nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve. <i>GVJ sugjeron të përfshihet dokumenti i dorëzuar pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve si dhe të ndjekë procedurat e nevojshme për të siguruar miratimin e planit të kodifikimit të programeve të studimit nga kjo ministri.</i> Kjo është një garanci më shumë që programet e studimit janë në përputhje të plotë me udhëzimet kombëtare dhe evropiane dhe për të siguruar një bazë të qartë ligjore për funksionimin e tyre. <u>Evidenca: 5 Evidenca 5: Regullore e Fakultetit te Informatikes</u> <u>Evidenca 6: Regullore e Programit Master Profesional ne Sisteme Informacioni ne Biznes</u> RVB
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore,	Fushat e përgjithshme dhe specifike e programit Master Profesional në “Sistemet e Informacionit në Biznes”, konstatohet se është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë. Edhe pse ky program ndërlidhet dhe me disiplina të tjera, shihet se pjesa tjetër plotësohet mjaft mirë dhe nga lektorë të departamenteve të tjera, qofshin këto departamente të Fakultetit të Informatikës, si departamenti i Teknologjisë së Informacionit, ashtu edhe nga lektorë të Fakultetit të Shkencave Ekonomike. Ky harmonizim besojmë se vjen si pasojë e historikut të shkuar të strukturave

të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	institucionale (pjesëe Fakultetit të Shkencave Ekonomike), Gjithsesi, departamenti i Informatikës së Biznesit, i cili është përgjegjës për këtë program studimi, siguron përputhje mes disiplinave të ndryshme. <u>Evidenca 6: Regullore e Programit Master Profesional në Sisteme Informatike në Biznes</u> <u>Evidenca 11: Përmbledhese e Tabelave për Programin</u> <u>Evidenca 23: Plani Mesimor</u> Vitita në IAL
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohej nga institucionet partnere.	GVJ konstaton se ky program nuk është jashtë profilit të institucionit, për pasojë ekspertiza në mbarëvajtjen e tij mbulohet nga vetë IAL.
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtjshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, GVJ konstatoi organizimin e aktiviteteve të ndryshme në fushën e IT, kryesisht takime informuese me përfaqësues nga biznese vendase por jo vetëm si dhe përfaqësues ose staf akademik nga universitete të tjera. Nga takimi në IAL me Dekanin dhe Përgjegjësin e Departamentit u përmend organizimi injëkonference, aktivitet i cili nuk është pasqyruar në listën e aktiviteteve të Organizuar nga Fakulteti i Informatikës. Gjithashtu vihet re se pavarësisht projekteve të ndryshme në rang institucioni, studentët e këtij masteri nuk kanë mundur të jenë pjesë e tyre. Ndërkohë qëvitet re edhe mungesë e trajnimeve qëi referohen atyre me natyrë profesionale të mëtjshme për studentët e diplomuar dhe kjo në bashkërendim me punëdhënësit. <i>GVJ sugjeron që të përditësohet lista e aktiviteteve organizuar nga Fakulteti i Informatikës duke përfshirë edhe konferencat në të cilat studentët e këtij masteri kanë marrë pjesë dhe përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë.</i> Gjithashtu është e rëndësishme përfshirja e këtyre studentëve në projekte të ndryshme si një mjet për të zhvilluar aftësitë e tyre praktike dhe profesionale. <u>Evidenca 12: Listë e Marrëveshjeve të Bashkëpunimit</u> <u>Evidenca 13: Lista e Aktiviteteve Organizuar nga Fakulteti i Informatikës</u> Vizita në IAL

Konkluzione	<i>Analiza e programit Master Profesional në "Sistemet e Informacionit në Biznes" tregon përputhje të fortë me fushën akademike dhe kërkesat e njësisë kryesore të institucionit. Përgjigja e institucionit ndaj kërkesave të tregut për inovacion dhe specializim është e qartë, përmirësimi i kapaciteteve njerëzore dhe përfshirja e ekspertëve të jashtëm do të garantonte vazhdimësinë e këtij trendi. Në aspektin e trajnimeve profesionale të mëtejshme, nevoja për organizim të aktiviteteve të përditësuara dhe përfshirjen e studentëve në projekte praktike janë thelbësore për përgatitjen e tyre në tregun e punës. Për të siguruar cilësi dhe përputhje me standardet kombëtare dhe europiane, rekomandohet vazhdimi i procesit për miratimin e planit të kodifikimit të programeve të studimit dhe monitorimi i përpjekjeve për përshtatje me trendet më të fundit të fushës së IT-së.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësi përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Duke u bazuar tek dokumentat e vëna në dispozicion si dhe nga takimi me stafin PAE PAK, GVJ konstaton se programi Master Profesional në "Sistemet e Informacionit në Biznes" mbështetet nga lëndë dhe staf të cilat mbulohen dhe nga departamente të tjera. Mund të përmendim që, përveç vetë departamentit "Informatikë Biznesi", përfshihen në procesin mësimor dhe "Departamenti i Teknologjisë së Informacionit" si dhe departamente të tjera nga fakulteti i Shkencave Ekonomike. Nga kjo ndërthurje kuptojmë një marrëdhënie të mirë ndër-institucionale në funksion të plotësimit të programit master. Bazuar në rregulloren e Organizimit të UMSH, rregulloren e Fakultetit të Informatikës, rregulloren e Departamentit të Informatikës së Biznesit, shihen të përcaktuara me detaje roli dhe detyrat e Dekanit, Zv. Dekanit, Përgjegjësit të njësive bazë, Përgjegjësit të grupit mësimor, Përgjegjësit të punës kërkimore shkencore, Personelit akademik, etj. <u>Evidence 5: Rregullore e Fakultetit të Informatikës.</u>

	<u>Evidenca 9: Rregullore e Organizimit UMSH</u> <u>Evidence 15: Rregullore e Departamentit te Informatikes se Biznesit</u> <u>Evidenca 27: Te dhenat Permbledhese te Stafit Akademik per Programin e Studimit sipas kualifikimit</u> <u>Evidenca 50: Personeli Akademik per cdo Njesi Baze: PAE, PAK, Titujt/Gradat, PNA dhe PA)</u> Takimi IAL
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	GVJ konstaton që në bazë të dokumentave të vëna në dispozicion nga Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë& Erasmus+, IAL ka aktualisht 27 marrëveshje bashkëpunimi me kompani, institucione të rëndësishme në vend, OJF si p.sh. Akademia e Shkencave, The headhunter Shpk, Intesa SanPaolo Bank, Qendra Didaktive Irisoft, Qendra për studime të krahasuara dhe ndërkombëtare, etj. Gjithashtu ka edhe 36 marrëveshje bashkëpunimi me IAL të tjera Brenda dhe jashtë vendit si; Universiteti Bujqësor, Universiteti Italian Catania, VUZF University, etj. Në bazë të dokumentave dhe takimit nga afër me përfaqësuesin e zyrës së Marrëdhënieve me Jashtë dhe Erasmus+, vëmë re dhe një fokus të rëndësishëm në aktivitetet dhe partneritetet në fushën e IT. Përvec institucioneve publike e private, GVJ konkludon që IAL ka vendosur marrëdhënie të mira dhe me institucione homologe në shtete të ndryshme. <u>Evidenca 12: Liste e Marrëveshjeve te bashkepunimit</u> <u>Evidenca 17: Lista e IAL qe UMSH ka marreveshje Bashkepunimi Vizita IAL</u>
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe	GVJ evidentoi se institucioni ka lidhur një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione, organizata profesionale dhe biznese të ndryshme. Qëllimi dhe objektivat e këtyre marrëveshjeve kishin në fokus realizimin e objektivave të programve të studimeve për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikave në bashkëpunim me punëdhënësin. Fokus i tyre janë dhe internshipet e studentëve. Sipas RVB dhe vizitës në IAL, kompanitë të cilat bashkëpunojnë me departamente të ndryshme në UMSH, janë shprehur të hapura në bashkëpunim për internshipet, leksionet e hapura, vizitat në kompani etj. Gjithashtu gjatë takimeve me përfaqësues të ndryshëm të UMSH shprehet qartëse universiteti do të vijoje orientimin në bazë të kërkesave të tregut dhe në përputhje me strategjitë për zhvillimin kombëtar, duke mos e përjashtuar mundësinë e përditësimit të kurrikulave. GVJ e vlerëson si pozitive këtë praktikë.

mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.	GVJ vlerëson se institucioni bashkëpunon me një sërë aktorësh dhe institucionesh. Sic e përmendëm dhe më parë, janë nënshkruar marrëveshje me aktorë të rëndësishëm të botës së biznesit, si dhe institucione publike. Bazuar nëRVB, në listën e dokumentave të dorëzuara, por edhe nga saktësimet e konstatuara gjatë vizitës në institucion, marrëveshjet kanë ndihmuar edhe në realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve. Në dokumenta pasqyrohet qartë mobiliteti për stafin akademik për tre vitet e fundit akademike. Ndërkohë është vënë re që nuk ka studentë të masterit MP SIB të cilët të kenë qënë pjesë e mobiliteteve. <u>Evidenca 12: Liste e Marrëveshjeve të bashkëpunimit</u> <u>Evidenca 18: Liste e Mobilitetit të Stafit Akademik</u> Vizita IAL RVB
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Duke u bazuar tek: dokumentat e vëna në dispozicion (Raporti vjetor i UMSH) dhe vizita në IAL, GVJ mendon se njësia përgjegjëse për programin e studimit Master Profesional në “Sistemet e Informacioni në Biznes”, realizon raporte të cilat më pas përpunohen dhe pasqyrohen nëRaportin Vjetor të IAL. Ndërkohë sipas RVB, Departamenti IB bën një analizë vjetore për përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të programeve të studimit. Një raport i tillë vjetor nuk është vënë në listën e dokumentave që disponon GVJ, pra konstatohet mungesëe dokumentimit të analizës vjetore të Departamentit. Gjithashtu referuar në RVB shihet një listë me formularë që plotësohen gjatë praktikave të ndryshme por nuk ka një dokumentim të një përpunimi analitik të tyre. <i>GVJ rekomandon dokumentimin e analizës vjetore të Departamentit IB me një analizë të thelluar dhe me natyrë analitike, ku duhet të pasqyrojë realizimet, pritshmëritë, konkluzionet e një viti akademik. Si dhe hartimin e raportit të detajuar dhe analitik të përfitimeve që vijnë nga lista e gjatë e marrëveshjeve të Bashkëpunimit.</i> <u>Evidenca 12: Liste e Marrëveshjeve të Bashkëpunimit</u> <u>Evidenca 18: Listë e Mobilitetit të Stafit Akademik</u> <u>Evidenca 22: Raport Vjetor UMSH</u>
Konkluzione	<i>Analiza e marrëdhënieve bashkëpunuese në kuadër të programit të studimit "Sistemet e Informacionit në Biznes" tregon një përshtatje të mirë me standardet e institucionit të arsimit të lartë. Institucioni</i>

	ka zhvilluar marrëdhënie të thella me institucione, kompani, dhe organizata të ndryshme, duke përfshirë partneritetet ndërkombëtare. Këto marrëveshje kanë sjellë kontribut në përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit, duke përfshirë organizimin e praktikave profesionale dhe bashkëpunimin për realizimin e kërkimeve shkencore. Megjithatë, është vërejtur një mungesë dokumentimi në analizën vjetore të përfitimeve nga këto marrëveshje, e cila është një aspekt që duhet adresuar për të siguruar monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të këtyre marrëdhënieve. Rekomandohet që institucioni të dokumentojë dhe të analizojë me thellësi përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit, si dhe të hartojë raporte analitike të përfitimeve në përputhje me standardet dhe nevojat e institucionit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Sipas dokumentacionit të referuar, programi Master Profesional “Sistemet e Informacionit në Biznes”, është e organizuar në module të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS), bazuar në kuadrin ligjor në fuqi. Për një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë, sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një semestri është 30 kredite, kurse në total programi master në fjalë ka 60 kredite. Programi i studimit organizohet sipas veprimtarive formuese (A-E), perkatesisht: A- Lëndë bazë: përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme (6 ECTS)

	B- Lëndë Karakterizuese: Përgatitje për disiplinën shkencore (23 ECTS) C- Lëndë Ndërdisiplinore/Integruese – nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje (15 ECTS) D- Lëndë Plotësuese – gjuhë të huaja, njohuri informatikë, praktika profesionale (6 ECTS) E- Detyrime Përmbyllëse (10 ECTS) <u>Evidenca 4: Strategjia e Zhvillimit të Programit MP SIB</u> <u>Evidenca 6: Regullore e Programit MP SIB</u> <u>Evidenca 23: Plani Mesimor</u>
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparura në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Në dokumentacionet e dorëzuara nga IAL, vërehet një saktësim i pozicioneve të mundshme të punës të specialistëve të IT të cilët diplomohen në programin Master Profesional “Sistemet e Informacioni në Biznes” tek raporti i Analizë e Tregut të Punës, ku Lista e Profesioneve/Mundësive për punësim pas përfundimit të studimeve në MP SIB vijon si me poshtë: 1. Hartues Multimedia dhe Rrjetit të saj 2. Analist Biznesi 3. Konsulent Sistemi 4. Koordinator IT 5. Zhvillues dhe Analistë të aplikacioneve dhe të software-ve 6. Administratore të Sistemeve 7. Arkitekt i Sistemeve 8. Specialistë të Rrjetit të Kompjuterit 9. Zhvillues të Softuerit 10. Menaxher Projekti 11. Analisti i Sistemeve të Bazave të të Dhënave 12. Teknikë Website Ndërsa në dokumentat e tjera (si Rregullore e Programit MP SIB) ku gjithashtu pritet të bëhet ky saktësim informacioni mungon. Pavarësisht kësaj, GVJ beson se ky program studimi formon njohuri të vecanta në fushën e IT e mund të jetë i përshtatshëm dhe i mjaftueshëm për të filluar në pozicione specialist junior ose të mesëm, në ndonjë nga fushat e përmendura më sipër. Programi MP SIB jep njohuri konceptuale dhe praktike në fushën e IT të aplikuar në proceset e ndryshme të bizneseve apo sipërmarrjeve të tjera. Gjithashtu, ky është një program i orientuar nga praktika më shumë se ana akademike (e cila plotësohet më mirë në programet Master i Shkencave). Në përbërje të strukturën

	së tij ofrohen lëndë të cilat nxisin të kuptuarit kritik dhe parimet akademike, vecanërisht lëndët e kategorisë A. Sipas RVB dhe vizitës në IAL, ky program ka objektiva të qarta përsa i përket formimit të studentëve dhe kompetencave profesionale. GVJ konsideron që programi Master Profesional “Sistemet e Informacionit në Biznes”, duke qenë se zhvillohet në një periudhë 1-vjecare, pra e ndarë në dy semestra, ofron njohuri dhe aftësi të mira (por jo të avancuara) qoftë menaxheriale apo teknike. <u>Evidenca 6: Rregullore e Programit MP SIB</u> <u>Evidenca 29: Analize e Tregut të Punës</u>
Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Referuar dokumentacionit të dorëzuar si dhe RVB evidentohet se programi i studimit Master Profesional në “Sistemet e Informacionit në Biznes” e ka të përcaktuar qartësisht ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale si dhe atë të detyrimeve përmbyllëse si më poshtë: 1- Praktika (Tipologji D – Lëndë Plotësuese: gjuhë të huaja, njohuri informatikë, praktika profesionale), kryhet në simestrin e dytë në përfundim të lëndëve të tjera dhe përpara provimit të formimit. Ngarkesa në kredite është 6 (ECTS). Puna e praktikës konvertohet në 120 janë orë në auditor dhe 30 orëpunë e pavarur. 2- Projekti kërkimor dhe Teza (Tipologji E - Detyrime Përmbyllëse), në këtë program studimi realitohet duke ndërmarrë një provim formimi në përfundim të simestri të dytë. Ngarkesa në kredite është 10 (ECTS). Puna e detyrimit përmbyllës konvertohet në 250 orë gjithsej ku 20 janë orë në auditor konsultime të vazhdueshme me pedagogun udhëheqës dhe 230 janë orëpunë e pavarur. <u>Evidenca 6: Rregullore e Programit MP SIB</u> <u>Evidenca 23: Plani Mesimor</u>
Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të	Ky kriter nuk është i aplikueshëm për këtë program studimi.

ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.	
Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	Ky kriter nuk është i aplikueshëm për këtë program studimi.
Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Ky kriter nuk është i aplikueshëm për këtë program studimi.
Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Bazuar në RVB kjo pikë konsiderohet si N/A. Referuar faqes zyrtare të UMSH nuk ka program studimi apo të ketë patur programe studime të cilat plotësojnë kushtet e këtij kriteri. Pra nuk gjenden dokumenta mbështetës për këtë kriter. RVB http://www.umsh.edu.al/
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më	Bazuar në RVB, grupi i punës shprehet se “Sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit mbështetur në direktivat dhe udhëzimet kombëtare dhe europiane, UMSH ka hartuar planin e kodifikimit të programeve të studimit ku specifikisht MP SIBkodifikohet si 0688 ...”. Ky plan kodifikimi nuk është miratuar ende nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve.

tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Bazuar në këtë informacion GVJ sugjeron intensifikim të komunikimit me Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve për të kuptuar statusin e dokumentit të dorëzuar. Është e rëndësishme që UMSH të jetë proaktiv në këtë proces për të përshpejtuar miratimin. RVB			
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Ky program studimi ofrohet nga Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë dhe jo në bashkëpunim me IAL të tjera vendase apo të huaja. Në rregulloren e programit MP SIB, Neni 3 shprehimisht thuhet se “Programi i studimit MP SIB është pjesë përbërëse e studimeve të ciklit të dytë në strukturën akademike të Fakultetit të Informatikës në Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë” <u>Evidenca 6: Rregullore e programit MP SIB</u>			
Konkluzione	<i>Analiza e programit të studimit MP SIB tregon përputhje të mirë me parashikimet ligjore dhe rregullatore vendase, si dhe me standardet ndërkombëtare si Sistemi ECTS. Struktura e programit është e qartë dhe e përcaktuar mirë, duke ofruar një gamë të gjerë lëndësh që promovojnë zhvillimin e njohurive teknike dhe menaxheriale në fushën e IT. Megjithatë, disa dokumente, si Rregullorja e Programit, nuk ofrojnë një saktësim të plotë të pozicioneve të mundshme të punës për studentët e diplomuar. Rekomandohet që institucioni të saktësojë këtë informacion dhe të sigurojë një dokumentim të plotë për qëllime informuese për studentët dhe për tregun e punës. Nëse ka dokumente që nuk janë ende miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve, UMSH duhet të intensifikojë komunikimin për të siguruar miratimin e tyre. Për të plotësuar nevojat për të përmirësuar programin, është e rekomandueshme të hartohet një analizë vjetore e përfitimeve dhe një dokumentim i detajuar i përmbajtjes së programit sipas standardit të përcaktuar.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për	Në bazë të dokumentacionit të dorëzuar, GVJ konstaton që Fakulteti i Informatikës, i hapur me Urdhër të Ministrit të Arsimit

programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.

dhe Sportit, Nr. 738, datë 15.12.2022, ka në përbërje tre njësi bazë: Departamenti i Informatikës së Biznesit; Departamenti i Teknologjisë së Informacionit dhe Qendra Kërkimore: Qendra e Inovacionit dhe Teknologjive Digjitale. Kjo strukturë është në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi.

Gjithashtu GVJ konstaton që departamenti i Informatikës së Biznesit, njësi bazë e Fakultetit të Informatikës, zhvillon të gjitha veprimtaritë e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Referuar dokumentacionit të dorëzuar, (Aneks tabelat përmbledhëse, tabela 1.) numri i personelit akademik i angazhuar pranë Fakultetit të Informatikës gjatë vitit akademik 2022-2023 është 39 anëtarë (27-PAE, 10-PAK dhe 2-PNA/PA). sipas tabelës më poshtë :

IAL	Nr. PAE	Tituj/ Grada	Nr. PAK	Tituj/ Grada	Nr. PNA	Total
Departamenti i Informatikës së Biznesit	10	1-Prof.Dr. 0- Prof.As 3- Dr. 5-Dr.proc. 1- Msc	3	1-Prof.Dr. 0-Prof.As. 0-Dr. 1-Dr.proc. 1-Msc.	0	13
Departamenti i Teknologjisë së Informacionit	10	0-Prof.Dr. 0-Prof.As. 3- Dr. 4-Dr.proc. 2 - Msc	7	1-Prof.Dr. 2-Prof.As. 1-Dr. 0-Dr.proc 2-Msc.	2	19
Qendra Kërkimore, Qendra e Inovacionit dhe Teknologjive Digjitale	7	3-Prof.Dr. 0-Prof.As. 1-Dr. 1-Dr.proc. 2-Msc.	0	0-Prof.Dr. 0-Prof.As. 0-Dr. 0-Dr.proc 0-Msc.	0	7
Total	27		10		2	39

Personeli Akademik pranë Departamentit të Informatikës së Biznesit për vitin akademik 2022-2023 është sipas tabelës më poshtë :

Kualifikimi i stafit akademik të DIB	2022-2023	
	PAE	PAK
Prof. Dr	1	1
Prof. Asoc.	0	0

	Dr/Phd	3	0
	Dr/ Phd Proc.	5	1
	Msc.	1	1
	Gjithsej	10	3
	Ndërkohë referuar RVB deklarohet se stafi akademik i Fakultetit të Informatikës përbëhet nga 43 anëtarë dhe Departamenti Informatikë Biznesi përbëhet nga 15 anëtarë. Shifra të cilat nuk përputhen me ato të paraqitura në dokumentacionin e dorëzuar. GVJ, pavarishtë kësaj, mer parasysh të dhënat e ofruara nga evidencat. <u>Evidenca 1: Statuti UMSH</u> <u>Evidenca 5: Rregullore e Fakultetit të Informatikës</u> <u>Evidenca 15: Rregullore e Departamentit Informatikë Biznesi</u> <u>Evidenca 27: Te dhenat Permbledhese te Stafit Akademik per Programin e Studimit, sipas Kualifikimit dhe Raportet midis tyre.</u> <u>Tabelat Përmbledhëse</u> <u>RVB</u>		
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, si dhe të shprehur në RVB, konstatohet nga GVJ që për zhvillimin e praktikave profesionale angazhohet personeli ndihmës akademik, ku njësitë përgjegjëse për programin MP SIB kanë personel të mjaftueshëm. Gjithashtu në rregulloren e departamentit IB shkruhet se: “Departamenti së bashku me Dekanin e fakultetit janë përgjegjës për realizimin e praktikës profesionale të studentit. Praktika profesionale zhvillohet nën mbikqyrjen e pedagogëve përkatës dhe lista e pedagogëve që monitorojnë praktikën profesionale jep emrat e pedagogëve dhe departamentin nga i cili janë caktuar. <u>Evidenca 15: Rregullore e Departamentit të Informatikës së Biznesit</u> <u>Evidenca 19: Lista e Pedagogëve që Monitorojnë Praktikën Profesionale</u> <u>Evidenca 20: Dosja e Praktikës</u> <u>RVB</u>		
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në	Bazuar në rregulloren e Fakultetit të Informatikës si dhe në Rregulloren e Programit MP SIB, vihet re përcaktimi i rolit, detyrave dhe përgjegjësi që ka koordinatori i programit të studimit. Kjo pohohet dhe në RVB.		

rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Gjatë vizitës në IAL është theksur se për cdo program studimi ka koordinator program dhe se koordinatori i programit të studimit MP SIB është përcaktuar përpara se të fillojë programi. GVJ, bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, ve re se nuk ka dokument i cili vërteton caktimin e një koordinatori për programit e studimit Master Profesional “Sistemet e Informacionit në Biznes”, pranë Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë. <i>Si rrjedhojë GVJ rekomandon vënien në dispozicion të dokumentacionit përkatës që tregon se kjo praktikë është e plotësuar me sukses (p.sh mbështetur në njëvendim të Dekanit të Fakultetit të Informatikës).</i> <u>Evidenca 5: Rregullore e Fakultetit të Informatikës</u> <u>Evidenca 6: Rregullore e Programit MP SIB</u> Vizita IAL			
Konkluzione	<i>Struktura akademike dhe personeli akademik nën Fakultetin e Informatikës, në përputhje me ligjin aktual në fuqi, janë të përshtatshme për programin e studimit "Sisteme Informacioni në Biznes". Megjithatë, ndryshimet në numrin e personelit akademik duhet të reflektohen në dokumentacionin zyrtar dhe të koordinohen në përputhje me rregulloret e fakultetit dhe programit. Po ashtu, duhet të caktohet një koordinator i programit të studimit për të përcaktuar përgjegjësinë dhe ecurinë e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij, duke siguruar që dokumentacioni për këtë të jetë i plotë dhe i dokumentuar siç parashikohet nga rregulloret institucionale.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën	Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, GVJ konstaton se njësitë përgjegjëse për programin e studimit Master Profesional “Sistemet e Informacionit në Biznes”, disponojnë të gjithë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e tij. Këto gjenden në dokumentat e referuara më poshtë. Një pjesë e konsiderueshme e këtij informacioni gjendet dhe në faqen zyrtare online të IAL.

dhe përmbajtjen e programit të studimit.	<u>Evidenca 1: Statuti i UMSH</u> <u>Evidenca 5: Rregullore e Fakultetit të Informatikës</u> <u>Evidenca 6: Rregullore e Programit MP SIB</u> <u>Evidenca 15: Rregullore e Departamentit Informatike në Biznes</u> <u>Evidenca 23: Plani Mesimor</u> <u>Evidenca 24: Syllabuset e Lendeve të Ofruara për Vitin Akademik Vizita IAL</u>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mesimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mesimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Në dokumentin “Plani Mësimor” për programin MP SIB paraqitet ngarkesa mesimore gjithsej, ndarja e lëndëve sipas semestrave, Ngarkesa në ECTS për çdo lëndë, orët në auditor të ndara në: Leksione, Seminare, Laboratore dhe Praktikë, si dhe detyrimet e studentit jashtë auditorit në formën e Punëve të Pavarura. Rregulla të tjera më të detajuara si ai i frekuentimit dhënënyra e vlerësimit të dijeve janë të pasqyruara dhe syllabuset e vecanta të dorëzuara për çdo lëndë. Në bazë të dokumentacionit, IAL përcakton një nivel frekuentimi të mësimi prej 75% të kohës për programet e ciklit të dytë. <u>Evidenca 23: Plani Mesimor</u> <u>Evidenca 24: Syllabuset e lendeve të ofruara për vitin akademik</u>
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Informacionet e nevojshme për studentët në lidhje me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit, GVJ konstaton se ato janë të paraqitura në Rregulloren e Fakultetit të Informatikës në Nenin 32 për transferimet dhe në Nenin 44, Nenin 45 për ekuivalentimet. Gjithashtu në Rregulloren e Programit MP SIB: në kreun III, Neni 12 janë saktësuar kriteret se kush mund ta ndjekë këtë master. Për të rregulluar më tej procesin e transferimeve IAL ka vënë në dispozicion dokumentin “Procedura e transferimit të Studentëve”, sipas të cilit UMSH pranon dhe lejon transferimin e studentëve drejt dhe nga ky institucion. GVJ konstaton se në kriteret e pranimit nuk ka rregulla specifike të listuara në Rregulloren e Fakultetit ose të publikuara në faqen zyrtare të IAL (e vendosur si reference në RVB), pra kushte paraprake për regjistrimin e studentëve. Kjonënkupton që këtë program mund ta ndjekin studentë nga çfarëdo programi bachelor. <u>Evidenca 5: Rregullore e Fakultetit të Informatikës.</u> <u>Evidenca 6: Rregullore e Programit MP SIB</u> <u>Evidenca 56: Permbledhjes së Procedurës së Transferimit të Studentëve</u> http://www.umsh.edu.al/d/347/prove

	<u>RVB</u>
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Bazuar në RVB dhe dokumentacionin e dorëzuar, GVJ konstatoi që informacioni i detajuar për secilën lëndë të programit të studimit paraqitet në programin lëndor të detajuar, i cili miratohet përpara fillimit të semestrit nga përgjegjësi i Përgjegjësi i Departamentit. Gjithashtu gjatë vizitës në institucion GVJ u njoh dhe më tej me formatet e miratuara, të cilat janë të plota dhe ofrojnë informacion të detajuar mbi: të dhënat të përgjithshme të lëndës, qëllimi dhe objektivat, kalendari i temave, forma e vlerësimit, literatura e detyruar dhe ajo e rekomanduar etj. <i>GVJ Sugjeron përmirësimin e vazhdueshëm të mëtejshëm të përmbajtjeve të lëndëve.</i> <u>Evidenca 24: Syllabuset e Lendeve të Ofruara për vitin Akademik</u> Vizita IAL RVB
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	GVJ konstatoi në bazë të dokumentacionit të dorëzuar si dhe nga vizita në institucion gjatë takimeve me anëtarë drejtues të njësisëbazë dhe kryesore se programet mësimore dhe përmbajtjet e tyre lëndore janë në përmirësim të vazhdueshëm. Kjo konsiderohet si një aspekt pozitiv dhe shpesh i domosdoshëm për profile si ai i Masterit Profesional në “Sistemet e Informacionit në Biznes”. GVJ gjithashtu vuri re se një nga arsytet e bashkëpunimit midis institucionit dhe grupit alumni të UMSH, ishte pikërisht mundësia e përmirësimit të programeve sipas asaj çfarë tregjet e punës kërkojnë për këto drejtime. Sipas RVB dhe vizitës në IAL, programi i studimit, plani mësimor, disiplinat mësimore dhe syllabuset, që ofrohen në këtë program rishikohen dhe analizohen nga DIB, në mënyrë periodike përpara fillimit të procesit mësimor. Programet lëndore përditësohen dhe miratohen përpara fillimit të çdo semestri, për të garantuar përmirësimin dhe përditësimin e informacionit për studentët. <i>GVJ vë re se syllabuset janë të dorëzuara vetëm në gjuhën shqipe dhe rekomandon të dokumentohet edhe varianti i tyre në gjuhën angleze.</i> <u>Evidenca 24: Syllabuset e Lendeve të Ofruara për vitin Akademik</u> Vizita IAL RVB
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se programi i studimit MP SIB është i detajuar dhe i organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për</i>

	këtë program disponon të gjithë informacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e tij, siç parashikohet në dokumentacionin zyrtar dhe në faqen zyrtare online të institucionit. Programi përmban një plan mësimor të detajuar, të cilit i përfshihen të gjitha informacionet për lëndët, orët në auditor/jashtë auditorit, dhe të gjitha komponentët formues të programit. Megjithatë, gjatë vlerësimit u konstatua mungesa e dokumentacionit në gjuhën angleze për syllabuset e lëndëve, duke kërkuar një përmirësim në këtë aspekt. Si rekomandim, sugjerohet që të kryhet përditësimi i dosjeve të plotës në dy gjuhë, shqip dhe anglisht, për të siguruar transparencën dhe aksesin më të gjerë për studentët dhe personelin akademik.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	GVJ, pas një shqyrtimi të detajuar të përmbajtjeve të veprimtarive dhe të emërtimeve të tyre, të shpërndarjes së lëndëve dhe ndarjes së tyre në profilet përkatëse të programit Master Profesional në “Sistemet e Informacionit në Biznes”, është i mendimit se disa lëndë duhet të rishikojnë përmbajtjen e tyre në syllabus-et përkatës. Kështu p.sh.: 1. Lënda Menaxhim Projektsh e deklaruar në planin mësimor, është e emërtuar me emrin Menaxhim projektsh në IT në syllabusin e dorëzuar. 2. Sugjerojmë që në emërtimet e lëndëve të hiqen termat “E thelluar”, përfshirja e termave “E Thelluar” mund të krijojë përshtypjen e një përmbajtje të shumëllojshme dhe të thellë, që mund të mos jetë e mundur për të përmbushur brenda një semestri. 3. Në brendësi të programeve të lëndëve duhet të detajohen pjesët praktike në mënyrë më konkrete.

	4. Lëndët të mos jenë bashkim i dy moduleve, pasi ekziston rreziku që dija në to të jepet në mënyrë jo të thelluar (p.sh. Programim i avancuar në Web dhe Aplikime Mobile, etj.) 5. GVJ e shoh si të domosdoshme rishikim i literaturës për lëndët e këtij programi. Duke përjashtuar lëndët Kontabilitet Kosto Drejtimi dhe Modelime dhe Simulime në Biznes (literatura e të cilave ofron një bazë të qëndrueshme me një nivel të përmbajtjes së aktualizuar dhe të rëndësishme për tregun e punës të viteve 2019, 2022, 2020) Lëndët e tjera bazohen në literaturë të vjetëruar të viteve 2009 - 2017. Literatura e bazuar në libra të viteve të kaluara mund të mos përmbajë informacionin më të fundit dhe zhvillimet e fundit në fushën e Sistemeve të Informacionit në Biznes. Kjo mund të bëjë që disa nga njohuritë dhe praktikat e përfshira në këto libra të mos jenë më të vlefshme ose të përputhshme me kushtet e tanishme të tregut të punës. Përditësimi i literaturës me burime më të freskëta dhe të përshtatshme mund të ndihmojë në përmirësimin e përmbajtjes së programit dhe në përgatitjen e studentëve për sfidat aktuale të industrisë. <u>Evidenca 23: Plani mesimor</u> <u>Evidenca 24: Syllabusete Lendeve të Ofruara për Vitin Akademik</u>
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënës dhe kërkimit shkencor.	Sipas GVJ, shpërndarja e ngarkesës mësimore në dy semestrat e kohëzgjatjes së programit është e balancuar dhe mundëson arritjen e rezultateve të pritshme të të nxënës dhe aftësimin profesional. Lëndët në programin e Masterit Profesional nuk kanë të njëjtin numër kreditesh por variojnë nga 4-10 kredite. Ngarkesat nëpër lëndë janë të përafërta. Përjashtim bën lënda Programim i Avancuar në Web dhe Aplikime Mobile, e cila ka 10 ECTS dhe zhvillohet në 2 semestra. Gjithashtu Projekti Kërkimor dhe Tezaka 10 ECTS, pasi është më shumë punë e pavarur jashtë auditorit. <u>Evidenca 23: Plani mësimor</u> <u>Evidenca 24: Syllabusete Lëndëve të Ofruara për Vitin Akademik</u>
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit "Master Profesional", ky	Sipas RVB dhe vizitës në IAL, programi i MP "Sistemet e Informacionit në Biznes", është hartuar duke shfrytëzuar përvojat më të mira bashkëkohore të vendeve të huaja dhe universiteteve me programe të ngjashme në Shqipëri si ai i Universitetit të Tiranës. GVJ vëren që ky program është i harmonizuar me zhvillimet ekonomike dhe teknologjike të vendit tonë, është i përshtatshëm për vendet e punës të ofruara në fushën e IT, por nevojitet të saktësohet më shumë brenda programeve lëndore në lëndë të veçanta raporti teori-praktikë për të vënë akoma më shumë në pah kompetencat dhe

program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	formimin e thelluar profesional që studentët përfitojnë nga ky program. <i>GVJ në këtë pikë rekomandon që të ndiqet jo vetëm struktura e programit, lëndët apo raporti teori-praktikë por edhe që lëndët mbështeten nga literaturë e huaj të rëndësishme të fushës, që ofrohen dhe në univeristete të tjera jashtë vendit.</i> RVB Vizita IAL
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	GVJ konstaton se ka një raport të përshtatshëm në ndarjen e veprimtarive formuese. Mund të shtohet dhe një modul tjetër në lëndët e Kategorisë A, për të plotësuar më mirë këtë kategori (që aktualisht në planin mësimor reflektohet vetëm me një lëndë). Gjithashtu, natyra praktike e Masterit Profesional “Sisteme Informacioni ne Biznes” duhet të theksohet më shumë dhe në syllabus-et e lëndëve. <u>Evidenca 23: Plani mesimor</u> <u>Evidenca 24: Syllabusete Lendeve te Ofruara per Vitin Akademik</u>
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Sipas RVB, Vizitës në IAL dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion, Departamenti i Informatikës së Biznesit përditëson në mënyrë periodike literaturën bazë dhe të detyrueshme të programit të studimit. Këto ndryshime bëhen në fillim të secilit semestër, ku theksimi është në përfshirjen e literaturës së viteve të fundit për të reflektuar aritjet shkencore në fushën e shkencave informatike e ekonomike. Pavarësisht titujve të vendosur në syllabus-et e lëndëve përkatëse, të cilët mund të jenë tekste mjaft të mira në vetvete, GVJ konstaton që: 1. Në këto bibliografi, në pjesën dërrmuese të tyre, mungon vendosja e vitit të botimit (i detyrueshëm në cdo standard). Për pasojë, nuk mund të themi kohën e botimit të tyre duke lexuar syllabusin. 2. Literatura e cituar nën seksionet: a. Literatura bazë e detyrueshme, dhe b. Literatura e rekomanduar, nuk ndjek në mënyrë konsistente të njëjtin standard referimi (p.sh. APA style, apo të tjerë). 3. Një pjesë e lëndëve i kanë vitet të shprehura në literaturat e lëndëve, por këto janë mbi 5 vite të vjetra, pra më herët se 2019. Kjo shihet dhe në lëndë që kanë pësuar një ndryshim mjaft të shpejtë, si p.sh. Menaxhimi i Projekteve në IT. Sipas kërimit të bërë nga <i>GVJ mbi literaturat e përdorura në syllabuset e lëndëve, rezultojnë që literatura të jetë e vitit 2009.</i>

	4. Lënda Siguria e Sistemeve të Informacionit në një pjesë të mirë të tematikave që zhvillon ka si literaturë bazë dhe të detyruar Leksione të shkruara pedagogu i lëndës pa dhënë më shumë informacione. Bazuar në sa më sipër <i>GVJ rekomandon rishikimin e literaturave për lëndët e këtij programi mësimor duke përfshirë literaturë të 5 viteve të fundit.</i> Në rastet e mos ribotimeve të librave të caktuar nga autorët rekomandohet përzgjedhja e një literature të një autori tjetër të huaj apo vendas, literaturë e cila përdoret edhe nga programe të tjera të ngjashme brenda apo jashtë vendit. <u>Evidenca 15: Rregullore e Departamentit të Informatikës së Biznesit</u> <u>Evidenca 24: Syllabuset e Lendeve të Ofruara për Vitin Akademik</u> Vizita IAL RVB
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	GVJ konstaton se programi Master Profesional në “Sistemet e Informacionit në Biznes” në përgjithësi synon nxitjen e studentëve për përvetësimin e dijeve bashkëkohore, si dhe përfitim të aftësive praktike, e bërë kjo në përputhje me synimet e një programi Master Profesional. Konkretisht në auditore, në bazë dhe të vizitës së GVJ në IAL në takimin me studentë, u vu re një nivel mesatar kompetencash. Gjithashtu në raportin vjetor të UMSH, Tabela 9, faqe 51 tregohet se kalueshmëria mesatare në % Diplomimë 2021-2022, për programin MP SIB, është 64%. Për këtë arsye GVJ sugjeron rritjen dhe përmirësimin e anës praktike të secilës lëndë, si dhe një përjasje tjetër në kriteret e pranimit të studentëve në programin master profesional të kësaj natyre, sic e kemi shprehur dhe në kriteret e mësipërme. Kjo do të rriste cilësinë e programit në tërësi dhe ngritjen e kompetencave për profesionistë IT që zotërojnë një diplomë të nivelit të dytë. <u>Evidenca 6: Rregullore e programit MP SIB</u> <u>Evidenca 22: Raporti Vjetor UMSH</u> Vizita IAL
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimit të studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Në RVB, raporti shpreh se: “Programi mundëson formimin profesional të studentëve dhe përgatitjen e tyre në synimin e ndjekjeve të studimeve të mëtejshme ose trajnimeve të ndryshme të lidhura me fushën... “për t’iu përgjigjur kërkesave të tregut të punës, mbështetur edhe në lidhjet e krijuara me partnerët konkretë të tregut të punës. Në bazë të legjislacionit shqiptar për Arsimin e Lartë, studentët që mbarojnë një diplomë Master Profesional, nuk mund të vijnë më tej studimet e Nivelit të Tretë. Gjithsesi, këta specialistë

	mund të kualifikohen (p.sh. me anë të Certifikatave) në mënyrë individuale e në varësi të profileve të tyre të punës. <u>Evidenca 12: Liste e Marveshjeve të Bashkepunimit RVB</u>			
Konkluzione	<i>Struktura dhe organizimi i programit janë në përputhje me objektivat formuese dhe nivelin e kualifikimit sipas standardeve kombëtare dhe evropiane. Megjithatë, ka disa sfida dhe fusha për përmirësim. Për shembull, emërtimet e lëndëve dhe përmbajtja e tyre duhet rishikuar për të siguruar që përmbajnë njohuri të thella dhe të përditësuara për kërkesat e tregut të punës. Po ashtu, përditësimi i literaturës nuk i referohet 5 viteve të fundit. Por duhet marrë parasysh fakti se elementet sipas vkm.41 qendrojnë.</i> <i>Rekomandimet përfshijnë rishikimin e emërtimeve të lëndëve, përditësimin e literaturës me burime më të reja dhe të përputhshme dhe përqasjen më të mirë të veprimtarive teorike dhe praktike për të garantuar formimin e thelluar profesional dhe përputhjen me kërkesat e tregut të punës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga IAL, në Statutin e UMSH, neni 38, pika h dhe në rregulloren e departamentit Neni 8, pika g, parashikohet se drejtuesi i njësisë bazë kërkon rishikime dhe përmirësime të programeve të studimit në bazë të nevojave dhe treguesve akademikë. Gjithashtu programi i studimit MP SIB, konsultohet në mënyrë të herëpashershme me anëtarët e Bordeve të Punës, përfaqësues të bizneseve, të shërbimeve ose të profesioneve respektive, dhe ai mund të ndryshojë për t'iu përgjigjur sa më mirë dhe në kohë kërkesave të tregut të punës. Këtë, GVJ e konfirmon në raportin e Analizës së Tregut të Punës si dhe nga shpjegimet e dhëna gjatë vizitës në institucion. <i>GVJ sugjeron që kriteri (sic është i shprehur në këtë raport) të konsiderohet i plotësuar, duhet që këto konsulta e propozime (që</i>

	<i>më pas kthehen në vendime në kuadër të përmirësimit të programeve të studimit) të jenë dhe të dokumentuara.</i> <u>Evidenca 1: Statuti UMSH</u> <u>Evidenca 15: Rregullore e Departamentit BI</u> <u>Evidenca 29: Analize e Tregut të Punës</u>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, në RVB dhe në vizitën pranë IAL, GVJ konstaton se institucioni krijon fokus grupet subjekt i të cilave janë studentët e programit Bachelor dhe Master. Qëllimi i këtyre grupeve është mbledhja e eksperiencave dhe mendimeve të drejpërdrejta në lidhje me shërbimet ndaj studentëve, procesin e mësimdhënies, sugjerimet për përmirësim të mëtejshëm të institucionit, lëndëve programeve akademike, etj. Në UMSH, është funksionale Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe e Karrierës, e cila mban kontakte me studentët e diplomuar ku në funksion të saj është dhe UMSH ALUMNI. Kjo zyrë ndihmon në ruajtjen e marrëdhënieve midis institucionit dhe studentëve të diplomuar e punësuar. Gjithashtu Bordet e Punës janë krijuar me anëtarë edhe nga radhët e UMSH Alumni, të cilët kanë zhvilluar një karrierë të spikatur profesionale pranë institucioneve ku janë punësuar. Ata janë konsulentë pranë departamentit për aktivitete të ndryshme, leksione të hapura si dhe konsultues të programeve të studimit. Për sa u tha më sipër GVJ nuk ka në dispozicion një dokument që e vërteton reflektimin e tyre në programin mësimor (procesverbal, memo, aposhkresë tjetër). GVJ konstaton se IAL angazhohet seriozisht në organizimin, mbështetjen dhe fuqizimin e rrjeteve ALUMNI që funksionojnë pranë UMSH, duke i përfshirë gjithnjë e më shumë ALUMNI-t në strukturat konsultuese e drejtuese të universitetit, si dhe duke i angazhuar në aktivitete/projekte zhvilluese të UMSH. Një politikë e tillë është ndjekur në mënyrë të vazhdueshme nga UMSH. <u>Evidenca 29: Analize e Tregut të Punës</u> <u>Evidenca 31: Procedura e Punës me Fokus Grupet</u> https://www.umsh.edu.al/c/98/alumni Vizita IAL RVB
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet	Referuar RVB: “UMSH dhe Fakulteti i Informatikës kontakton me grupet e interesit, publike apo private, duke marrë në konsideratë nevojat specifike lokale apo më gjerë”, e gjitha kjo në kuadër të riorganizimit të programeve të posaçme të studimit për tu

dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	ardhur në ndihmë studentëve të cilët synojnë të plotësojnë nevojat e tregut. Sipas prioriteteve të caktuara për vendin tonë, duke qenë se profilet me drejtim IT janë gjithmonë të kërkuara e për të cilat ka mjaft nevojë tregu, edhe programi i Masterit Profesional "Sistemet e Informacionit në Biznes" është pikërisht rezultat i nevojës për t'iu përgjigjur kërkesave të tregut të punës për kualifikimin e nëpunësve të angazhuar në procese pune të lidhura me informatikën. Një inkurajim për zhvillimin e këtij programi, IAL e merr dhe nga UMSH Alumni nëpërmjet Bordeve të Punës. <u>Evidenca 4: Strategjia e Zhvillimit të Programit MPSIB</u> <u>Evidenca 29: Analize e Tregut të Punës</u> RVB		
Konkluzione	<i>UMSH po bën përpjekje për të nxitur përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit. Megjithatë, ka disa fusha për përmirësim. Rekomandimet përfshijnë nevojën për dokumentim të konsultimeve dhe propozimeve nga institucionet partnerë dhe tregu i punës për përmirësimin e programit, si dhe për të vërtetuar reflektimin e opinionit të studentëve dhe diplomuarve në programin e studimit. Po ashtu, sugjerohet një qasje më e mirë në mbajtjen e lidhjeve me të diplomuarit dhe përfshirjen e tyre në procesin e përmirësimit të programit. E rëndësishme është edhe përditësimi i programit të studimit në përputhje me zhvillimet e fundit në fushat përkatëse, duke përfshirë bashkëpunimin me profesionistë, shoqata dhe institucione të tjera relevante.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi II.6	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Bazuar në dokumentacionin e disponueshëm, UMSH ka përcaktuar objektiva të qarta dhe të realizueshme për të pajisur studentët me dije të nivelit të lartë dhe aftësi për tregun e punës. Në vizion të këtij institucioni midis të tjerave theksohet se institucioni gjithashtu ka potencialin për kërkim shkencor në drejtimet specifike të UMSH. Referuar RVB, programi MP SIB është hartuar nëpërputhje me kuadrin ligjor në fuqi që përcakton standardet e dijeve, aftësive dhe

	kompetencave profesionale dhe shkencore që karakterizojnë profilin e programit të studimit. GVJ konfirmon se programi i studimit MP SIB ka një përcaktim të qartë tëpërioriteteve dhe objektivave, dhe se ato janë në përputhje me vizionin dhe misionin e institucionit. Në analizën e këtij kriteri, është identifikuar se programi i studimit përshtatet me synimet e institucionit dhe se orientimi i tij është në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor. <u>Evidenca 4: Strategjia e Zhvillimit të programit MP SIB</u> <u>Evidenca 9: Rregullore e Organizimit UMSH</u> <u>Evidenca 3: Plani i Zhvillimit Strategjik i UMSH</u> RVB
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Bazuar në rregulloren e organizimit të UMSH, Kreu II, Neni 4 mbi të drejtat dhe liritë themelore, tregohet qartë që institucioni realizon objektivat dhe misionin e vet duke u mbështetur në liritë themelore të sanksionuara me Ligjin Nr.80/2015, ku liria akademike garantohet nëpërmjet të drejtës: - Për të organizuar veprimtaritë e mësimdhënies, të kërkimit shkencor si edhe veprimtaritë krijuese - Për të hartuar dhe zhvilluar programet e studimit dhe për të përcaktuar fushat e kërkimit shkencor - Për të organizuar procesin e promovimit të personelit akademik Bazuar në RVB, Departamenti i Informatikës së Biznesit nxit veprimtaritë e mësimdhënies, kërkimin shkencor ose ato artistike duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik. Kjo gjë është konfirmuar edhe gjatë bisedës me stafin PAE dhe PAK në vizitën që pati GVJ në UMSH. <u>Evidenca 9: Rregullore e Organizimit UMSH</u> Vizita IAL RVB
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Referuar planit mësimor mbi punën e pavarur të studentëve dhe syllabuseve të lëndëve ku parashikohen edhe përgatitjet e detyrave të kursit ose projektet nga ana e studentëve shohim që programi i studimit MP SIB nxit dhe motivon studentët në studime dhe aktivitete kërkimore. Bazuar në RVB, në diskutimet me stafin PAE, PAK, studentet dhe përfaqësuesin e zyrës së marrëdhënieve me jashtë dhe projektet, gjatë vizitës në IAL, për përfshirjen e studentëve në aktivitete është pohuar zhvillimi periodik i seminareve dhe konferencës së UMSH. Ndërkohëpo planifikohet zhvillimi i kësaj konference edhe këtë vit

	akademik ku studentët janë të ftuar të marrin pjesë. Gjithashtu institucioni ka një listë bashkëpunimi me institucione, biznese dhe universitete vendase dhe të huaja nga të cilat përfitojnë stafi dhe studentët. Studentët pohojnë se kanë qënë pjesë e projeteve dhe Erasmus+ (mobilitet), gjë e cila vërtetohet dhe nga thirjet për mobilitet Erasmus+ të publikuara në faqen zyrtare të UMSH. Megjithatë GVJ nuk ka mundur të gjejë një dokument me statistika se sa është numri i studentëve të programit MP SIB që kanë mundur të përfitojnë nga të gjitha këto aktivitete, prandaj dhe rekomandon hartimin e një dokumenti i cili pasqyron qartë në mënyrë sasiore përfshirjen e studentëve të MP SIB në aktivitete të ndryshme të organizuara nga institucioni, fakulteti apo departamenti. <u>Evidenca 12: Lista e marveshjeve të bashkëpunimit.</u> <u>Evidenca 13: Lista e aktiviteteve të organizuara nga Fakulteti i Informatikës</u> <u>Evidenca 23: Plani mesimor</u> <u>Evidenca 24: Syllabuset e Lendeve të Ofruara për Vitin Akademik</u> https://www.umsh.edu.al/c/148/nderkombetarizimi Vizita IAL RVB
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	Bazuar në pasqyrën financiare për vitet akademike 2017-2022, GVJ gjen informacionin mbi mbështetjen që bën institucioni mbi aktivitete të ndryshme studimore dhe kërkimin shkencor: Referuar dokumentit mund të themi se UMSH për vitin 2022, ka të ardhura nga projektet. Ndërkohë ka zëra për shpenzime nëpunën kërkimore shkencore, pagesa për projektet e kërkimit si dhe shpenzime për kërkim zhvillim. Gjithashtu bazuar në RVB, theksohet se të gjitha aktivitetet studimore të organituara nga njësia përgjegjëse mbi programin e studimit, financohen nga institucioni. Ndërkohë mobilitetet e stafit financohen nga institucionet partnere në projekt. Kjo gjë theksohet edhe në takimin që GVJ bëri me stafin PAE PAK gjatë vizitës në IAL. <u>Evidenca 55: Raporti Financiar</u> RVB Vizita IAL
Konkluzione	<i>GVJ konkludon se programi i studimit në UMSH siguron një orientim të qartë në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor. Programi MP SIB përshtatet me synimet dhe vizionin e institucionit dhe ka përcaktuar objektivat e qarta për të pajisur studentët me dije dhe aftësi për tregun e punës. Rekomandohet hartimi i një</i>

	dokumenti për të dokumentuar përfshirjen e studentëve në aktivitetet e organizuara nga institucioni. Financimi për aktivitetet studimore dhe kërkimore është i siguruar nga institucioni, duke ndihmuar në mbështetjen e veprimtarive të kërkimit dhe shkencës në UMSH.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7

Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, GVJ konstaton se ndihma në mbështetje të grupeve lëndore dhe projekteve kërkimore shkencore vjen: - Financiarisht, bazuar në pasqyrën financiare për vitet akademike 2017-2022, gjendet informacion mbi mbështetjen që bën institucioni mbi aktivitete të ndryshme studimore dhe kërkimin shkencor: si shpenzime në punën kërkimore shkencore, pagesa për projektet e kërkimit dhe shpenzime për kërkim zhvillim. - Infrastruktura, ku stafi akademik dhe studentët kanë akses në; bibliotekën online me mbi 18.000 libra, akses në platforma online, klasa dhe laboratorë me akses në internet, software, projektorë, etj. Gjithashtu ofron një listë të pasur me institucione kërkimore ose IAL të tjera brenda dhe jashtë vendit me të cilat kanë pasur edhe mobilitete të studentëve dhe të stafit. Ndërkohë GVJ rekomandon edhe hartimin e një listë ku pasqyrohet qartë edhe mobiliteti i studentëve. <u>Evidenca 18: Liste e Mobiliteti i Stafit Akademik</u> <u>Evidenca 22: Raporti vjetor i UMSH</u> <u>Evidenca 31: Procedura e Punes me Fokus Grupet</u> <u>Evidenca 39: Manuali i Perdorimit te Platformave Online</u> <u>Evidenca 42: Relacioni i Godines</u> <u>Evidenca 53: Manual mbi Perdorimin e Bibliotekes Online</u> <u>Evidenca 55: Raporti Financiar</u> Vizita IAL
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu	Bazuar në RVB, "Drejtuesit në rang universiteti, Rektor, Dekan, Përgjegjës Departamenti dhe njësitë e tjera përbërëse, nxisin dhe

përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	inkurajojnë jo vetëm personelin akademik por edhe studentët të bëhen pjesë e projekteve kërkimore shkencore “. Kjo mbështetet edhe në thirrjet e publikuara në faqen zyrtare të UMSH, për pjesëmarrjen e studentëve në projekte. Gjithashtu gjatë takimeve të ndryshme në IAL, nga të gjitha grupet është theksuar një bashkëpunim shumë i mirë dhe korrekt të stafit akademik në bashkëpunim me studentët, në ndihmën dhe hartimin e raporteve. Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion mund të përmendim gjenerimin e raporteve të tilla si: Analiza e Tregut, Vlerësimi i Pedagogut, Raporti vjetor UMSH, etj. https://www.umsh.edu.al/c/182/erasmus- https://www.umsh.edu.al/c/185/universiteti-mesdhetar RVB
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	Bazuar në RVB personeli akademik dhe studentët nxiten të jenë pjesë e kërkimit shkencor si dhe të punojnë për kërkimin e kualifikimeve të mëtejshme. Kjo gjë theksohet dhe në takimet që GVJ bëri me stafin PAE, PAK dhe studentët. Të cilët konfirmuan pjesëmarrjen e tyre në konferenca, projekte, programe Ersamus+ (mobilitet), aktivitete me natyrë shkencore të organizuara nga Departamenti i Informatikës në Biznes. GVJ konstatoi të dokumentuara në Raportin vjetor të UMSH si dhe në faqen zyrtare të këtij institucioni, listën e aktiviteteve si më poshtë: 1. Revista EUROMEDITERRANEAN nga numri i parë publikuar në Dhjetor 2010 deri në numrin 19 (numër tek i cili nuk cilësohet viti i botimit) 2. Revista EKOINFO-SISTEM (me fokus kërkimin në shkencat ekonomike dhe informatike), dy vëllime (Dhjetor 2022, Dhjetor 2023) 3. Konferenca shkencore ndërkombëtare: “Are We Ready? Challenges of the Society Facing Digital Transformation”. Prill 2023. 4. Aktivitete të tjera: Leksione të hapura dhe Webinare (ku për webinarët nuk është vendosur një datë për zhvillimin e tyre dhe nuk dihet nëse janë aktivitete të zhvilluara në tre vitet e fundit). 5. Programe Erasmus+: ku thirrjet për pjesëmarrje janë të azhornuara (thirje për vitin 2024) 6. Lista e projekteve, ku tre prej tyre janë projekte të përfunduara me sukses të tjerat janë projekte të cilat janë në vazhdim.

	Nga sa është listuar më sipër duket qartë që institucioni bën përpjekje të vazhdueshme për të ndihmuar personelin dhe studentët në arritjet e tyre. Ajo që <i>GVJ rekomandon në këtë pikë, është hartimi i një dokumenti ku përshkruhet dhe ilustrhet në mënyrë cilësore dhe sasiore se cilat janë angazhimet e njësisë përgjegjëse për programin MP SIB në veçanti (hartimi i një raporti).</i> <u>Evidenca 13: Lista e Aktiviteteve të Organizuar nga fakulteti i Informatikës</u> <u>Evidenca 22: Raporti vjetor i UMSH</u> RVB Vizita IAL https://www.umsh.edu.al/c/147/kerkimi-shkencor https://www.umsh.edu.al/c/148/nderkombetarizimi
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	Bazuar në Raportin Vjetor të UMSH, Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Studentëve, në bashkëpunim me njësinë bazë, zhvilloi një hulumtim tregu për plotësimin e nevojave të tregut të punës dhe synimet e zhvillimit kombëtar dhe ndërkombëtar. • Raporti vjetor i UMSH vë në dukje përparimin e konsiderueshëm në trajtimin e hendeut midis aftësive të diplomave dhe nevojave të tregut të punës. • Politikat dhe praktikat koherente dhe të bashkërenduara arsimore adresojnë dhe koordinojnë aftësitë e diplomave me nevojat e tregut të punës. • UMSH inkurajon rritjen e bashkëpunimit midis nivelit akademik dhe palëve të interesit për hartimin e programeve dhe rishikimin periodik të kurikulave dhe materialeve mësimore për të ndjekur tendencat aktuale të hulumtimit dhe nevojat e tregut të punës. • Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Studentit realizon një studim vjetor në fillim të Marsit. Në këtë raport ka rezultate të publikuara për punësimin e studentëve Bachelor, por jo për ata të programeve Master dhe MP SIB në vecanti. Gjithashtu në takimin me Dekanin dhe Përgjegjës të Departamentit Informatike Biznesi nëUMSHështë theksuar që studentët janë në përgjithësi të punësuar dhe në profesion. Për të mbështetur sa u tha më sipër, <i>GVJ rekomandon dorëzimin e përpunimeve statistikore të dala si rezultat i përpunimit të të dhënave që Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Studentit ka marrë gjatë anketimit.</i> <u>Evidenca 12: Liste e Marreveshjeve të Bashkëpunimit</u>

	<u>Evidenca 22: Raporti vjetor UMSH</u> <u>Evidenca 29: Analize e Tregut te Punes</u> Vizita IAL RVB			
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesioniste, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	Referuar RVB ky kriter është cilësuar si N/A dhe GVJ nuk disponon dokumenta për të vërtetuar ndryshe.			
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	Referuar RVB ky kriter është cilësuar si N/A dhe GVJ nuk disponon dokumenta për të vërtetuar ndryshe.			
Konkluzione	GVJ konstaton se njësia përgjegjëse për programin e studimit ofron mbështetje të rëndësishme për grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore në kuadër të kërkimit shkencor. Për të arritur këtë, institucioni ka siguruar mbështetje financiare dhe infrastrukturale të nevojshme për zhvillimin e këtyre aktiviteteve. Për të përmirësuar transparencën dhe monitorimin e mobilitetit të studentëve, rekomandohet hartimi i një liste të qartë dhe të dokumentuar të aktiviteteve të realizuara në lidhje me këtë. Në përgjithësi, vlerësohet se institucioni ka ndërmarrë hapa pozitivë për të inkurajuar dhe ndihmuar personelin akademik dhe studentët në kërkimin shkencor, por një përmirësim i dokumentimit dhe transparencës së aktiviteteve do të ishte përfitimtar.			
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1

Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënës dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Në bazë të dokumentave të ndryshëm të vënë në dispozicion të GVJ, si dhe nga vizita gjatë institucionit, u konstatua që procesi mësimor zhvillohet me leksione, seminare, laboratore, detyra praktike dhe me detyra kursi, Projekte individuale ose në grup, praktika konkrete, praktikat profesionale, punim diplome ose provim të përgjithshëm përfundimtar. Sipas syllabus-eve të lëndëve u vu re që përvec provimit përfundimtar, kontrolli i dijeve bëhet i vazhdueshëm, përgjatë gjithë semestrit, në mënyrë që studentët të kenë mundësi të identifikojnë mangësitë dhe t'i plotësojnë ato përpara përfundimit të semestrit. Institucioni ka zhvilluar dhe leksione të hapura me institucione dhe biznese me të cilat UMSH ka marrëveshje bashkëpunimi. <u>Evidenca 6: Rregullore e Programit MP SIB</u> <u>Evidenca 20: Dosja e Praktikes</u> <u>Evidenca 23: Plani Mesimor</u> <u>Evidenca 24: Syllabueset e Lendeve te Ofruara per Vitin Akademik</u> Vizita IAL RVB
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Sipas RVB, por edhe në bazë të dokumentacionit të konsultuar, GVJ evidenton që personeli akademik ka respektuar diversitetin e studentëve. Sipas vizitës në IAL, në takimin me studentët, duke qenë se shfaqin heterogjenitet në formimin e tyre Bachelor, ata mendojnë që shtimi i pjesëve praktike në lëndët e profilit do ishte edhe më në dobi të avancimit të tyre praktik dhe për pasojë rritjes së mundësisë së punësimit të tyre në një profil të fushës së IT.

	<u>Evidenca 34: Rregullore per studentet me Aftesi Ndryshe</u> Vizita IAL RVB
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	Sipas RVB, dhe dokumentacionit të venë në dispozicion, Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë në institucion lidhet dhe me trajnimin dhe kualifikimin e pedagogëve. Institucioni ka një program trajnimi të strukturuar për stafin akademik në përputhje me gradën shkencore. Gjatë vizitës në institucion, GVJ vuri re anën logjistike të sallave, apo edhe të ambienteve të tjera, të cilat vërtetojnë përdorimin e pajisjeve dhe metodave bashkëkohore të të nxënit. Institucioni në mënyre periodike bën vlerësimin e performancës së personelit akademik të angazhuar me kohë të plotë dhe të ftuar, i cili vlerësohet nga autoriteti drejtues dhe nga studentët. Raporti përfundimtar i performancës ndihmon stafin të përmirësojë aspekte të caktuara, si dhe vlen si bazë për zhvillimin e marrëdhënieve të punësimit. <u>Evidenca 36: Formulari i vlerësimit të Pedagogut dhe Lendes nga Studenti</u> <u>Evidenca 37: Formulari i Vlerësimit të Pedagogut nga Autoriteti Drejtues</u> <u>Evidenca 46: Program Trajnimi dhe Kualifikimi</u> Vizita IAL RVB
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te studentët mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	GVJ pasi shqyrtoi Curriculum Vitae të dorëzuara nga IAL për anëtarët e stafit që japin mësim në programin Master Profesional “Sistemet e Informacionit në Biznes”, arrin në përfundimin që ky personel akademik është kompetent në shpjegimin e njohurive, si pasojë e edukimit të tyre, përvetësimit të titujve dhe gradave apo edhe nga eksperiencia e tyre profesionale në kompani apo projekte IT. <i>Për lëndët e profesionit sugjerohet rishikim i programeve, si dhe i literaturave.</i> <u>Evidenca 7: CV e Stafit Akademik në Programin e Studimit MP SIB</u> <u>Evidenca 24: Syllabuset e Lendeve të Ofruara për Vitin Akademik</u>

Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Sipas strukturës organizative të UMSH, ngritja e zyrave të ndryshme në vecanti NJSBCZHK, apo bërja pjesë e kompetencave të përgjegjësve të departamenteve, dekanëve, apo stafeve të tjera menaxhuese të institucionit, të vlerësimit të performancës së lektorëve nga studentët, bën që GVJ të konstatojë që IAL e vlerëson dhe përpiket të përmirësojë mësimdhënien në përgjithësi në mënyrë periodike. Bazuar në informacionin e grumbulluar gjatë vizitës, këto vlerësime mund të jenë vendimtare për vazhdimësinë e punës në UMSH. Studentët kanë një rol aktiv në dhënien e sugjerimeve për kurrikulën e programit, duke u përfshirë në strukturat organizative sipas ligjit aktual. NJSBCZHK dhe njësia bazë mbledhin pikëpamjet dhe sugjerimet lidhur me procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies për programin MP SIB, duke përdorur metoda si plotësimi i formularëve, fokuset grupore dhe konsultimet me studentët. Pas analizës së rezultateve të mbledhura, hartohen raporte dhe më pas paraqiten në Rektorat për të marrë masa për përmirësimin e vazhdueshëm të procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies në të ardhmen. <u>Evidenca 31: Procedura e Punes me Fokus Grupet</u> <u>Evidenca 35: Plan Veprimi NJSBCZHK</u> <u>Evidenca 36: Formulari i Vleresimit te Pedagogut dhe Lendes nga Studenti</u> <u>Evidenca 37: Formular i Vleresimit te Pedagogut nga Autoritetet Drejtuese</u>
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht	Në IAL Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë, vepron Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave, e cila është një strukturë autonome, e përhershme në strukturën organizative të universitetit. Ndër detyrat e kësaj strukture është të vlerësojë periodikisht veprimtaritë e mësimdhënies si dhe ato të kërkimit shkencor. Përveç kësaj strukturave të dedikuara, janë dhe strukturat drejtuese dhe autoritetet të institucionit të cilat janë gjithashtu përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë. GVJ konstatoi nga vizita në IAL që Fakulteti i Informatikës dhe Departamenti “Informatikë Biznesi” mbështet zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies. Implementimi i projektit “Laboratori i Inteligjencës Artificiale në Shqipëri dhe Kosovë” është një prej tyre. Bazuar në dokumentacion, personeli akademik i UMSH mund të përmirësojë aftësitë e tij në mësimdhënie, duke shfrytëzuar

personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	trajnime dhe kualifikime të herëpashershme nga lektorë të ftuar, apo anëtarë të personelit të UMSH. Në dokumentin Program Trajnimi dhe Kualifikimi, GVJ gjen 15 aktivitete në total të zhvilluara për vitin akademik 2022-2023. Gjithashtu gjatë vizitës në institucion, GVJ evidentoi që një pjesë e mirë e pedagogëve prezentë në takim përdorin metoda interactive dhe diskutimi me studentët. Nga vëzhdimi i syllabus-eve të detajuar të lëndëve, GVJ konstaton dhe lëndë të caktuara që përfshijnë diskutimin e rasteve, punën në grup, etj. Sugjerohet përmirësimi i mëtejshëm i aspekteve teknike. <u>Evidenca 5: Rregullore e Fakultetit të Informatikës</u> <u>Evidenca 15: Rregullore e Departamentit Informatike Biznesi</u> <u>Evidenca 16: Rregullore e NJSBCZHK</u> <u>Evidenca 35: Plan Veprimi NJSBCZHK</u> <u>Evidenca 46: Program Trajnimi dhe Kualifikimi</u> Vizita IAL			
Konkluzione	<i>GVJ konkludon se IAL garanton procesin e të nxënës dhe aftësimin profesional e shkencor nëpërmjet metodave dhe praktikave të mira, duke përqendruar vëmendjen në studentët. Procesi mësimor përdor një gamë të gjerë metodash, përfshirë leksione, seminare, punë laboratorike, detyra kursi dhe projekte praktike. Institucioni ka mbështetur marrëdhëniet dhe bashkëpunimet midis personelit akademik dhe studentëve, duke inkurajuar angazhimin e tyre në përmirësimin e procesit të mësimin dhe nxënies. Për të përmirësuar vazhdimisht cilësinë e mësimdhënies, rekomandojmë vazhdimin e trajnimeve për personelin akademik, përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies dhe hartimin e planeve të veprimit për koordinimin dhe përmirësimin e procesit të mësimin dhe nxënies në të ardhmen.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, në lidhje me kriteret dhe mënyrën e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale, IAL ka të përcaktuara në

profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	dokumentin “Rregullore e Programit Master Profesional “Sistemet e Informacionit në Biznes”, - Neni 20, sipas të cilës: Shkalla e përvetësimit të dijeve vlerësohet me sistemin prej 10 notash (nga 5 e lart janë kaluese). Kontrolli i dijes të një lënde mund të bëhet me shkrim ose i kombinuar me shkrim e me gojë. - Kreu V, Neni 21, sipas të cilës:studenti futet në provimin e një lënde mbasi ka shlyer detyrimet akademike që lidhen me atë lëndë, të parashikuara në planin mësimor dhe në programin e lëndës. Referuar Udhëzuesit të Studentëve, seksionit Procedurat dhe Rregullat, Procesi mësimor, pika 2 Vlerësimi i dijeve, shprehimisht thuhet se: - Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Nota përfundimtare është rezultante e kombinimit të elementëve të mëposhtëm në % të përcaktuara në programin e lëndës: - Nivelit të frekuentimit, aktivizimit në seminare, provimit të ndërmejtëm, detyrave të kursit (0% - 40%) - Provimit Përfundimtar (60% - 70%) - Etj, Kërkesa specifike të sqaruara në sillabusin e lëndës përkatëse. Duke ju referuar programeve të lëndëve, disa lëndë përdorin komponentët e vlerësimit të përcaktuara më sipër: <table> <tr> <td>Vlerësim i vazhdueshëm</td><td>15%</td></tr> <tr> <td>Detyra kursi</td><td>15%</td></tr> <tr> <td>Provimi i ndërmjetëm</td><td>30%</td></tr> <tr> <td>Provimit përfundimtar</td><td>40%.</td></tr> </table> Ndërsa pjesa tjetër e lëndëve cilësojnë këta komponentë vlerësimi: <table> <tr> <td>Detyrë kontrolli</td><td>10%</td></tr> <tr> <td>Detyrë kontrolli</td><td>10%</td></tr> <tr> <td>Detyrë kontrolli</td><td>10%</td></tr> <tr> <td>Detyrë kontrolli</td><td>10%</td></tr> <tr> <td>Detyrë kontrolli</td><td>10%</td></tr> <tr> <td>Detyra projekte kursi</td><td>20%</td></tr> <tr> <td>Provimi Përfundimtar</td><td>30%</td></tr> </table>	Vlerësim i vazhdueshëm	15%	Detyra kursi	15%	Provimi i ndërmjetëm	30%	Provimit përfundimtar	40%.	Detyrë kontrolli	10%	Detyrë kontrolli	10%	Detyrë kontrolli	10%	Detyrë kontrolli	10%	Detyrë kontrolli	10%	Detyra projekte kursi	20%	Provimi Përfundimtar	30%
Vlerësim i vazhdueshëm	15%																						
Detyra kursi	15%																						
Provimi i ndërmjetëm	30%																						
Provimit përfundimtar	40%.																						
Detyrë kontrolli	10%																						
Detyrë kontrolli	10%																						
Detyrë kontrolli	10%																						
Detyrë kontrolli	10%																						
Detyrë kontrolli	10%																						
Detyra projekte kursi	20%																						
Provimi Përfundimtar	30%																						

	Mungojnë kriteret e vlerësimit për lëndën Kontabilitet Kosto Drejtimi, <i>GVJ rekomandon vendosjen e tyre në syllabus</i>. Referuar RVB, format dhe kriteret e vlerësimit të studentit i bëhen të ditura paraprakisht studentëve. <u>Evidenca 6: Rregullore e Programit MP SIB</u> <u>Evidenca 38: Udhezuesi i Studenteve</u> RVB
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Sipas RVB, vizitës në UMSH, dhe dokumentave në dispozicion, studentët njihen me silabusin e lëndës në të cilin përcaktohen në mënyrë të detajuar mënyra e kontrollit dhe format e vlerësimit të dijeve, së bashku me afatet kur duhet të plotësohet secili detyrim deri në përfundim të zhvillimit të lëndës, në fillim të çdo semestri. Njoftime të detajuara për detyrat dhe provimet në kuadër të lëndës vendosen edhe në platformën SMS, si dhe u njoftohen me email nga koordinatori dhe departamentit. <u>Evidenca 38: Udhezuesi i Studenteve</u> <u>Evidenca 39: Manual i Përdorimit të Platformave Online</u> Vizita IAL RVB
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Mbështetur në Udhezuesin e Studentëve, vlerësimi i dijeve bëhet nëpërmjet nivelit të frekuentimit, aktivizimit në seminare, provimit të ndërmejtëm, detyrave të kursit, provimit përfundimtar dhe kërkesa specifike të sqaruara në silabusin e lëndës përkatëse. Ndërkohë Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë Kreu III, Neni 37, dhe Rregullore e Programit MP SIB, Neni 20, përcaktojnë formën e kontrollit të dijes nëpërmjet provimit i cili mund të jetë: • provim me shkrim • provim me gojë • ose provim i kombinuar me shkrim e me gojë. Gjithashtu në po këtë Nen theksohet se nëse për arsye objektive një student e ka të pamundur dhënien e provimit sipas formës së përcaktuar në programin e lëndës, atëherë përgjegjësi i njësisë bazë vendos me urdhër të veçantë kryerjen e provimit në një nga format e listuara më sipër. Kjo tregon kujdes për të adresuar nevojat dhe stilet e ndryshme të të mësuarit dhe ju jep mundësi studentëve për të demonstruar njohuritë dhe kompetencat e fituara. <u>Evidenca 5: Rregullore e Fakultetit të Informatikës</u>

	<u>Evidenca 6: Rregullore e Programit MP SIB</u> <u>Evidenca 38: Udhëzuesi i Studenteve</u> RVB			
Konkluzione	GVJ konstaton se institucioni shfaq kujdes dhe përgjegjësi në hartimin e rregulloreve dhe procedurave për testimin dhe vlerësimin e njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore. Përparësia e përcaktimit të kriterëve dhe mënyrave të testimit është e vlerësuar si e rëndësishme dhe e qartë, duke lejuar për një gamë të gjerë të formatit të testimit, duke përfshirë provime me shkrim, me gojë ose një kombinim të tyre. Përveç kësaj, rregulloret e përcaktojnë qartësisht që nëse një student për arsye objektive nuk mund të japë provimin sipas formës së përcaktuar, njësia bazë është e detyruar të përcaktojë një formë alternative. Kjo tregon një kujdes për të adresuar nevojat dhe stilin e ndryshëm të të mësuarit dhe ofron mundësi për studentët për të demonstruar njohuritë dhe kompetencat e tyre në mënyra të shumëllojshme.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Sipas të dhënave të reflektuara në syllabus-et e lëndëve, e në bazë të Rregullores së programit MP SIB dhe Udhëzuesit të Studentëve, vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit është shumë e elementëve të mëposhtëm: a. Provimit të ndërmjetëm b. Nivelit të diskutimit në seminare c. Detyrës së kursit (ese, prezantime, projekte, laboratore)/ detyra praktike d. Provimit përfundimtar. Provimi i ndërmjetëm zhvillohet në mes të semestrit, seminarët janë të përjavshme, kurse detyrat e tjera janë të shpërndara sipas planit të secilit pedagog të lëndës. Kjo, për GVJ, vërteton shpërndarjen e vlerësimit përgjatë gjithë semestrit. <u>Evidenca 24: Syllabuset e Lendëve të Ofruara për Vitin Akademik</u> <u>Evidenca 6: Rregullore e Programit MP SIB</u>

	<u>Evidenca 38: Udhezuesi i Studenteve</u>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Bazuar në RVB dhe Manualin e përdorimit të platformave online, Institucioni inkurajon stafin akademik dhe studentët të përdorin platformën Google Classroom si sistem elektronik për kontrollin e dijeve të formës Quiz dhe Assignemts. Ndërkohë nuk ka sisteme elektronike për Testimet e ndërmejtme ose Provimet përfundimtare të lëndëve. Nga njëra anë, kjo mund të jetë e kuptueshme për lëndët me karakter teknik, sic janë pjesa më e madhe e lëndëve të programit të studimit. Megjithatë GJVJ konstaton se për të rritur transparencën gjatë gjithë procesit të provimit, sekretaria sekretion provimet. Pedagogët i korrigjojnë ato të sekretuara dhe në përfundim të procesit të korrigjimit, sekretaria i ç' sekretion provimet dhe hedh pikët në listën e studentëve pjesëmarrës në provim. <u>Evidenca 39: Manual i përdorimit të Platformave Online</u> <u>Evidenca 40: Udhezues për Provimin e Ndermjetem, Përfundimtar dhe të Sezonit Perserites</u> RVB
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Referuar RVB dhe vizitës në IAL, theksohet se mënyra e vlerësimit është e paraqitur në syllabusin e secilës prej lëndëve të programit MPSIB dhe se vlerësimi bëhet në përputhje me përcaktimet e akteve rregullatore të Fakultetit të Informatikës. RVB Vizita IAL
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënies për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Sipas Udhezuesit të Provimeve dhe në bazë të informacionit të marrë gjatë vizitës në IAL, Vlerësimi në asnjë rast nuk kryhet vetëm nga një pedagog. Pavarësisht se mënyrës se si zhvillohet provimi (me shkrim apo me gojë), pedagogu i lëndës e ka për detyrë që në tezën e miratuar të vendosë shënime, pikë dhe notë në cdo tezë, duke lënë gjurmë për vlerësimin e studentit. Gjithashtu, institucioni ndjek dhe një procedurë të mirëregulluar për rastet kur studenti ka ankesë për pikët e vlerësimit të lëndës. Në rastet kur pikët ndryshojnë si pasojë e seancave sqaruese apo ankimore, pedagogu duhet të japë sqarime për cdo ndryshim duke lënë gjurmët e këtij ndryshimi edhe në tezë. Referuar po të njëjtit dokument, parashikohen edhe rastet kur teza rishikohet nga një komision i posaçëm pa praninë e pedagogut të lëndës, është e detyrueshme që cdo ndryshim të pasqyrohet në një procesverbal të vecantë.

	Referuar formatit të tezës së provimit të vënë në dispozicion, vihet re tabela e vlerësimit të detajuar për tezën, e vendosur në faqen e fundit. Në këtë tabelë kërkohen të vendosen pikët për çdo pyetje, komentet si dhe totali i pikëve. Bazuar në RVB, gjatë seancave sqaruese studentët marrin informacione më të detajuara mbi problematikat e konstatuara në zgjidhjen e tezës së provimit. <u>Evidenca 40: Udhezues per Provimin e Ndermjetem, Perfundimtar dhe te Sezonit Perserites</u> RVB
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Referuar dokumentit Kodi i Etikës, Neni 7, pika f dhe Neni 9, pika c, GVJ konstaton që IAL ka të rregulluar rastet e evidentuara të kopjes, mashtrimit apo shmangies nga shlyerja e detyrimeve mësimore. Gjithashtu GVJ evidenton se, referuar dokumentit “Udhëzuesi i Studentëve”, studenti që kapet duke kopjuar në çfarëdo lloj provimi mësimor apo përfundimtar, përjashtohet nga provimi dhe vlerësohet me notën 4 (katër). Gjithashtu studentit të cilit i rezulton e kopjuar detyra e kursit ose diploma, pas verifikimeve të pedagogëve, vlerësohet me notën 4 (katër). Akti vlerësohet automatikisht si thyerje e kodit të etikës dhe meren masat përkatëse për thyerje të kodit të etikës. Një rikujtesë mbi plagjiaturën dhe kopjimin bëhet edhe në syllabuset e çdo lëndë të programit MP SIB, ku shpjegohet se shkelja penalizohet sipas përcaktimit në Kodin e Etikës së UMSH. <u>Evidenca 2: Kodi i Etikës</u> <u>Evidenca 24: Syllabuset e Lendeve te Ofruara per Vitin akademik</u> <u>Evidenca 38: Udhëzuesi i Studenteve</u>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Sipas dokumentit “Udhëzues i Studentëve” dhe RVB, mbi Vlerësimin e dijeve, thuhet se dorëzimi i vlerësimeve të provimeve komunikohet brenda 3 (tri) ditëve nga data e zhvillimit të tyre dhe rezultati bëhet i ditur nëpërmjet Sistemit SMS në kohë reale në llogaritë personale të çdo studenti. Referuar RVB, komponentët e tjerë hidhen në Sistemin SMS, në procesverbalin analitik online, brenda 5 (pesë) ditëve nga zhvillimi i provimit përfundimtar. Ashtu sic u përmend edhe në Kriterin 2 të Standardit 3, për çështje transparencë e për rrjedhojë meritë tezat sekretohen nga sekretaria. Pedagoget pas korigjimit duhet ti dërgojnë në sekretari për ti ç’sekretuar provimet dhe më pas të hedhin pikët në listën e studentëve pjesëmarrës në provim.

	<u>Evidenca 38: Udhëzuesi i Studenteve</u> RVB
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Ashtu sic u përmend edhe në kriterin e mësipërm (kriteri 6) studentët njihen me rezultatin e provimit brenda 3 (tri) ditëve nga data e zhvillimit të provimit dhe rezultatin e marë nëpërmjet sistemit SMS. Bazuar në dokumentin Udhëzues i Studentëve, në lidhje me kërkesën për rishikim të vlerësimit, ankimimi mund të kryhet në momentin e komunikimit të rezultatit dhe të konsumohet procedura e sqarimit me pedagogun e lëndës. Në rast se studenti nuk bie dakord, brenda 2 (dy) ditëve paraqet kërkesën me shkrim pranë sekretares së ciklit për trajtim nga Dekani dhe brenda 6 (gjashtë) ditësh Dekani komunikon vendimin e tij. <u>Evidenca 38: Udhëzuesi i Studenteve</u> RVB
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Bazuar në RVB dhe Rregulloren e Fakultetit të Informatikës theksohet, studenti i cili mendon se vlerësimi nga ana e pedagogut nuk është korrekt, ka të drejtë të bëjë njëankesë me shkrim të cilën e dorëzon në sekretarinë mësimore të fakultetit. Kërkesa i drejtohet Dekanit, i cili më pas është i detyruar të bëjë verifikimin e situatës. Nëse Dekani gjykon se ka pasur një gabim në vlerësim ose gabim në shënimin e notës, ai ngre një komision i cili bën rivlerësimin e tezës së provimit të dorëzuar, ose rimer studentin në provim. Personeli akademik i lëndës në këtë rast nuk mund të jetë anëtar i komisionit të rishikimit, por njoftohet për orën dhe datën e rishikimit <u>Evidenca 5: Rregullore e Fakultetit të Informatikës</u> RVB
Konkluzione	<i>GVJ mendon se institucioni ka implementuar një proces të drejtë dhe transparent të vlerësimit akademik që bazohet në meritë. Vlerësimi përfshin teste gjatë semestrit, detyra të ndryshme, dhe provime përfundimtare, të gjitha të para në syllabuset e lëndëve. Përdorimi i sistemeve elektronike si Google Classroom rrit transparencën, megjithatë, mungesa e një sistemi elektronik për provimet e ndërmjetme dhe përfundimtare mund të jetë një hap pas në garantimin e transparencës së plotë. Institucioni gjithashtu zbaton rregulla të qarta për ankimimin dhe rishikimin e vlerësimeve, duke siguruar të drejta të plota për studentët për të kundërshtuar vlerësimet.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Programi i studimit Master Profesional “Sistemet e Informacionit në Biznes”, Referuar dokumentit “Rregullore e Programit MP SIB”, ka si objekt kryesor të pajisë studentët me njohuritë e nevojshme për ndërtimin dhe zbatimin e sistemeve të informacionit në subjektet e biznesit të tregut shqiptarë. Ai garanton njëkohësisht sigurimin e informimit dhe kërkimit të vazhdueshëm në fushën e inovacionit, teknologjisë dhe ekonomisë, etj. Bazuar në RVB, ky program studimi është plotësisht i fokusuar në zhvillimin e njohurive në fushën ekonomike dhe informatike. GVJ mendon se IAL ka arritur të garantojë në mënyrë të kënaqshme zhvillimin e aftësive profesionale dhe të veçanta të studentëve, por <i>sugjerojmë përmirësimin e mëtejshëm të kurrikulës, azhurnimin e literaturave, si dhe shtimin e trajnimeve, certifikimeve, apo vetë pjesëve praktike në lëndët e profilit, sikurse kemi evidentuar në kriteret e tjera më sipër.</i> <u>Evidenca 6: Rregullore e Programit MP SIB</u> RVB
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Detyrat e ndryshme të kursit, projektet, literaturat ndihmëse në gjuhën angleze, mendojmë se zhvillojnë aspekte të komunikimit dhe ndërveprimit në grup. Këto detyra janë një mënyrë edhe për të analizuar kompetencat e aftësitë të studentëve e për të kuptuar më shumë nga pedagogu se çfarë ata kanë përfituar nga lënda. Bazuar në RVB, nëpërmjet lëndëve të programit MP SIB, studentëve ju ofrohen njohuri të avancuara për mënyrën se si organizatat përdorin teknologjitë dhe sistemet e informacionit. <u>Evidenca 24: Syllabuset e Lendeve të Ofruara për Vitin akademik</u> RVB
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e	Sipas RVB, pedagogu, një javë para provimit bën përsëritje për temat e trajtuara, përveçse ndalet edhe njëherë në çështjet më të rëndësishme të trajtuara gjatë semestrit, jep edhe orientimet e

studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	nevojshme se ku duhet të fokusohen studentët për përgatitjen e tyre në provim. Pedagogu mund të ndalet më gjatë në elementët që kanë rezultuar më të vështirë për t'u përvetësuar nga studentët, gjatë semestrit. Gjithashtu në dispozicion të studentëve janë edhe konsultat përpara provimit edhe gjatë orëve të takimit zyrtar, sipas grafikut të shpallur në fillim të semestrit. Ky komunikim mes pedagogut dhe studentëve, qartësimi i detajeve të ndryshme të lëndës, si dhe i gjithë procesi mësimor u vërtetua dhe nga vizita në institucion nga GVJ, ku studentët u shprehën mjaft të kënaqur. RVB Vizita IAL
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Në programin MP SIB, lëndë të caktuara të programit zhvillohen në laboratorët e informatikës, ku studentët e këtij masteri, anën teorike të leksioneve të marra e zbatojnë praktikisht. Kjo u konstatua nga GVJ gjatë vizitës në IAL. Gjithashtu, praktika profesionale është një lëndë e programit të studimit, e cila kryhet në pozicione pune sa më pranë fushës së studimit të programit, me synim rritjen e aftësive profesionale dhe integrimin më të mirë në tregun e punës. Sipas RVB dhe e konfirmuar gjatë vizitës në institucion, puna në grup dhe diskutimet janë një pjesë shumë e rëndësishme e procesit mesimor, për arritjen e objektivave mësimore pasi sa më shumë ide të shpalosen nga studentët aq më e thjeshtë bëhet të kuptuarit e leksionit dhe zgjidhja e problematikave të caktuara. Programi mësimor i MP SIB, në lëndët e tij ka krijuar një klimë të mirë për zhvillimin e ideve inovative e kjo lidhet ngushtë me vetë natyrën që programi ka. Duke qenë i orientuar drejt profileve informatike, me natyrë të aplikuar, pjesa e studimeve të avancuara kërkimore e shkencore nuk mbulohet nga ky program në mënyrë të drejtpërdrejtë. Këto profile i shohim që IAL i ka si fokus në programe të tjera studimi, të cilat studentët e Masterit Profesional mund t'i ndjekin në përfundim të tij. Një inkurajim i mirë që i jepet studentëve është për të marrë pjesë në projekte të ndryshme të shkëmbimit si ai Erasmus+. UMSH mbështet këshillat e studentëve nga ana logjistike dhe mund të financojë ata nëpër projekte të ndryshme. GVJ këtë e evidenton si një pikë të fortë të institucionit, kjo dhe falë bashkëpunimit të suksesshëm të zyrës së projekteve ku mundësohet

	shkëmbimi i studentëve në nivel ndërkombëtar nëpërmjet programeve Erasmus, projekt ky që ka funksionuar shkëlqyer e më së miri në gjithë tërësinë e tij. RVB Vizita IAL <u>Evidenca 12: Liste e Marreveshjeve të Bashkepunimit</u>			
Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Sipas RVB dhe listës së aktiviteteve të organizuara, Fakulteti i Informatikës dhe Departamenti Informatikë Biznesi realizon orë të hapura, trajnime, leksione të hapura etj, mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit, ku studentët kanë mundësinë e zgjerimit të dijeve dhe prezantimit me risi të reja në fushën ku ata studiojnë. Kjo u bë e ditur edhe gjatë vizitës në institucion, ku GJV u informua nga drejtuesit e njësisë bazë. <u>Evidenca 13: Lista e Aktiviteteve Organizuar nga Fakulteti i Informatikës</u> RVB Vizita IAL			
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	GVJ konstaton nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe gjatë takimit me përfaqësuesit e IAL, që angazhimi i studentëve në projekte të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare është një pjesë e rëndësishme e jetës universitare. Shumë studentë kanë përfituar dhe nga programet e shkëmbimit, si ai Erasmus+. <i>Në lidhje me studimet e avancuara kërkimore e shkencore apo mbështetja financiare e tyre, kjo nuk evidentohet në dokumentet e dorëzuara nga IAL.</i> https://www.umsh.edu.al/c/182/erasmus- https://www.umsh.edu.al/c/185/universiteti-mesdhetar			
Konkluzione	GVJ nënvizon përkushtimin e institucionit për të rritur aftësitë krijuese dhe zbatuese të studentëve. Programi u ofron studentëve mundësi për zhvillimin e kompetencave profesionale dhe shkencore përmes një kurrikule të orientuar drejt aplikimit të njohurive në praktikë, si dhe përmes angazhimit në praktika laboratorike dhe profesionale. Ky angazhim i studentëve në detyra praktike dhe projekte ndihmon në thellimin e njohurive të tyre dhe në integrimin më të mirë në tregun e punës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

			X	
--	--	--	---	--

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Bazuar në RVB dhe në vizitën pranë UMSH, program i studimit MP SIB përmbyll detyrimet akademike me provimin e formimit. Pasi ka shlyer të gjitha detyrimet akademike dhe financiare, studentët kanë të drejtë të hyjnë në provimin e formimit. Në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion, GVJ konstaton që institucioni harton rregullore të posaçme për provimin final apo atë të mbrojtjes së diplomës. Kështu, këto saktësohen në dokumentet: • Program Orientues për Provim Formimi • Rregullore e Programit MP SIB, Kreu VI, Neni 24 • Rregullore e Fakultetit të Informatikës, Kreu X, Neni 51, Neni 51, Neni 52 Nuk është e qartë se në çfarë formë, ky informacion i vihet në dispozicion studentit. Në RVB është vendosur si referencë Evidenca 26: Udhëzues për provimin e formimit, i cili nuk figuron në listën e dokumentave të vënë në dispozicion. GVJ rekomandon vënien në dispozicion të kësaj evidence. Gjatë vizitës në institucion, GVJ u informua që përcaktimin midis diplomës apo provimit, departamenti e bente në bazë të mesatares së ciklit të parë. Argumenti për këtë zgjidhje ishte kohëzgjatja një-vjeçare e programit master në fjalë. <u>Evidenca 25: Program Orientues per Provim Formimi</u> <u>Evidenca 6: Rregullore e Programit MP SIB</u> <u>Evidenca 5: Rregullore e Fakultetit te Informatikes</u> RVB Vizita IAL
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	Sipas RVB, gjatë hartimit të pyetjeve orientuese respektohet raporti: 40% pyetje të formimit të përgjithshëm dhe 60% pyetje të profilit sipas programit të studimit. Referencë për këtë është dhe Evidenca 26: Udhëzues për Provimin e Formimit, i cili mungon në listën e dokumentave të vënë në dispozicion. Ky raport mbi ndarjen e pyetjeve të provimit të formimit konfirmohet edhe nga dokumenti orientues për provim formimi. <u>Evidenca 25: Program Orientues per Provim Formimi</u>

	RVB
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Në bazë të RVB dhe programit orientues për provimin e formimit, institucioni ka vendosur që për programin MP SIB, duke qënë se fokusi i programit është përvetësimi i aftësive praktike profesionale nga ana e studentit, edhe provimi përfundimtar si detyrim përmbyllës, synon të testojë pikërisht këto aftësi të përfituara nga programi i studimit. Bazuar në po këto dokumente: • Pjesa e përgjithshme (40 pikë) përmban pyetje nga lëndet: Analiza dhe Projektimi i Sistemeve të Informacionit - 20 pikë dhe E-Biznes Studime të Thelluara - 20 pikë • Pjesa e profilit (60 pikë) përmban pyetje nga lëndët: Analiza dhe Projektimi i Bazave të të Dhënave - 20 pikë, Komunikimi i të Dhënave në Biznes - 20 pikë, dhe Programim i Avancuar në Web & Aplikime Mobile (nga 10 pikësecila lëndë, 20 pikë në total) Referuar Planit Mësimor, GVJ vë re se lëndët e tipit A (lëndë bazë) dhe B (lëndë karakterizuese) janë përfshirë të gjitha në provimin e formimit. Ndërkohë nga lëndët e tipit C (lëndë ndërdisiplinore), përfshihet vetëm 1(një) nga 3(tre) lëndët e paraqitura në planin mësimor. <i>GVJ rekomandon mundësisht përfshirjen e të gjitha lëndëve të kategorisë C në provimin e formimit.</i> <u>Evidenca 23: Plani Mesimor</u> <u>Evidence 25: Program Orientues per Provim Formimi</u> RVB
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Sic u theksua dhe më lart, bazuar në RVB dhe në vizitën pranë UMSH, program i studimit MP SIB përmbyll detyrimet akademike me provimin e formimit dhe jo me diploma. RVB Vizita IAL

Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Referuar RVB dhe relacionit të godinës, UMSH vë në dispozicion të studentëve të gjitha kapacitetet e tij logjistike dhe infrastrukture, si biblioteka, laboratorët, sallat, etj edhe jashtë orareve mësimore kur këta kërkojnë ti përdorin për kryerjen e praktikave të tyre mësimore, zhvillimin e projekteve etj. RVB <u>Evidence 42: Relacioni i godines</u>
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Sipas RVB, Provimi i programit MP SIB ka 10 kredite dhe vlerësohet me notë bazuar në pikët e grumbulluara nga studenti nga vlerësimi i tre anëtarëve të komisionit të korrigjimit të tezës. Shkalla e vlerësimit është e njëjtë me lëndët e tjera të këtij programi. Ndërkohë mungon evidenca 26: Udhëzues për provimin e formimit dhe nuk ka informacion se çfarë ndodh kur studenti vlerësohet me notë jo kaluese në provimin përfundimtar. RVB
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Bazuar në rregulloren e programit MP SIB, Kreu 5, Neni 24, në përfundim të punimit të diplomës ose provimit, studentët pajisen me Diplomë të ciklit të dytë: Master Profesional në Sistemet e Informacionit në Biznes. Bazuar në rregulloren e Fakultetit të Informatikës, Kreu X, Neni 53 si dhe Rregullore e Organizimit UMSH, Kreu X, Neni 75, theksohet se pas përfundimit me notë kaluese në Provimin përfundimtar të formimit ose pas mbrojtjes së temës së diplomës, studenti pajiset me diplomën e nivelit përkatës dhe suplementin e diplomës. • Diploma plotësohet me bojë teknike dhe me shkrim dore, e nënshkruar nga Rektori i UMSH dhe Dekani i Fakultetit të Informatikës me gradat përkatëse. Në fund diploma vulolet me vulën e UMSH. • Bashkëlidhur me diplomën jepet edhe Suplementi i Diplomës i cili përmban të dhëna të plotatë vlerësimeve dhe krediteve (ECTS) për secilën lëndë. Formati i diplomës dhe suplementi i saj janë dokumente të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Megjithatë mungon një dokument mbështetës në lidhje me vendimin e ministrisë përgjegjëse. <u>Evidenca 5: Rregullore e Fakultetit të Informatikës</u> <u>Evidenca 6: Rregullore e Programit MP SIB</u> <u>Evidenca 9: Rregullore e organizimit UMSH</u> <u>Evidenca 43: Suplementi i Diplomes</u>

	<u>Evidenca 44: Model Diplome</u>			
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Sipas RVB, por edhe nga vizita e kryer në institucioni, GVJ konstatoi që institucioni ruan duke magazinuar për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse ato kërkohen. Nga depozitimet përkatëse të dokumentacioneve mund të gjendet në çdo moment një kopje respektive duke verifikuar zbatimin e rregullores në çdo pike. RVB			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se institucioni ka një procedurë të qartë për përmbylljen e detyrimeve të studentit, duke e përgatitur me dokumentacionin e nevojshëm për provimin e formimit. Institucioni siguron rregullore specifike për detyrimet përmbyllëse, të cilat janë publike, por rekomandohet që të përmirësohet qartësia dhe aksesibiliteti i këtyre dokumenteve për studentët. Strukturat përgjegjëse ndihmojnë studentët me udhëzime dhe materialet e nevojshme, përfshirë një përqindje të caktuar të pyetjeve nga profili specifik në provimin e formimit. Komisioni i posaçëm vlerëson njohuritë e studentëve bazuar në pesha të caktuara të lëndëve. Në fund, studentët vlerësohen me notë dhe, pas suksesit në provimin përfundimtar, pajisen me diplomë dhe suplementin e diplomës. Institucioni gjithashtu ruan dokumentacionin e studentëve në përputhje me legjislacionin. Rekomandohet që të gjitha lëndët ndërdisiplinore të përfshihen në provimin e formimit për të siguruar një vlerësim të plotë dhe gjithëpërfshirës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose	Referuar dokumentacionit si dhe vizitës në IAL, Studentët e programit Master Profesional “Sistemet e Informacionit në Biznes”, zhvillojnë tema të caktuara në ambjentet laboratorike të institucionit. Për tu ambjentuar dhe me mjedisin real të punës, ata

jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	zhvillojnë dhe praktikat profesionale në formën e internship pranë institucioneve, me të cilët IAL ka marrëveshje. <u>Evidenca 12: Listmarveshje e Bashkepunimeve</u> Vizita IAL			
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Referuar RVB ky kriter është cilësuar si N/A. Ndërkohë GVJ konstaton se duke ju referuar bisedave me studentët dhe stafin gjatë vizitës në IAL si dhe listës së marrëveshjeve të bashkëpunimit ku studentët kryejnë praktika profesionale apo intershipe pranë këtyre institucioneve, studentët kanë mundësinë dhe njihen me format dhe teknologjitë e përdorura në tregun e punës shqiptar, me qëllim përfitimin sa më të mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale që lidhen me këtë fushë në të cilën ata po studiojnë, si dhe për të orientuar dhe kualifikimin e tyre profesional përtej studimeve të ciklit të dytë. <u>Evidenca 12: Listmarveshje e Bashkepunimeve</u> Vizita IAL			
Kriteri 3. Praktikrat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Sipas pasqyrës të Planit mësimor lënda Praktika profesionale ka 6 ECTS. Sipas Rregullores të Departamentit InfomratikëBiznesi, janë të detajuara rregullat që duhet të shoqërojnë zhvillimin e Praktikave Profesionale. Sipas Nenit 26, pika 6 e këtij dokumenti, Studenti pas përfundimit të praktikës përgatit një raport për punën e kryer, sipas specifikës së praktikës së tij. Raporti i përgatitur kontrollohet nga pedagogu përkatës dhe studenti merr vlerësimin me notë për praktikën. <u>Evidenca 15: Rregullore e departamentit IB</u> <u>Evidenca 23: Plani Mesimor</u> Vizita IAL			
Konkluzione	<i>GVJ shpreh se institucioni ka aplikuar një model efektiv në përdorimin e praktikave laboratorike dhe profesionale për të nxitur zbatimin praktik të njohurive. Praktikrat laboratorike brenda institucionit dhe praktikrat nëpërmjet partneriteteve me institucione të ndryshme tregojnë një lidhje të fortë mes teorisë dhe praktikës. Kjo siguron që studentët jo vetëm të mësojnë, por edhe të ambientohen me mjedisin real të punës. Gjithashtu, dokumentimi i këtyre praktikave në formën e krediteve dhe raporteve të detajuara të punës tregon një përkushtim ndaj vlerësimit të plotë dhe dokumentimit të përvojave praktike të studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																																
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Univ. Mesdhetar (UMSH), GVJ konstaton se departamenti përgjegjës për këtë program studimi mban të dhëna në lidhje me stafin akademik të përfshirë në mësimdhënie, ku përfshihet personeli akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme që angazhohet çdo vit, lëndët që zhvillon secili prej tyre, ngarkesa për cdo disiplinë, ngarkesa semestrale dhe ajo totale. Personeli akademik që angazhohet në realizimin e programit të studimit Master Profesional “Sistemet e Informacionit në Biznes”, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, sipas tabelës më poshtë : <table><tr><th rowspan="2">Stafit akademik i programit të studimit</th><th colspan="2">2020-2021</th><th colspan="2">2021-2022</th><th colspan="2">2022-2023</th></tr><tr><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof. Dr</td><td>2</td><td>0</td><td>2</td><td>1</td><td>2</td><td>0</td></tr><tr><td>Prof. Asoc.</td><td>1</td><td>0</td><td>1</td><td>0</td><td>0</td><td>0</td></tr><tr><td>Dr/Phd</td><td>3</td><td>0</td><td>3</td><td>0</td><td>5</td><td>0</td></tr><tr><td>Msc.</td><td>1</td><td>0</td><td>1</td><td>0</td><td>1</td><td>1</td></tr><tr><td>Gjithsej</td><td>7</td><td>0</td><td>7</td><td>1</td><td>8</td><td>1</td></tr></table>	Stafit akademik i programit të studimit	2020-2021		2021-2022		2022-2023		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof. Dr	2	0	2	1	2	0	Prof. Asoc.	1	0	1	0	0	0	Dr/Phd	3	0	3	0	5	0	Msc.	1	0	1	0	1	1	Gjithsej	7	0	7	1	8	1
Stafit akademik i programit të studimit	2020-2021		2021-2022		2022-2023																																												
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																																											
Prof. Dr	2	0	2	1	2	0																																											
Prof. Asoc.	1	0	1	0	0	0																																											
Dr/Phd	3	0	3	0	5	0																																											
Msc.	1	0	1	0	1	1																																											
Gjithsej	7	0	7	1	8	1																																											
	Evidenca:																																																

	Raporti i vleresimit te brendshem periodik MP SIB.pdf Evidenca nr 7. Cv e stafit akademik ne programin e studimit.pdf Aneks_Tabela,tabelat 6-6.3 MP_SIB.pdf																				
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në UMSH, GVJ konstaton se universiteti ka një rregullore në të cilën përcaktohet procedura e ndarjes se ngarkeses. Bazuar në tabelën 12, Aneks Tabelat Përmbledhëse, Personeli akademik efektiv në vitin akademik 2020-2021, mbulon 100% të ngarkesës mësimore për programin e studimit Master Profesional “Sistemet e Informacionit në Biznes”. Stafi akademik efektiv mbulon ngarkesën e orëve mësimore mbi 70%. Kërkesa ligjore që stafi akademik PAE të mbulojë të paktën 70% te ngarkesës përmbushet plotësisht. Ngarkesa e orëve mësimore i stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi, për tre vitet e fundit akademike, është sipas tabelës me poshtë : <table><tr><th>Viti</th><th>Total orësh</th><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE/PAK (%)</th></tr><tr><td>2020-2021</td><td>480</td><td>480</td><td>0</td><td>100%</td></tr><tr><td>2021-2022</td><td>480</td><td>420</td><td>60</td><td>87.5 % / 12.5%</td></tr><tr><td>2022-2023</td><td>480</td><td>420</td><td>60</td><td>87.5 % / 12.5%</td></tr></table> Evidenca : Aneks tabelat përmbledhëse (tabela 12)	Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)	2020-2021	480	480	0	100%	2021-2022	480	420	60	87.5 % / 12.5%	2022-2023	480	420	60	87.5 % / 12.5%
Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)																	
2020-2021	480	480	0	100%																	
2021-2022	480	420	60	87.5 % / 12.5%																	
2022-2023	480	420	60	87.5 % / 12.5%																	
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në UMSH, GVJ konstaton se UMSH ka kontrata pune me secilin punonjës të stafit akademik PAE dhe PAK. Çdo fillim viti zyra e burimeve njerëzore në bashkëpunim me departamentin dhe fakultetin përgjegjës për programin Master Profesional në "Sistemet e Informacionit në Biznes" përditësojnë listën e personelit akademik. Në zyrën e burimeve njerëzore gjenden dosjet e personelit, në të cilat përfshihen kontratat e punës, raportet e vlerësimit gjatë rekrutimit, cv, diploma, kualifikime etj. Kohëzgjatja e kontratës së punës për stafin akademik me kohë të plotë dhe të pjesshëm ishin me kohë zgjatje të ndryshme, sipas specifikave dhe kategorive të ligjit në fuqi, përkatësisht me kohëzgjatje të pa përcaktuar, njëvjeçare, semestrale etj. Rinovimi i kontratës bëhet në bazë të performancës dhe vlerësimit cilësor në																				

	fushën e mësimdhënies, punës kërkimore, si dhe duke kontribuar në mbështetjen dhe zhvillimin e institucionit. GVJ vëren paqëndrueshmëri në personelin akademik të angazhuar në programin e studimit, vërehet në evidencat e ofruara nga IAL-ja.
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriterë të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Bazuar në RVB-në e paraqitur nga UMSH dhe në varësi të nevojave të departamentit, Fakulteti i Informatikës, i paraqet [Evidenca nr 5. Rregullore e Fakultetit të Informatikës.pdf] zyrës së Burimeve Njerëzore kërkesën për fillimin e procesit të rekrutimit [Evidenca nr 49. Permbledhje e procedurës së rekrutimit.pdf]. Zyra e Burimeve Njerëzore e shpall vendin vacant në faqen zyrtare të universitetit, https://www.umsh.edu.al/d/386/konkurs-per-vende-pune-prane-universitetit-mesdhetar-i-shqiperise. Aplikantët ftohen të dërgojnë online dokumentacionin e specifikuar në thirrjen e shpallur. Evidenca: Evidenca nr 5. Rregullore e Fakultetit të Informatikës.pdf Evidenca nr 49. Permbledhje e procedurës së rekrutimit.pdf
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në IAL, personeli ndihmës akademik është angazhuar për realizimin e orëve laboratorike dhe mirëmbajtjen e mjediseve lab. [Aneksi Tabela MP SIB.pdf]. Në bashkëpunim me personelin akademik ata përcaktojnë nevojat e laboratorit në lidhje me programin e studimit. Evidenca: Raporti i vlerësimit të brendshëm periodik MP SIB.pdf
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit	GVJ zgjodhi në mënyrë të rastësishme dosje të pedagogëve të brendshëm dhe të jashtëm, nga ku konstaton se Zyra e Burimeve Njerëzore ka dosjet me dokumentat përkatëse për të gjithë personelin, ku për çdo pedagog të programit disponon të dhënat e kualifikimeve të tij/ të saj, kontratat e punës, dokumente që lidhen me vjetërsinë në punë, të dhëna për zhvillimin e vijueshëm profesional. Evidenca: Vizita në IAL Evidenca nr 7. Cv e stafit akademik në programin e studimit.pdf Evidenca nr 27. Te dhënat përmbledheve për stafin akademik, kualifikimet.pdf

akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.				
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	UMSH ka lidhur një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi në rang Universiteti. Janë marrëveshje me Universitete Kombëtare/ Ndërkombëtare, institucione ose kompani. Këto marrëveshje shërbejnë për praktikën dhe punësimin e studentëve të këtij program studimi. Evidenca: Evidenca nr 12. Liste marreveshje te bashkepunimit-1.pdf			
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Kurrikula e programit Master Profesional në "Sistemet e Informacionit në Biznes", ka në përbërje Praktikën Profesionale sipas ngarkesës së përcaktuar në Ligjin e Arsimit të Lartë. [Evidenca nr 6. Rregullore e programit MP SIB.pdf]. UMSH ka një udhëzim [Evidenca nr 20. Dosja Praktikes.pdf] të miratuar për Praktikën Profesionale, ku shpjegohet procedura e organizimit dhe menaxhimit Evidenca: Evidenca nr 6. Rregullore e programit MP SIB.pdf Evidenca nr 20. Dosja Praktikes.pdf Evidenca nr 21. Formulari i praktikës se studenteve.pdf			
Konkluzione	GVJ konstaton se në Fakultetin e Informatikës, programi Master Profesional në "Sistemet e Informacionit në Biznes", personeli akademik efektiv dhe ndihmës akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet në përputhje me fushën e programit, të mësimdhënies të programit të studimit. GVJ vëren se mbulimi i ngarkesës nga PAE është mbi 70%,			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	GVJ nga vizita në institucion konstaton se hapësira ku zhvillohen shumica e lëndëve të këtij programi studimi. Sallat kanë hapësirën e nevojshme për të ushtruar mësimdhënien në kushte të mira dhe komode për studentët. Secili mjedis disponon ajrosjen dhe ndriçimin e duhur, sistem mbrojtje nga zjarri edhe ajër të kondicionuar. Evidenca: <u>Evidenca nr 42. Relacioni i Godines.pdf</u> Vizita GVJ në institucion
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	GVJ konstaton se hapësira ku zhvillohen shumica e lëndëve të këtij programi studimi, ka kompjuter dhe videoprojektor funksional. Sallat kanë hapësirën e nevojshme për të ushtruar mësimdhënien në kushte të mira dhe komode për studentët. Labororet garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik referuar kurseve informatike të <i>programit të studimit Master Profesional në "Sistemet e informacionit në biznes"</i> Në [Evidenca nr 42. Relacioni i Godines.pdf] jepet një informacion rreth infrastrukturës së UMSH por jo specifikisht për programin e studimit. Në dokumentin me komente të ofruar nga UMSH, sqarohet hapësira e dedikuar të programit të studimit. UMSH disponon 4 laboratore dhe në atë kohë laborator i pestë ishte në proces. Aktualisht UMSH disponon 5 laboratore funksional. Evidenca: Vizita GVJ në institucion <u>Evidenca nr 42. Relacioni i Godines.pdf</u>
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave	Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në ambientet e IAL-së, GVJ konstaton se laboratorët janë të pajisur me aparatura dhe mjete të nevojshme për të trajtuar lëndë të shkencave kompjuterike duke siguruar një mësimdhënie të orientuar nga praktika. Evidenca: Vizita GVJ në institucion

formues të programit të studimit në tërësi.			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në ambientet e IAL-së, GVJ konstaton se UMSH ka laborator të dedikuar për programin e studimit, i cili është i pajisur me aparatura dhe mjete të nevojshme për të trajtuar lëndë të shkencave kompjuterike. Evidenca: Vizita ne IAL		
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorie me kapacitetet e nevojshme.	Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në ambientet e IAL-së, GVJ konstaton se Institucioni ofron mjedise të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Evidenca: Vizita ne IAL Evidenca nr 42. Relacioni i Godines.pdf Evidenca nr 12. Liste marreveshje te bashkepunimit-1.pdf Evidenca nr 17. Lista IAL me UMSH.pdf		
Konkluzione	GVJ konstatoi se UMSH ka mjedise mësimore dhe infrastrukturë të përshtatshme për realizimin e procesit të mësimdhënies. Në dispozicion të studentëve janë auditorë dhe laboratorë në përmbushje të kërkesave të programit të studimit.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB, GVJ konstaton se çdo lektor i vendos studentëve në dispozicion syllabusin e lëndës në të cilin ndodhet literatura bazë dhe ndihmëse. [Evidenca nr 24. Syllabuset e lendeve te ofruara per vitin akademik-1.pdf] Materialet në formë elektronike gjëndën në klasat virtuale të krijuar në platformën google classroom. Gjithashtu UMSH disponon një bibliotekë në të cilën të gjithë studentët mund të aksesojnë literaturën e sugjeruar. Referuar syllabus-eve te paraqitura si evidenca, verehet nje literature ne perputhje me permbajtjen e kursit, e cila ofrohet ne shqip. GVJ rekomandon: • <i>që të azhurnohet literatura brenda 5 viteve të fundit.</i> Evidenca: Evidenca nr 24. Syllabuset e lendeve te ofruara per vitin akademik-1.pdf Evidenca nr 53. Manual mbi perdorimin e bibliotekes online.pdf Evidenca nr 54. Kerkese per libra.pdf
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	GVJ konstaton se çdo fillim viti akademik, përgjegjësi i njësisë bazë dhe koordinatori i programit të studimit në bashkëpunim me pedagogët e lëndës sugjerojnë dhe përditësojnë syllabuset e lëndeve. Evidenca: Raporti i vleresimit te brendshem periodik MP SIB.pdf
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Tek UMSH, ka nje bibliotekë mësimore, e cila i krijon mundësi studentëve të aksesojnë fizikisht dhe online materialet dhe tutorialet e nevojshme. Literaturat në bibliotekë shtohen sipas kërksave të departamenteve, të cilët pasqyrojnë kërkesat e stafit akademik. Biblioteka online që ofron UMSH janë COBISS dhe Edwarg Publishing. Evidenca: Raporti i vleresimit te brendshem periodik MP SIB.pdf Evidenca nr 53. Manual mbi perdorimin e bibliotekes online.pdf Evidenca nr 54. Kerkese per libra.pdf
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të	Bazuar në vizitën në IAL, u verifikua që UMSH, ofron një bibliotekë fizike dhe online. Biblioteka është e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore në gjuhën shqipe dhe të huaj, libra dhe revista shkencore. Evidenca: Index of /EbooksServer (umsh.edu.al)

mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	https://plus.cobiss.net https://www.e-elgar.com
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	UMSH krijon kushte të barabarta dhe pa pagesë për studentët, Biblioteka është në dispozicion të studentëve sipas orarit zyrtar 8.00-16.00, dhe ofron disa burime online te aksesueshme, si [Index of /EbooksServer (umsh.edu.al)], [https://plus.cobiss.net], [https://www.e-elgar.com], që janë në përgjigje edhe të nevojave të studentëve. Evidenca: Evidenca nr 53. Manual mbi perdorimin e bibliotekes online.pdf
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në UMSH, GVJ konstaton se në bibliotekë ka hapësirë, për të mundësuar një përdorim sa më eficient të burimeve që biblioteka ka apo ofron. Evidenca: <i>Vizita ne IAL</i>
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka është në dispozicion të studentëve në orare zyrtare 8.00-16.00, dhe jo vetëm. Këto orare në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor, janë në përgjigje edhe të nevojave të studentëve. Në hyrje të IAL-së janë të afishuara oraret e aksesit në bibliotekë. Evidenca: Raporti i vleresimit te brendshem periodik MP SIB.pdf Evidenca nr 53. Manual mbi perdorimin e bibliotekes online.pdf <i>Vizita ne IAL</i>
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit,	Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit të studimit <i>Master Profesional në "Sistemet e Informacionit në Biznes"</i> , çdo fillim viti akademik zhvillojnë procedurën për pasurimin e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online përmes një kërkesë të departamentit bazuar në kërkesat e stafit. Evidenca: Raporti i vleresimit te brendshem periodik MP SIB.pdf Evidenca nr 54. Kerkese per libra.pdf

shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.				
Konkluzione	<i>GVJ konstatoi se çdo lektor i vendos studentëve në dispozicion syllabusin e lëndës në të cilin ndodhet literatura bazë dhe ndihmëse. Literatura e cila ofrohet në format elektronik ose të printuar, mund të përdoren nga studentët për të marrë njohuritë në kurset e programit që ato ndjekin. Materialet në formë elektronike gjenden në klasat virtuale të krijuar në platformën google classroom. UMSH disponon një bibliotekë në të cilën të gjithë studentët mund të aksesojnë literaturën e sugjeruar.</i> <i>GVJ rekomandon të pasurohet literatura brenda 5 viteve të fundit, si dhe të pasurohet biblioteka me literature në fushën e Informatikës dhe Shkencave Kompjuterike.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	UMSH disponon një sistem të menaxhimit të dedikuar, [Evidenca nr 41. Udhezues per perdorimin e SMS-se.pdf] nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët. Ky sistem përdoret që nga viti 2017. Që në momentin e regjistrimit, studentët pajisen me kredencialet përkatëse për t'u logg-uar në system, ku marrin informacionin e nevojshëm në lidhje me arritjet e tyre akademike. Ky sistem shërben si urë komunikimi ndërmjet stafit administrative dhe studentëve. Evidenca: Vizita ne IAL Raporti i vleresimit te brendshem periodik MP SIB.pdf http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi Menaxhimit Uni Mesdhetar

Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Sistemi i brendshëm i menaxhimit, [Evidenca nr 41. Udhezues per perdorimin e SMS-sc.pdf] administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit PAE/PAK, personelit ndihmësakademik, dhe zyrave përkatëse, siç është psh. Sekretaria. Evidenca: Vizita ne IAL Raporti i vleresimit te brendshem periodik MP SIB.pdf http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi Menaxhimit Uni Mesdhetar Evidenca nr 41. Udhezues per perdorimin e SMS-sc.pdf
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Sistemi i menaxhimit në UMSH siguron akses në informacione e dokumente për të gjithë personelin PAE/PAK dhe studentët e programit të studimit. Ky funksion vërehet kryesisht në sekretarinë mësimore të UMSH, ku gjenerohen dokumente si procesverbalet, vërtetimet etj.
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Sistemi i menaxhimit në UMSH nuk ka të integruar platforma dhe module interaktiv në lidhje me shkëmbimin e informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve. Stafi akademik përdor klasat virtual, përmes Google Classroom, për shkëmbimin e informacionit ndërmjet tyre dhe studentëve. <i>GVJ sugjeron që në sistemin e menaxhimit të UMSH të integrohen platforma të standartizuara që mundësojnë format e komunikimit interaktiv ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</i>
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Sistemi i menaxhimit në UMSH, monitoron aktivitetin akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale. Raportimet paraqesin informacion për arritjet akademike, prezenca në IAL, kërkimi shkencor etj. Referuar RVB-së (Raporti i vleresimit te brendshem periodik MP SIB.pdf, Standarti IV.4, Kriteri 5) thuhet që këto raporte përpunohen përmes sistemit të menaxhimit UMSH, por nuk ka një evidencë që e dokumenton. <i>GVJ sugjeron që mënyra si përpunohen përmes sistemit të menaxhimit këto raporte të shtohen në evidencë.</i> Evidenca:

	Raporti i vleresimit te brendshem periodik MP SIB.pdf Vizita ne IAL			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Informacionet që lidhen me programin e studimit Master Profesional në "Sistemet e Informacionit në Biznes", personelin akademik dhe aktivitete të ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, gjuha shqipe dhe gjuha angleze. Evidenca: Raporti i vleresimit te brendshem periodik MP SIB.pdf https://www.umsh.edu.al/ https://www.umsh.edu.al/c/220/fakulteti-i-informatikes			
Konkluzione	UMSH disponon një sistem të menaxhimit të dedikuar, nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me stafin dhe studentët. E gjithë procedura akademike dhe administrative realizohet përmes këtij sistemi. Sistemi i menaxhimit siguron akses për të gjithë personelin akademik dhe studentët e programit të studimit. GVJ rekomandon që: ✓ procesi si përpunohen këto raporte përmes sistemit të menaxhimit të shtohen në evidencë. ✓ në sistemin e menaxhimit të UMSH të integrohen platforma që mundësojnë format e komunikimit interaktiv ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të	Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në UMSH, GVJ konstaton se në fillim të çdo viti akademik, administratori depoziton raporte nga fakultetet dhe njësitë bazë të universitetit për të mbledhur informacion mbi nevojat e tyre specifike. Propozimet miratohen nga Bordi i Administrimit. Në fillim të çdo viti akademik hartohet

studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	buxheti, i cili pasqyron shpenzimet bazuar në kërkesat e departamenteve dhe të ardhurat e IAL-së. Evidenca: Evidenca nr 55. Raporti Financiar.pdf Evidenca nr 58. Rregullore e bordit te administrimit.pdf
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	GVJ konstaton se UMSH të ardhurat parësore i ka nga tarifat e studentëve të cilat janë pasqyruar në kontratat individuale me secilin nga studentët. Burimet financiare të IAL-së janë të ardhurat e realizuara nga vetë institucioni. Shpenzimet për vitin 2022 janë në vlerën 114,686,891 dhe ato janë të ndara sipas: • 43% shpenzime qeraje. • 51% shpenzime për shërbime • 6% shpenzime per botime shkencore dhe konferenca GVJ rekomandon: ⇒ <i>që të azhurnohet informacioni për buxhetin për vitin 2023.</i> Evidenca: Evidenca nr 55. Raporti Financiar.pdf Evidenca nr 1. Statuti i UMSH.pdf
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	GVJ konstaton se pasqyrat financiare auditohen çdo vit, raporti i pasqyrave financiare i nënshtrohet kontrollit sipas standardeve kombëtare. Institucioni kryen auditime të përvitshme, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Të ardhurat për këtë program studimi bazohen kryesisht: ✓ nga tarifat e studentëve Evidenca: Evidenca nr 55. Raporti Financiar.pdf
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	UMSH në fillim të çdo viti harton buxhetin vjetor, çdo njësi drejtuese informohet në lidhje me realizimin e buxhetit të vitit paraardhës.

Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	Institucioni harton një raport financiar i cili miratohet nga Bordi i Administrimit. Zyra e financë kontabilitetit është përgjegjëse për zbatimin dhe menaxhimin e planit financiar.			
Konkluzione	GVJ konstatoi se në UMSH çdo fillim viti hartohen pasqyrat financiare, ku përfshihen kërkesat dhe nevojat e njësisë bazë dhe programit të studimit. Të ardhurat për këtë program studimi bazohen kryesisht në tarifat e studentëve. GVJ rekomandon: ⇒ që të azhurnohet informacioni për buxhetin, për vitin 2023.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1 Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin	GVJ konstatoi se UMSH, afishon çdo vit programet e akredituara. Procedurat dhe kriteret janë të përcaktuara në rregulloren e programit të studimit [Evidenca nr 6. Rregullore e programit MP

e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	SIB.pdf] dhe rregulloren e fakultetit. Deri më sot, në këtë program studimi, Master profesional ‘Sistemet e Informacionit në Biznes’, nuk ka patur raste studentësh të transferuar. GVJ rekomandon të plotësohet tabela 21 sipas formatit ASCAL Evidenca: Evidenca nr 1. Statuti i UMSH.pdf Evidenca nr 5. Rregullore e Fakoltetit te Informatikes.pdf Evidenca nr 6. Rregullore e programit MP SIB.pdf
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	GVJ konstatoi se programi i studimit Master profesional ‘Sistemet e Informacionit në Biznes’ mund të ndiqet nga çdo shtetas shqiptar, etnitë jashtë kufijve shtetërore si dhe çdo shtetas i huaj, në bazë të legjislacionit në fuqi. UMSH krijon mundësi komunikimi me ambjentin e jashtëm nëpërmjet web-it zyrtar (https://www.umsh.edu.al/), focus grupeve, etj. PKPSSC është një njësi që ndjek studentët gjatë kohës së studimeve dhe përtej. Kjo zyrë ofron transparencë në lidhje me procedurat dhe çështjet akademike, mësimore, shkencore, gjithashtu afron studentët në tregun e punës. Evidenca: Evidenca nr 1. Statuti i UMSH.pdf Evidenca nr 34. Rregullore e studentev eme aftesi ndryshe.pdf Evidenca nr 61. Rregullore per organizimin dhe PKPSSC.pdf
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	GVJ konstaton se çdo vit akademik, referuar urdhërit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, për regjistrimet dhe transferimet, publikon në web-in dhe hapësirat publike të UMSH, informacion lidhur me programet e studimit dhe kriteret përkatëse. GVJ rekomandon të përcaktohen më qartë kriteret e pranimit dhe kuotat e kandidatëve. Evidenca: Evidenca nr 6. Rregullore e programit MP SIB.pdf Evidenca nr 38. Udhëzuesi i Studenteve.pdf
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose	GVJ konstatoi se kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, vlerësimet gjatë kursit të studimit, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të aksesueshme përmes faqes web të UMSH. Theksojmë që informacioni i publikuar në lidhje me kriteret e pranimit i referohet tërësisht legjislacionit në fuqi, nuk ka të afishuara kriteret shtesë.

të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Evidenca: <u>Evidenca nr 1. Statuti i UMSH.pdf</u> <u>Evidenca nr 4. Strategjia e zhvillimit të programit MP SIB.pdf</u> <u>Evidenca nr 6. Rregullore e programit MP SIB.pdf</u>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	GVJ konstatoi nga vizita në IAL dhe evidencat, se përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit. Këto kriteret bëhen publike në faqen web të UMSH (Universiteti Mesdhetar (umsh.edu.al)). Gjithashtu zhvillohen takime me Fokus grupet, ku maturantët mund të shkëmbejnë ide. Evidenca: <u>Evidenca nr 1. Statuti i UMSH.pdf</u> <u>Evidenca nr 6. Rregullore e programit MP SIB.pdf</u> Ueb: https://www.umsh.edu.al/c/150/kriteret-e-pranimit
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	GVJ konstatoi nga vizita në IAL dhe evidencat se përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit, në përputhshmëri me Ligjin 80/2015 dhe Urdhërit përkaës të përvitshëm të MAS për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta dhe të pakicave kombëtare. Evidenca: <u>Evidenca nr 34. Rregullore e studentev eme aftesi ndryshe.pdf</u>
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	GVJ konstatoi se në fillim të çdo viti akademik, UMSH informon të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit, në përputhshmëri me Ligjin 80/2015 dhe Urdhërit përkaës të përvitshëm të MAS për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera. GVJ rekomandon që UMSH të përcaktojë mekanizma dhe kriteret shtesë për përthithjen e studentëve me mesatare të lartë.
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	GVJ konstatoi nga vizita në IAL se UMSH ka përcaktuar politika të ndihmës/bursave për shtresat në nevojë bazuar në Ligjin 80/2015 dhe Urdhërit përkatës të përvitshëm të MAS. Gjithashtu me mbështetjen e Bordit të administrimit, ofron tarifa të reduktuara për studentët në nevojë dhe studentët ekselentë. Evidenca: <u>Evidenca nr 1. Statuti i UMSH.pdf</u> web: https://www.umsh.edu.al/c/110/bursat

	Evidenca nr 58. Rregullore e bordit te administrimit.pdf			
Konkluzione	GVJ konstatoi se UMSH harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit Master Profesional "Sistemet e Informacionit në Biznes". Universiteti përdor faqen zyrtare të webit, si mjet komunikimi gjithëpërfshirës. UMSH ofron mundësinë e regjitrimit në këtë program, studentëve shqiptarë, të huaj etj. Universiteti ofron bursa për studentët me arritje të larta dhe bursa sociale. GVJ rekomandon që UMSH të përcaktojë mekanizma dhe kritere shtesë për përthithjen e studentëve me mesatare të lartë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	GVJ konstatoi nga vizita në IAL dhe RVB e dorëzuar në sistem se UMSH vë në dispozicion një informacion të plotë në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. Ky informacion publikohet në formë të shkruar, brenda mjediseve të UMSH; Koordinator i programit të studimit ndjek studentët dhe koordinon procesin akademik brenda dhe jashtë vendit. Evidenca: Evidenca nr 6. Rregullore e programit MP SIB.pdf Evidenca nr 38. Udhezuesi i Studenteve.pdf
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Në programin e studimit master professional "Sistemet e Informacionit në Biznes", nuk ka patur raste transferimi të studentëve. Megjithatë procedura është e paraqitur qartë në Rregulloren e programit MP SIB dhe procedura e transferimit të studenteve. Evidenca: Evidenca nr 38. Udhezuesi i Studenteve.pdf

Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	<u>Evidenca nr 56. Procedura e transferimit te studenteve.pdf</u> Bazuar ne dokumentacionin e ofruar nga IAL-ja dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi që institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve të studentëve në programin e studimit. Në orën e parë të mësimit bëhet prezantimi i programit të lëndës dhe vlerësimit përkatës. Evidenca: <u>Evidenca nr 59. Java e pare orientimit UMSH.pdf</u> <u>Evidenca nr 24. Syllabuset e lendeve te ofruara per vitin akademik-1.pdf</u> <u>Evidenca23 MP SIB.pdf</u> <u>Aneks Tabela MP SIB.pdf</u> <u>Evidenca nr 38. Udhezuesi i Studenteve.pdf</u>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	GVJ konstatoi që institucioni informon studentët në lidhje me procedurat e diplomimit të studentëve në programin e studimit Master Professional “Sistemet e Informacionit në Biznes”. UMSH ka hartuar një rregullore, “Rregullore e ZKSK”, ku tregohet plani i mbështetjes së studentëve. Evidenca: <u>Evidenca nr 14. Rregullore e ZKSK.pdf</u> <u>Evidenca nr 38. Udhezuesi i Studenteve.pdf</u> <u>Evidenca nr 6. Rregullore e programit MP SIB.pdf</u> <u>Evidenca nr 25. Program Orientues per Provimin e Formimit.pdf</u>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	UMSH përdor mjete të ndryshme informimi, përmes publikimit të informacionit në rrjetet sociale që ai menaxhon, ambientet e IAL-së, fletëpalosje dhe broshura, të cilat japin informacion rreth përshkrimit të programit të studimit, objektivat, kriteret, mundësitë e punësimit, kurrikulën etj. UMSH organizon javën e orientimit të studentëve, takime dhe diskutime me Fokus grupet etj. Evidenca: <u>Evidenca nr 31. Procedura e punes me fokus grupet.pdf</u> <u>Evidenca nr 14. Rregullore e ZKSK.pdf</u> <u>Evidenca nr 53. Manual mbi perdorimin e bibliotekes online.pdf</u> <u>Evidenca nr 59. Java e pare orientimit UMSH.pdf</u> <u>Evidenca nr 13. Lista e aktiviteve te organizuara nga FI.pdf</u>
Konkluzione	<i>GVJ konstatoi se UMSH përdor mjete të ndryshme informimi, përmes publikimit të informacionit në rrjetet sociale që ai menaxhon, ambientet e IAL-së, fletëpalosje dhe broshura. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat</i>

	<i>e vlerësimit të dijeve të studentëve në programin e studimit dhe procesin e diplomimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Studentët informohen në mënyrë të detajuar për kurrikulën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe fletëpalosje/udhëzues për lëndët/modulet, kurrikulën dhe veprimtaritë formuese. Ky informacion gjendet në rregulloren e programit të studimit [Evidenca nr 6. Rregullore e programit MP SIB.pdf] dhe Udhëzuesin e studentëve [Evidenca nr 38. Udhëzuesi i Studenteve.pdf]. Gjithashtu studentët mund të aksesojnë edhe faqes web (https://www.umsh.edu.al/) për tu njohur me kurrikulën dhe syllabuset. Evidenca: Evidenca nr 6. Rregullore e programit MP SIB.pdf Evidenca nr 38. Udhëzuesi i Studenteve.pdf Evidenca23 MP SIB.pdf https://www.umsh.edu.al/
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe fletëpalosje/udhëzues për lëndët/modulet, kurrikulën dhe veprimtaritë formuese. Ky informacion gjendet në rregulloren e programit të studimit [Evidenca nr 6. Rregullore e programit MP SIB.pdf] dhe Udhëzuesin e studentëve [Evidenca nr 38. Udhëzuesi i Studenteve.pdf]. Gjithashtu informacioni gjendet edhe në syllabuset e kurseve të programit të studimit.
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	UMSH ka një rregullore në mbështetje të studentëve [Evidenca nr 14. Rregullore e ZKSK.pdf]. Në strukturën e UMSH, ka një zyrë përgjegjëse për orientimin dhe informimin e studentëve, kjo zyrë është ZKSK (Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karriere).

Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Studentët e degës Master Profesional “Sistemet e Informacionit në Biznes” njihen me orarin që në fillim të semestrit. Nëse do ketë ndryshime, studentët njoftohen përmes sekretarisë mësimore ose me mail. Në UMSH zhvillohen ditët e orientimit, ku studentët njihen me ambientet dhe personelin përgjegjës për menaxhimin e tyre.		
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Informacioni në lidhje me programin e studimit paraqitet në faqen web të UMSH, i cili është lehtësisht i arritshëm nga studentët kudo ata ndodhen. Gjithashtu studentët mund të aksesojnë edhe nëpërmjet sistemit për tu njohur me kurrikulën dhe syllabuset Studentët marrin informacion rreth performancës dhe arritjeve të tyre akademike. Evidenca: <u>Evidenca nr 41. Udhezues per perdorimin e SMS-se.pdf</u> https://www.umsh.edu.al		
Konkluzione	<i>GVJ konstatoi se UMSH ka struktura të mirëpërcaktuara në mbështetje të studentëve. Në UMSH zhvillohen ditët e orientimit, ku studentët njihen me ambientet dhe personelin përgjegjës për menaxhimin e tyre. Studentët informohen në mënyrë të detajuar për kurrikulën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	GVJ konstatoi se UMSH mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit Master Profesional “Sistemet e Informacionit në Biznes”. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, transferimet nga programi dhe largimet. Informacioni ruhet në zyrën e statistikave në UMSH dhe sekretarinë e fakultetit të Informatikës. Numri i studentëve të regjistruar në tre vitet e fundit akademike janë si më poshtë :

	2021-2022 17 studentë ; 2022-2023 13 studentë ; 2023-2024 17 studentë ; Evidenca: <u>Vizita në Sekretarinë mësimore</u> <u>Evidenca nr 5. Rregullore e Fakultetit të Informatikës.pdf</u> <u>Evidenca nr 14. Rregullore e ZKSK.pdf</u>
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, transferimet nga programi dhe largimet. Studentët informohen në fillim të çdo viti për mënyrën organizimit të kurseve, kreditet, vlerësimin përmes syllabusit të kursit. Informacioni ruhet në zyrën e statistikave në UMSH dhe sekretarinë e fakultetit të Informatikës. Evidenca: Vizita në Sekretarinë mësimore <u>Evidenca nr 5. Rregullore e Fakultetit të Informatikës.pdf</u>
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Informacioni statistikor në lidhje me programin e studimit ruhet në sistemin e menaxhimit të brendshëm të UMSH. Ky sistem lejon ruajtjen e të dhënave në mënyrë të sigurtë dhe gjenerimin automatik të statistikave. Evidenca: <u>Evidenca nr 41. Udhezues për përdorimin e SMS-se.pdf</u>
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	GVJ konstatoi që institucioni zhvillon kontrole periodike pranë gjithë njësive përgjegjëse si fakultetet, departamentet, sekretaritë mësimore, njësitë administrative, etj., ku vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët dhe programet e studimit. Në sekretarinë mësimore kontrolli realizohet 2-herë në vit. Procedura e kontrollit bazohet në rregulloren e fakultetit të Informatikës, sekretarisë mësimore etj. <i>GVJ rekomandon të dorëzohet si evidencë "Rregullorja e sekretarisë".</i> Evidenca:

	<u>Evidenca nr 22. Raporti vjetor i UMSH.pdf</u> <u>Evidenca nr 5. Rregullore e Fakoltetit te Informatikes.pdf</u>			
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Në fund të çdo viti akademik, njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, përqindjen e cilësisë së punësimit të tyre. Dekanati është përgjegjës për analizimin e tyre. ZKSK është përgjegjëse për monitorimin dhe gjurmimin e studentëve pas diplomimit. Ky informacion duhet të paraqitet në raportin vjetor të IAL-ës. Evidenca: <u>Evidenca nr 22. Raporti vjetor i UMSH.pdf</u> <u>Evidenca nr 5. Rregullore e Fakoltetit te Informatikes.pdf</u> <u>Evidenca nr 14. Rregullore e ZKSK.pdf</u>			
Konkluzione	<i>GVJ konstatoi se UMSH mban statistika vjetore për numrin e studentëve, të diplomuarve, në programin e studimit Master Profesional 'Sistemet e Informacionit në Biznes'. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, transferimet nga programi dhe largimet.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	UMSH parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore në fuqi. Studenti ka të drejtë të zgjedhë dhe të zgjidhet në përfaqësinë studentore. Këshilli studentor është pjesë e strukturës së Universitetit Mesdhetar. https://www.umsh.edu.al/c/40/keshilli-studentor Evidenca: <u>Evidenca nr 1. Statuti i UMSH.pdf, Kreu X, Neni 83</u> <u>Evidenca nr 9. Rregullore e organizit UMSH.pdf, Kreu 8, Neni 58</u> <u>Evidenca nr 60. Rregullore e keshillit studentor.pdf</u>

Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Në bashkëpunim me organet drejtuese, UMSH ushtron veprimtarinë e tij. Rektori dhe Dekani nuk zgjidhen me votë, ata emërohen nga instancat përkatëse. Studentët kanë përfaqësi bazuar në legjislacionin në fuqi, rregulloren UMSH, rregulloren e fakultetit Informatikë, rregulloren e programit të studimit etj. Studentët përfshihen përmes opinionit të tyre në hartimin e raportit vjetor. Këshilli studentor mban lidhje të vazhdueshme me koordinatorin e programit të studimit.			
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	GVJ konstatoi se njësitë përgjegjëse, dekanati, koordinatori, zhvillojnë takime me studentët e programit <i>Master Profesional</i> në ‘Sistemet e Informacionit në Biznes’, me qëllim të diskutojnë performancën, kushtet laboratorike, nevojat dhe pritshmëritë, rishikimi i sugjerimeve për syllabuset dhe kurrikulën. UMSH zbaton metoda siç janë anketimet, për të përcaktuar mendimin e studentëve. Evidenca: Evidenca nr 60. Rregullore e keshillit studentor.pdf			
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.	Studentët <i>Master Profesional</i> në ‘Sistemet e Informacionit në Biznes’ shprehin mendimin e tyre përmes plotësimit të pyetësorëve për vlerësimin e lektorëve në formë anonime. Rezultatet analizohen dhe menaxhohen nga NJSBCZHK. Nëse studenti ka pakënaqësi, ai mund të bëjë një ankimim, të cilin ja drejton dekanit. Dekani shqyrton kërkesën dhe vendos nëse do e pranojë ose jo. Evidenca: Evidenca nr 35. Plani i veprimit NJSBCZHK.pdf			
Konkluzione	GVJ konstatoi se studentët janë të përfaqësuar në UMSH. Ata përfaqësohen në senatin akademik dhe NJSBC. Sugjerimet e tyre merren në konsideratë nga koordinatori i programit të studimit, ZKSK dhe përgjegjësi i departamentit. UMSH ka një udhëzues [Evidenca nr 38. Udhëzuesi i Studenteve.pdf] , i cila jep informacionin e plotë mbi procedurën e vlerësimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	UMSH në strukturën e tij ka njësi me qëllim informimin dhe mbështetjen e studentëve, për procesin mësimor, praktikat profesionale, gjetjen e punës pas diplomimit etj. Njësia bazë që ofron programit të studimit është më afër studentëve, duke i dhënë informacion të vazhdueshëm rreth procedurave, këshillimit etj. Evidenca: Evidenca nr 6. Rregullore e programit MP SIB.pdf Evidenca nr 14. Rregullore e ZKSK.pdf Evidenca nr 16. Rregullore e NJSBCZHK.pdf
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Institucioni ka ngritur një sistem për informimin, këshillimin, ndjekjen e studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. Njësitë përgjegjëse për këshillim dhe ndjekje të studentëve janë: ⇒ Strukturat përgjegjëse, si fakulteti, departamenti etj. ⇒ Këshilli studentor ⇒ ZKSK ⇒ Zyra e Marketingut Ky system ndjek studentët nga regjistrimi deri në njohjen me tregun e punës. Evidenca: Evidenca nr 5. Rregullore e Fakultetit të Informatikës.pdf Evidenca nr 14. Rregullore e ZKSK.pdf
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe	UMSH u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Njësia për këshillimin e karrierës, ZKSK, mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim në lidhje me procesin mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale dhe tregun e punës. Evidenca: Evidenca nr 14. Rregullore e ZKSK.pdf Evidenca nr 60. Rregullore e keshillit studentor.pdf

orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.				
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të studimit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Zyra e karrierës ndjek studentët pas diplomimit. Kjo zyrë përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit Master i Profesional në "Sistemet e Informacionit në Biznes". ZKSK realizon orientimin profesional, këshillimin individual ose në grup, gjithashtu bashkëpunon me Këshillin studentor dhe ALUMNI-n.			
Konkluzione	<i>GVJ konstatoi se UMSH u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Njësia për këshillimin e karrierës, ZKSK, mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim në lidhje me procesin mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale dhe tregun e punës. ZKSK realizon orientimin profesional, këshillimin individual ose në grup, gjithashtu bashkëpunon me këshillin Studentor dhe Alumni.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1

Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga IAL, vërehet se në UMSH ka një njësi të qëndrueshme, Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë dhe Zhvillimi të Kurrikulave. Kjo njësi bashkëpunon me departamentet dhe fakultetet dhe menaxhon procesin e përmirësimit të cilësisë sipas një frekuence periodike, bazuar në strategjinë e zhvillimi institucional. Evidenca: Evidenca nr 16. Rregullore e NJSBCZHK.pdf, Neni 1, 16 Evidenca nr 35. Plani i veprimit NJSBCZHK.pdf
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	NJSBCZHK në shërbim të përmirësimit të cilësisë, zbaton dhe menaxhon të dhënat në një frekuencë periodike, sa i përket proceseve administrative dhe përmbajtjes kurrikulare. Në fund të çdo semestri, studentët japin mendimet e tyre përmes një pyetësoi [Evidenca nr 36. Formulari i vlereimit te pedagogut nga studentet.pdf].
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	UMSH ofron metoda për vlerësimin periodik të metodave të mësimdhënies dhe kontrollin e njohurive. Në fund të çdo semestri, studentët japin mendimet e tyre përmes një pyetësoi [Evidenca nr 36. Formulari i vlereimit te pedagogut nga studentet.pdf]. Ky pyetësor plotësohet në format elektronik përmes sistemit UMSH. Studentët kanë hapësirë të shprehin pakënaqësitë e tyre, në lidhje me vlerësimin, performancën mësimore, literaturën etj. <i>GVJ citon që referenca e paraqitur në GVB për formularin e vlerësimit, 'Rregullore UMSH, Neni 76' nuk ekziston.</i> Evidenca: Evidenca nr 36. Formulari i vlereimit te pedagogut nga studentet.pdf Evidenca nr 41. Udhëzues për përdorimin e SMS-se.pdf Evidenca nr 39. Manuali i përdorimit te platoformave online.pdf
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulës bashkëpunon me departamentet dhe fakultetet, në procesin e përmirësimit të cilësisë sipas një frekuence periodike. Rezultatet e gjeneruara nga pyetësorët paraqiten në raport vjetor që kjo njësi përpunon. Gjithashtu rezultatet i dërgohen njësive drejtuese, duke ofruar transparencë në menaxhimin e tyre.

	<i>GVJ citon që referenca e paraqitur në GVB për rezultatet e vlerësimit, 'Rregullore UMSH, Neni 76' dhe 'Rregullore NJSBZHK, Neni 13' nuk përkon me çfarë i referohet.</i> Evidenca: Evidenca nr 16. Rregullore e NJSBCZHK.pdf Evidenca nr 9. Rregullore e organizit UMSH.pdf			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	UMSH nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra nga pyetësorët, afishon rezultatet në raportin vjetor, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Gjithashtu në UMSH realizohet vlerësimi i stafit nga drejtuesit [Evidenca nr 37. Formulari i vlerësimit të pedagogut nga autoritet drejtuese.pdf]. NJSBC dërgon në senat raportin, i cili diskutohet dhe shpërndahet në instancat përkatëse. Dekani dhe përgjegjësi i departamentin, trajtojnë rastet sipas specifikave, duke përmirësuar metodat e mësimdhënies. Evidenca: Evidenca nr 37. Formulari i vlerësimit të pedagogut nga autoritet drejtuese.pdf Evidenca nr 36. Formulari i vlerësimit të pedagogut nga studentet.pdf Evidenca nr 35. Plani i veprimit NJSBCZHK.pdf			
Konkluzione	<i>GVJ konstatoi se UMSH ofron metoda për vlerësimin periodik të metodave të mësimdhënies dhe kontrollin e njohurive. Në fund të çdo semestri, studentët japin mendimet e tyre përmes një pyetësori. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e Zhvillimit të Kurrikulës bashkëpunon me departamentet dhe fakultetet, në procesin e përmirësimit të cilësisë sipas një frekuence periodike. Rezultatet e gjeneruara nga pyetësorët paraqiten në raport vjetor që kjo njësi përpunon.</i> <i>GVJ rekomandon azhurnimin e referencave të sugjeruara</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	UMSH në përputhje me ligjin Nr. 80/2015 dhe statutin e universitetit, ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC). Në këtë IAL, ekziston Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e Zhvillimit të Kurrikulës, NJSBCZHK, e cila bashkëpunon me departamentet dhe fakultetet, në procesin e përmirësimit të cilësisë sipas një frekuence periodike. Evidenca: Evidenca nr 1. Statuti i UMSH.pdf Evidenca nr 9. Rregullore e organizit UMSH.pdf Evidenca nr 16. Rregullore e NJSBCZHK.pdf
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulës, NJSBCZHK, e cila bashkëpunon me departamentet dhe fakultetet, në procesin e përmirësimit të cilësisë sipas një frekuence periodike. Rezultatet e gjeneruara nga pyetësorët paraqiten në raport vjetor që kjo njësi përpunon. Kjo njësi [Evidenca nr 16. Rregullore e NJSBCZHK.pdf, Neni 3] është me mandat 3-vjeçar dhe përbëhet nga 9 anëtarë: ⇒ staf akademik i brendshëm, ⇒ ka 1 përfaqësues nga studentët, ⇒ ka përfaqësues nga ekspertë të fushës ⇒ staf ndihmës akademik Kjo njësi është e angazhuar për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm. Evidenca: Evidenca nr 16. Rregullore e NJSBCZHK.pdf Evidenca nr 22. Raporti vjetor i UMSH.pdf
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që	UMSH përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Ai përdor metodologji dhe teknika për vlerësimin e mësimdhënies, cilësisë së literaturës si dhe përmbushjen e objektivave të programit të studimit. Disa nga proceset e NJSBC janë: ⇒ Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies ⇒ Vlerësimi i cilësisë dhe ngritjes akademike ⇒ Hartimi i raportit vjetor Evidenca:

promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Evidenca nr 16. Rregullore e NJSBCZHK.pdf Evidenca nr 35. Plani i veprimit NJSBCZHK.pdf Evidenca nr 61. Rregullore për organizimin dhe PKPSSC.pdf Evidenca nr 22. Raporti vjetor i UMSH.pdf			
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënies dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	UMSH përdor mekanizma për vlerësimin e procesit të mësimdhënies dhe kërkimit, duke pasqyruar gjendjen, arritjet dhe dobësitë institucionale. Mbi bazën e rezultateve, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit. Evidenca: Evidenca nr 16. Rregullore e NJSBCZHK.pdf Evidenca nr 35. Plani i veprimit NJSBCZHK.pdf			
Konkluzione	<i>GVJ konstatoi se UMSH përdor disa instrumente dhe tregues për sigurimin e cilësisë. Ai përdor metodologji dhe teknika për vlerësimin e mësimdhënies, cilësisë së literaturës si dhe përmbushjen e objektivave të programit të studimit. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulës, NJSBCZHK, e cila bashkëpunon me departamentet dhe fakultetet, në procesin e përmirësimit të cilësisë sipas një frekuence periodike.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet ☐	Përmbushet pjesërisht ☐	Përmbushet kryesisht ☐	Përmbushet plotësisht ☒

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë	UMSH përdor metodologji vlerësimi sa i përket mbarëvajtjes së procesit të mësimdhënies dhe cilësisë akademike. Në fund të çdo viti akademik, NJSBCZHK përgatit një raport, të cilin e shpërndan në formë zyrtare. Bazuar në të dhënat e raportit nxirren rezultate dhe rekomandime për përmirësimin e cilësisë dhe mësimdhënies. Rezultatet e pyetësorëve bëhen publik ndaj stafit, studentëve, administratës etj.

akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Evidenca: Evidenca nr 22. Raporti vjetor i UMSH.pdf
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	Raportet e vlerësimit të cilësisë përfshijnë rezultatet e pyetësorëve të vlerësimit të cilat u përmendëm më lart dhe analizën krahasuese me rezultatet e një viti më parë. Këto rezultate i komunikohen stafit, studentëve. NJSBCZHK harton raportin vjetor të përgjithshëm që përgatitet në fund të çdo viti akademik.
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara,	UMSH në këtë program studimi përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve. Stafi i ri, këshillohet, orientohet dhe njihet me praktikatat më të mira që të kenë një përmirësim të vazhdueshëm. Personeli akademik në kontratën që firmos, njihet me të gjithë format e vlerësimit. Evidenca: Evidenca nr 37. Formulari i vlerësimit të pedagogut nga autoritet drejtuese.pdf Evidenca nr 46. Program trajnimi dhe kualifikimi.pdf Evidenca nr 52. Manual i përdorimit të raportimit vjetor individual.pdf

rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.				
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfutuara nga ky program.	UMSH në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: pyetësor ndaj studentëve, alumnit, mbledhje dhe diskutime të hapura të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ dhe palëve të tjera që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit. Evidenca: <u>Evidenca nr 22. Raporti vjetor i UMSH.pdf</u>			
Konkluzione	GVJ konstatoi se UMSH përdor metodologji vlerësimi sa i përket mbarëvajtjes së procesit të mësimdhënies, cilësisë akademike. Në fund të çdo viti akademik, NJSBCZHK përgatit një raport, të cilin e shpërndan në formë zyrtare.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të	Në UMSH, ka bashkëpunim ndërmjet njërive drejtuese të tij, në ndihmë të ruajtjes së cilësisë së programit të studimit Master

garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Profesional “Sistemet e Informacionit në Biznes”. Fakulteti i Informatikës bashkëpunon me institucione dhe kompani partnere për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies. NJSBCZHK komunikon dhe bashkëpunon vazhdimisht me njësitë drejtuese që ofrojnë këtë program studimi. Në kuadër të sigurimit të cilësisë IAL-ja ofron vazhdimisht trajnime [Evidenca nr 46. Program trajnimi dhe kualifikimi.pdf] për secilin anëtar të stafit. Evidenca: Raporti i vleresimit te brendshem periodik MP SIB.pdf Evidenca nr 3. Plani i Zhvillimit Strategjik te UMSH.pdf Evidenca nr 18. Liste e Mobilitetit te stafit akademik.pdf Evidenca nr 27. Te dhenat permbledheve per stafin akademik, kualifikimet.pdf Evidenca nr 36. Formulari i vlereimit te pedagogut nga studentet.pdf Evidenca nr 37. Formulari i vleresimit te pedagogut nga autoritet drejtuese.pdf Evidenca nr 51. Te dhena per kerkimin shkencor, stafi akademik.pdf
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	GVJ vëren se UMSH, përcakton qartë detyrat [Evidenca nr 9. Rregullore e organizit UMSH.pdf], dhe përshkallëzimi i tyre nga njësia kryesore, tek njësia bazë e deri në nivel lektorësh. Një sërë detyrash lidhen me sigurimin e brendshëm të cilësisë, si kontrolli i vazhdueshëm i kurrikulave, syllabuseve, procesi mësimor sipas kalendarit akademik, vlerësimi i lektorëve, fokus grupet etj. me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Detyrat dhe përgjegjësitë e secilit anëtar të stafit akademik dhe administrative paraqiten në rregulloren e NJSBCZHK [Evidenca nr 16. Rregullore e NJSBCZHK.pdf] dhe njërive përkatëse. Evidenca: Evidenca nr 16. Rregullore e NJSBCZHK.pdf Evidenca nr 35. Plani i veprimit NJSBCZHK.pdf
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të	UMSH operon me procedura të sigurimit të cilësisë që demonstrojnë transparencë dhe përgjegjësi për të gjithë aktorët e saj. I gjithë personeli akademik dhe administrativ ka një rol kyç në zbatimin e procedurave të sigurimit të cilësisë përmes një bashkëpunimi të vazhdueshëm me NJSBCZHK. Senati ka përgjegjësinë përfundimtare për miratimin, monitorimin dhe rishikimin e të gjitha procedurave të sigurimit të cilësisë.

personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.				
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	UMSH vlerëson dhe respekton standardet akademike në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë. Në këtë kuadër përfshirja dhe aktivizimi i të gjithë aktorëve të brendshëm në proceset e vlerësimit është një nga objektivat kryesore të IAL në këtë drejtim Evidenca: Evidenca nr 2. Kodi i Etikes.pdf			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Në nivel institucional, UMSH ka disa marrëveshje bashkëpunimi. Kjo lejon që të ketë mobilitet të stafit akademik dhe administrativ. Gjithashtu UMSH bashkëpunon në mënyrë të vazhdueshme me aktorë të jashtëm dhe palë të treta, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit Master Profesional “Sistemet e Informacionit në Biznes”. Evidenca: Evidenca nr 12. Liste marreveshje te bashkepunimit-1.pdf			
Konkluzione	<i>GVJ konstatoi se UMSH operon me procedura të sigurimit të cilësisë që demonstrojnë transparencë dhe përgjegjësi për të gjithë aktorët e saj. I gjithë personeli akademik dhe administrativ ka një rol kyç në menaxhimin dhe zbatimin e procedurave të sigurimit të cilësisë përmes një bashkëpunimi të vazhdueshëm me Njësinë e Sigurimit të Brendshme të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulës. Senati akademik ka përgjegjësinë përfundimtare për miratimin, monitorimin dhe rishikimin e të gjitha procedurave të sigurimit të cilësisë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	UMSH përmes komunikimeve me e-mail, takime informuese, rrjeteve sociale, informon studentët për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimit të cilësisë në universitet. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulës, NJSBCZHK, bashkëpunon me departamentet dhe fakultetet, në procesin e përmirësimit të cilësisë sipas një frekuence periodike. Rezultatet e gjeneruara nga pyetësorët paraqiten në raportin vjetor që kjo njësi përpunon. Evidenca: <u>Evidenca nr 16. Regullore e NJSBCZHK.pdf</u> <u>https://www.umsh.edu.al/c/125/sigurimi-i-cilesise</u>
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	UMSH publikon rezultatet e vlerësimeve, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. Rezultatet e gjeneruara nga pyetësorët paraqiten në raportin vjetor që kjo njësi përpunon. UMSH organizon takime periodike, në formën e diskutimeve dhe bashkëbisedimeve. Evidenca: <u>Evidenca nr 35. Plani i veprimit NJSBCZHK.pdf</u>
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Rezultatet e vlerësimit adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara. Në fund të çdo viti, rezultatet e vlerësimit hartohen në formën e Raportit Vjetor. Analizapërcakton rekomandimet për përmirësimin e cilësisë dhe mësimdhënies.
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Në lidhje me programin e studimit, janë marrë masa për rishikimin dhe përmirësimin e rregullores, kurrikulës, syllabuseve etj, në mënyrë periodike [<u>Raporti i vlerësimit të brendshëm periodik MP SIB.pdf</u>]. <i>GVJ rekomandon: hartimin e një evidence me ndryshimet dhe rishikimet e realizuara në përmirësimin e mangësive dhe dobësive të evidentuara.</i>

Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	NJSBCZHK harton një plan periodik aktiviteteve, ku përfshihen takime, mbledhje, njoftime në lidhje me proceset e akreditimit, të cilat lidhen me cilësinë e programit që ata bëjnë pjesë. Njësia mbledhet periodikisht, për të diskutuar mbi: punën e kryer, çështje të organizimit të cilësisë, vendosjen e indikatorëve, konkluzionet e monitorimit, rekomandimet etj. Evidenca: Evidenca nr 35. Plani i veprimit NJSBCZHK.pdf			
Konkluzione	<i>GVJ konstatoi se UMSH ka një njësi, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulës, NJSBCZHK, e cila bashkëpunon me departamentet dhe fakultetet, në procesin e përmirësimit të cilësisë sipas një frekuence periodike. UMSH publikon rezultatet e vlerësimeve, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</i> <i>GVJ rekomandon: hartimin e një evidence me ndryshimet dhe rishikimet e realizuara në përmirësimin e mangësive dhe dobësive të evidentuara.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional “Sistemet e Informacionit në Biznes” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë”

Pikat e forta dhe afirmime

1. Programi i studimit është hartuar në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit dhe plotëson nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik lokal dhe kombëtar në drejtimin e Teknologjisë së Informacionit.
2. Programi i studimit gëzon mbështetje të mirë nga strukturat drejtuese dhe kjo vihet re nga projektet ndërkombëtare, mbështetja nga Bordi i Punës, apo mundësitë e ofruara për studentët.
3. Kritja e bashkëpunimit dhe pjesëmarrja në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare ka ofruar dhe mbështet stafin akademik dhe studentët në njohuri dhe eksperiencë në fusha dhe projekte me interes të programit të studimit dhe tregut të punës.
4. Ofrimi i mbështetjes së studentëve me anë të bursave dhe programet e mobilitetit, ndërkombëtarizimit për ata me rezultate të larta .
5. Pjesëmarrja dhe trajnimi në aktivitete dhe trajnime profesionale të organizuara nga UMSH dhe organizata profesionale apo kompani private.
6. Programi siguron përfshirjen e studentëve në mësim praktik përmes praktikave të strukturuar dhe marrëveshjeve bashkëpunuese me institucione, duke nxitur përvojën praktike dhe integrimin më të mirë në tregun e punës.
7. Përshtatshmëria me legjislacionin në fuqi, pasi programi përmbush të gjitha kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për njësitet akademike, duke garantuar një ofertë arsimore në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore kombëtare.

Pika të dobëta

1. Mungesa e evidentimit të ndikimit të projekteve specifike në përmirësimin e cilësisë së programit MP SIB. *(Standardi I.1, kriteri 4)*
2. Mungesa e dokumentit të dorëzuar pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve dhe mosfinalizimi i procedurave për miratimin e planit të kodifikimit të programeve të studimit. *(Standardi I.2, kriteri 2)*
3. Mungesa e një analize të thelluar dhe të dokumentuar vjetore nga Departamenti IB, duke përfshirë realizimet, pritshmëritë dhe përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit. *(Standardi I.3, kriteri 4)*
4. Syllabuset janë vetëm në gjuhën shqipe, ku për ciklin e dytë të studimeve duhet edhe varianti i tyre në gjuhën angleze. *(Standardi II.3, kriteri 5)*
5. Mungesa e literaturës së huaj e përditësuar, e cila përdoret gjerësisht në universitetet ndërkombëtare, në mbështetje të lëndëve të programit. *(Standardi II.4, kriteri 3)*



6. Literatura në gjuhë të huaj e përdorur për lëndët e programit të studimit nuk është bashkëkohore (e 5 viteve të fundit) *(Standardi II.4, kriteri 5; Standardi IV.3, kriteri 1)*
7. Mungesa e një raporti të detajuar që përshkruan dhe ilustron në mënyrë cilësore dhe sasiore angazhimet e njësive përgjegjëse për programin MP SIB, duke përfshirë përmirësimet dhe përshtatjen me kërkesat e tregut të punës. *(Standardi II.7, kriteri 3)*
8. Rishikim i programeve dhe i literaturës për lëndët e profesionit, duke rrezikuar përputhjen me zhvillimet e fundit në fushë dhe kërkesat e tregut të punës. *(Standardi III.1, kriteri 4)*
9. Nevoja për përmirësim të mëtejshëm të kurrikulës, azhurnim të literaturës, shtim të trajnimeve, çertifikimeve dhe komponentëve praktikë në lëndët e profilit. *(Standardi III.4, kriteri 1)*
10. Staf i punësuar me kohë të plotë që jep mësim në këtë program është vazhdimisht në lëvizje (pra është i paqëndrueshëm). *(Standardi IV.1, kriteri 3)*
11. Burimi kryesor i financimit të programit të studimit janë të ardhurat e siguruar nga tarifat e shkollimit që paguajnë studentët. *(Standardi IV.5, kriteri 3)*
12. Mesatarja në hyrje e studentëve *(Standardi V.1, kriteri 3, kriteri 7)*

Rekomandime

1. Të hartohet dhe të dokumentohet një raport që evidenton ndikimin e projekteve specifike në përmirësimin e cilësisë së programit MP SIB, duke përfshirë analizën e rezultateve dhe përfitimeve të arritura.
2. Dorëzimi i dokumentave drejtuar Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve dhe finalizimi i procedurave për miratimin e planit të kodifikimit të programeve të studimit, për të siguruar përputhje me standardet kombëtare.
3. Departamenti IB duhet të hartojë dhe të dorëzojë një analizë të thelluar dhe të dokumentuar vjetore, e cila të përfshijë realizimet, pritshmëritë, dhe përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit, për të siguruar monitorim të vazhdueshëm dhe përmirësim të cilësisë së programit.
4. Të përgatiten syllabuset e programit edhe në gjuhën angleze, duke siguruar kështu përputhjen me kërkesat për ciklin e dytë të studimeve dhe lehtësimin e aksesit për palët e interesuara.
5. Të sigurohet dhe të integrohet literature e huaj e përditësuar, e cila përdoret gjerësisht në universitetet ndërkombëtare, për të mbështetur dhe pasuruar lëndët e programit.
6. Hartimi i një raporti të detajuar që përshkruan dhe ilustron në mënyrë cilësore dhe sasiore angazhimet e njësive përgjegjëse për programin MP SIB, duke përfshirë përmirësimet e realizuara dhe përshtatjen e programit me kërkesat e tregut të punës.
7. Të kryhet një rishikim i rregullt dhe sistematik i programeve dhe literaturës për lëndët profesionale, për të siguruar përputhshmëri me zhvillimet më të fundit në fushë dhe me kërkesat aktuale të tregut të punës.
8. Njësia bazë, si dhe stafi PAK dhe PAE i angazhuar në programin e studimit duhet të orientojë programin e studimit qartësisht: ose drejt përfitimit të aftësive teknike; ose atyre menaxheriale dhe proceseve të biznesit brenda profileve të veçanta. Kohëzgjatja prej një viti akademik i programit të studimit nuk i lejon të dyja.

9. Procesi mësimor nuk duhet të mbulohet tërësisht nga stafi PAE, pra duhet të integrohet stafi PAK
10. Njësia bazë duhet të ndërmarrë iniciativa shtesë në lidhje me aftësimin e studentëve përtej orëve në auditor (trajnime, certifikime, pjesëmarrje konkrete në projekte).
11. IAL të konsolidojë dokumentacionin e kërkuar sipas kritereve të shprehur në këtë raport, sic ato kërkohen, si dhe të jenë të azhornuara.
12. Programet lëndore të secilit profil rekomandohen të azhurnohen sipas sugjerimeve të dhëna në këtë RVJ, të përmirësohen literaturat me botime më të reja për lëndët.
13. Institucioni të angazhohet për gjetjen e burimeve të tjera për financimin e programit të studimit.
14. Të parashikohen dhe shtohen në syllabusin e disa lëndëve specifike në programin mësimor orët praktike/ laboratorike, të mbështetur me infrastrukturën e nevojshme softuer.
15. Të krijohen mekanizma për mbështetjen e stafit, që të jetë më i qendrueshëm.
16. Përmirësimi i transparencës në dokumentimin e procedurave dhe rregulloreve të ndryshme, duke siguruar që të gjitha rregulloret dhe procedurat të jenë të qarta dhe të aksesueshme për të gjithë aktorët.
17. Përfshirja e Studentëve në Projekte Kërkimore dhe Inovative (jo vetëm mobilitet): Sugjerohet që studentët të angazhohen më aktivisht në projekte kërkimore dhe inovative për të zhvilluar aftësitë e tyre analitike dhe kritike.
18. Në sistemin e menaxhimit të UMSH të integrohen platforma të standartizuara që mundësojnë format e komunikimit interaktiv ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.
19. Hartimin e një evidence me ndryshimet dhe rishikimet e realizuara në përmirësimin e mangësive dhe dobësive të evidentuara
20. Sugjeron që në sistemin e menaxhimit të UMSH të integrohen platforma të standartizuara që mundësojnë format e komunikimit interaktiv ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.

Strengths and Affirmations

1. The study program is designed in accordance with the economic development of the country, it meets the needs of the labor market, by the strategic goals of local and national economic development in the direction of Information Technology.
2. The study program has good support from the management structures; this can be seen in the international projects, the support from the Labor Board, or the opportunities offered to the students.
3. Increasing cooperation and participation in national and international projects supports the academic staff and students in new knowledge and experiences, in projects of interest to the study program and the labor market.
4. Support to students through scholarships and mobility programs, internationalization for those students with high results.
5. Participation and training in activities organized by UMSH and professional organizations or private companies

6. The program ensures the involvement of students in practical learning through structured internships and cooperative agreements with institutions, promoting practical experience and better integration into the labor market.
7. Compliance with the legislation in force, as the program fulfills all legal requirements and quality standards for academic units, guaranteeing an educational offer in accordance with national legal acts.


Weak points

1. Lack of evidence on the impact of specific projects in improving the quality of the MP SIB program. (Standard I.1, Criterion 4)
2. Lack of documentation on submitting the document to the Ministry of Education and Sports and non-finalization of the procedures for approving the coding plan of study programs. (Standard I.2, Criterion 2)
3. Absence of a detailed and documented annual analysis by the IB Department, including achievements, expectations, and benefits from cooperation agreements. (Standard I.3, Criterion 4)
4. Syllabuses are only in Albanian, while they must also be available in English for the second cycle of studies. (Standard II.3, Criterion 5)
5. Lack of updated foreign literature widely used in international universities to support the program's courses. (Standard II.4, Criterion 3)
6. The foreign literature used for the program's courses is not up-to-date (within the last five years). (Standard II.4, Criterion 5; Standard IV.3, Criterion 1)
7. Lack of a detailed report describing and illustrating qualitatively and quantitatively the efforts of the unit responsible for the MP SIB program, including improvements and alignment with labor market demands. (Standard II.7, Criterion 3)
8. Review of programs and literature for professional courses risks falling behind the latest developments in the field and labor market demands. (Standard III.1, Criterion 4)
9. Need for further improvement of the curriculum, updating of literature, and inclusion of more training, certifications, and practical components in profile courses. (Standard III.4, Criterion 1)
10. The full-time staff teaching in this program is continuously changing (i.e., it is unstable). (Standard IV.1, Criterion 3)
11. The primary source of funding for the study program is the income generated from tuition fees paid by students. (Standard IV.5, Criterion 3)
12. The students' entry average is low. (Standard V.1, Criteria 3 and 7)

RECOMMENDATIONS

1. Develop and document a report that highlights the impact of specific projects on improving the quality of the MP SIB program, including an analysis of achieved results and benefits.

2. Submit the required documents that verify the starting procedure with the Ministry of Education and Sports and finalize the procedures for approving the coding plan of study programs to ensure alignment with national standards.
3. The IB Department must prepare and submit a detailed and documented annual analysis, including achievements, expectations, and benefits from cooperation agreements, to ensure continuous monitoring and quality improvement of the program.
4. Prepare syllabuses in English to meet the requirements for the second cycle of studies and facilitate access for stakeholders.
5. Ensure and integrate updated foreign literature, widely used in international universities, to support and enrich the program's courses.
6. Develop a detailed report describing and illustrating qualitatively and quantitatively the efforts of the unit responsible for the MP SIB program, including completed improvements and the program's alignment with labor market demands.
7. Conduct regular and systematic reviews of programs and literature for professional courses to ensure alignment with the latest developments in the field and current labor market demands.
8. The department, along with the full-time (PAK) and part-time (PAE) staff involved in the program, must orient the study program: either toward developing technical skills or toward management and business processes within specific profiles. The one-year duration of the program does not allow for both.
9. The teaching process should not be entirely covered by part-time (PAE) staff; full-time (PAK) staff must also be integrated.
10. The department should undertake additional initiatives to develop students' skills beyond classroom hours (e.g., training, certifications, active participation in projects).
11. The institution must consolidate the required documentation according to the criteria expressed in this report, ensuring it meets the required standards and is up to date.
12. The subject-specific programs for each profile are recommended to be updated according to the suggestions given in this RVJ, and the literature should be improved with more recent publications.
13. The institution should actively seek additional funding sources for the study program.
14. Practical/laboratory hours supported by the necessary software infrastructure should be planned and added to the syllabus of specific courses in the program.
15. Mechanisms should be developed to support staff stability.
16. Improve transparency in documenting procedures and regulations, ensuring that all procedures and regulations are clear and accessible to all stakeholders.
17. Inclusion of students in research and innovative projects (beyond mobility): Students should be more actively engaged in research and innovative projects to develop their analytical and critical skills.
18. Standardized platforms that enable interactive communication between academic staff and students should be integrated into UMSH's management system.
19. Develop a record of changes and revisions made to address the identified shortcomings and weaknesses.



20. It is suggested that standardized platforms enabling interactive communication between academic staff and students be integrated into UMSH's management system.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X